RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Auditim Financiar

Tiranë, shtator 2026

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4

1. Përshkrim i shkurtër i institucionit 4
2. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij. 4
3. Objektivat dhe qëllimi i auditimit: 4
4. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave 5
5. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve 5
6. Paraqitja e gjetjeve kryesore 5-6
7. Paraqitja e rekomandimeve kryesore 7-8
8. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit 8-9

II. HYRJA 9

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit 9
2. Identifikimi i çështjes 10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 10
4. Përgjegjësia e audituesve 11
5. Kriteret e vlerësimit: 11-12
6. Standardet e auditimit 12
7. Metodat e auditimit 12-14
8. Dokumentimi i auditimit 13

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT 14

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin 14-15
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit 15

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik……. 15-25

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. 25-33

2.2.6 Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara… 33-39

2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025. 39-55

2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditim e mëparshëm. 55-97

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 98-97

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Bashkia e Skraparit kufizohet në veri me bashkitë Gramsh dhe Berat, në lindje me bashkinë Përmet, në jug me bashkinë Këlcyrë, ndërsa në perëndim me bashkinë Poliçan. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Çorovodës. Sipas Censusit të vitit 2023, Bashkia Skrapar numëron rreth 9,900 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej rreth 831 km², duke qenë një nga bashkitë me territor të gjerë dhe reliev kryesisht malor në jug të Shqipërisë.

Ekonomia e Bashkisë së Skraparit mbështetet kryesisht në bujqësi, blegtori, pemëtari dhe turizëm natyror. Zona njihet për prodhimin e rrushit, verës, rakisë tradicionale, mjaltit, arrave dhe produkteve blegtorale. Gjithashtu, kanionet e Osumit, mali i Tomorit dhe pasuritë natyrore e kulturore e kanë bërë turizmin një sektor me potencial të lartë zhvillimi.

Bashkia e Skraparit përbëhet nga qyteti i Çorovodës dhe disa njësi administrative rurale, të cilat karakterizohen nga reliev kodrinoro-malor. Banorët e këtyre zonave sigurojnë të ardhurat kryesisht nga pemëtaria, kultivimi i bimëve bujqësore, blegtoria dhe përpunimi i produkteve tradicionale. Vitet e fundit, zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit të aventurës ka krijuar mundësi të reja ekonomike për komunitetin lokal, duke shfrytëzuar potencialin e pasur natyror dhe kulturor të bashkisë.

2. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjore".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Skrapar si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

3. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe aktet ligjore dhe nënligjore për periudhën 01.01.2025-31.12.2025.

Në Auditimin Financiar, qëllimi është të jepet një opinion i pavarur dhe profesional, me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025 transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë pasqyruar saktë dhe drejtë në pasqyrat financiare të subjektit, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm të raportimit financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2. Burimi i krijimit të të ardhurave, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave
3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar.
4. Vlerësimi i funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm.
5. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, kryer në Bashkinë Skrapar.

4. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. ***Vlerësimi i riskut të kontrollit*;**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2025 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 7,543 mijë lekë dhe gabimi i lejuar *(10% - 20%)* në vlerën 982 mijë lekë për t'u konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);

Grupi i auditimit ka audituar transaksione të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren

5. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 16 gjetje dhe ka dhënë 17 rekomandime, nga ku masa organizative me 15 gjetje dhe 16 rekomandime, dhe 1 gjetje-rekomandim në fushën e të ardhurave.

6. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Nga auditimi u konstatua se nga Bashkia Skrapar nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuara (borxhi) dhe për të gjithë subjektet, pasi nga auditimi i të dhënave, rezulton se:

a) Deri në datën 31.12.2024 nga mospagesa e detyrimeve tatimore janë debitorë abonentët familjarë në vlerën 98,885,976 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025 janë paguar nga debitorët familjarë 6,348,087 lekë dhe është krijuar borxhi në vlerën 17,139,347 lekë për abonentët familjarë. Borxhi tatimor progresiv për abonentë familjarë në datë 31.12.2025, është në vlerën **109,677,236 lekë.**

b) Në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Skrapar konstatohet se deri në datë 31.12.2024, borxhi tatimor është në vlerën 9,856,375 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, janë paguar nga debitorët biznes detyrime të prapambetura në vlerën 8,877,632 lekë dhe është krijuar borxhi tatimor në vlerën 2,700,221 lekë për abonentët biznes. Borxhi tatimor progresiv për abonentë privatë në datë 31.12.2025, është në vlerën **11,577,856 lekë**.

- ***Procedurat e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit***

- Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:

Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme është miratuar me VKB nr.9, datë 27.02.2024 paraqitur në Këshillin Bashkiak. Vlerësimi i të ardhurave është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuar.
Tavanet Buxhetore për PBA 2025-2027 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.18, datë 27.03.2024 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 239/1 prot., datë 02.04.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara.
Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar.
Bashkia Skrapar nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave projektdokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm.
Projektdokumenti i fazës së parë të PBA 2025-2027 nuk është paraqitur në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë.
Tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr.39 datë 25.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.536/1 prot., datë 30.07.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara.
Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak
- Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Skrapar së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025, ka devijime me vlerën e planifikuar.
Për vitin 2025, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 1477,243 mijë lekë, plani përfundimtar është në vlerën 537,413 mijë lekë ndërsa realizimi është në vlerën 465,607 mijë lekë ose në masën 83%.
Për vitin 2025 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 637,974 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 532,165 mijë lekë ose në masën 86%.
Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real.

- ***Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025***

- Nga auditimi i dokumentacionit për kontabilizimin e investimeve në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* u konstatua se 2 (dy) investim për AAM nuk janë marrë në dorëzim dhe është kontabilizuar në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* 48,035 mijë lekë. Llogaria 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 48,035 mijë lekë.
- Nga auditimi i dokumentacionit për kontabilizimin e investimeve në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" u konstatua se 1 (një) investim për AAM nuk është marrë në dorëzim dhe është kontabilizuar në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* në vlerën 13,564 mijë lekë. Llogaria 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 13,564 mijë lekë.
-Llogaria 26 "Aktivet afatgjata financiare" është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 470 mijë lekë.
- Nga auditimi i kontabilizimeve në llogaritë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, vepra ujore"* u konstatuan 3 investime për Aktive Afatgjata Materiale me vlerë 61,600 mijë lekë të cilat nuk janë kolauduar dhe nuk janë marrë në dorëzim. Këto aktive duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 231 *"Investime për aktive afatgjata".*
-Llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 1,747 mijë lekë.

7. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

- ***Planifikimin dhe realizimit i të ardhurave***

- Drejtoria e të Ardhurave dhe e Tatim Taksave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2025 nga subjektet e biznesit debitorë në vlerën 11,577,856 lekë, nga debitorët familjarë në vlerën 109,677,236 lekë.
- Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim Taksave të marrë masa për hartimin e regjistrit fizik të tatimpaguesve fizik/juridik/shtetërorë me të gjitha detyrimet vjetore që ato kanë në zbatim të paketës fiskale të miratuar çdo vit.
- Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për përdorimin e një sistemi për administrimin e taksave dhe tarifave vendore i cili ofron siguri për regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave.

- ***Procedurat e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit***

- Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mosshlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Skrapar, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.
- Kryetari i Bashkisë Skrapar, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat e nevojshme që të ndjekë të gjitha fazat e planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor duke e miratuar brenda afateve ligjore.

- ***Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025***

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të saktësojë llogarinë 202 "*Studime dhe kërkime"* në pasqyrën e pozicionit financiar për 6 projekte të cilat lidhen me ujësjellës me vlerë historike 78,985 mijë lekë që duhet t'i bashkëngjiten kapitalizmit të aktiveve dhe të transferohen në *"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha"*.
- Kryetari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të ngrenë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Skrapar të kaluar me VKM për llogarinë 210 "*Toka, troje terrene*". Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të merren masa që vlerat e saj të jenë analizuar me objekte.
- Kryetari i Bashkisë Skrapar të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Skrapar për llogarinë 211 "*Pyje Plantacione*" në lidhje me gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor për aktivet e kontabilizuar në llogaritë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore".* Aktivet në këto llogari të kontabilizohen në momentin kur merren në dorëzim jo kur likuidohet i plotë detyrimi.

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të saktësojë llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në pasqyrën e pozicionit financiar për 62 Aktivet Afatgjata Materiale të cilat lidhen me ujësjellës me vlerë historike 895,367 mijë lekë duhet t'i transferohen *"Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha"*.

8. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2025:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Skrapar për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2025 - 31.12.2025, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Skrapar nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin e kualifikuar", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar me rezervë"****, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin e kualifikuar me rezervë[1]:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale por jo të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Skrapar. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Materialiteti i Bashkisë Skrapar për vitin 2025 është në vlerën 7,543 mijë lekë.

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2025, paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

- Në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* u konstatua se 4 (katër) investime për AAM nuk janë kolauduar, nuk janë marrë në dorëzim dhe janë kontabilizuar në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore*" për vlerën 48,035 mijë lekë sipas pagesave pjesore të kryera për këto investime dhe jo sipas vlerës së plotë të kontratës. Llogaria 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 48,035 mijë lekë.

[1] *Një "Opinion me rezervë", jepet në rastet kur: - audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;*

- Në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione*" u konstatua se 1 (një) investim për AAM nuk është kolauduar, nuk është marrë në dorëzim dhe është kontabilizuar në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* në vlerën 13,564 mijë lekë sipas pagesave pjesore të kryera për këtë investim dhe jo sipas vlerës së plotë të kontratës. Llogaria 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 13,564 mijë lekë.
-Llogaria 26 *"Aktivet afatgjata financiare"* është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 470 mijë lekë.
- Nga auditimi i kontabilizimeve në llogaritë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, vepra ujore"* u konstatuan 4 investime për Aktive Afatgjata Materiale me vlerë 61,600 mijë lekë të cilat nuk janë kolauduar dhe nuk janë marrë në dorëzim. Këto aktive duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 231 *"Investime për aktive afatgjata".*

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 550/1 prot, datë 22.05.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 25.05.2026 deri më datë 06.07.2026 në subjektin Bashkia Skrapar për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025, u krye *auditimi "Mbi auditimin financiar"* nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K H, Përgjegjës Grupi
2. A D, Auditues
3. K F, Auditues

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Objekt i këtij auditimi është auditimi financiar i subjektit, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kritereve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 "Kriteret e vlerësimit". Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj. Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre. Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

2. Identifikimi i çështjes

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Skrapar, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Skrapar.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë Skrapar në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Skrapar, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.
NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.
Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.
Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.[2]
Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësia e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e

[2] Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 15

brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.
Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.
Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.
Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Skrapar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.
Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:
- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm publik";* Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;* Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes Vendore"*; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"*; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues";* Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 *"Për miratimin e manualit të MFK";* Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".*
-Në fushën e buxhetit: Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *"Për huamarrjen e qeverisjes vendore";* Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar*; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* etj.;

Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;* Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" i ndryshuar*; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore".*

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar;*
- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar";* Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 *"Për sistemin e taksave lokale"*, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, *"Për taksat kombëtare", i ndryshuar;* VKM nr. 170, datë 25.4.2002 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime*; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, *"Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" i ndryshuar*; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245, datë 29.12.2022; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[3]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të nxitur te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

[3] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:
- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.*
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të auditimit financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme

që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuar në zyrën e protokollit të Bashkisë Skrapar në datë 06.07.2026, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit. Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi aktet e konstatimit.

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Zona Gjeografike: Bashkia e Skraparit kufizohet në veri me bashkitë Gramsh dhe Berat, në lindje me bashkinë Përmet, në jug me bashkinë Këlcyrë, ndërsa në perëndim me bashkinë Poliçan. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Çorovodës.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2023, Bashkia Skrapar numëron 9,981 banorë. Bashkia e Skraparit ka një sipërfaqe prej rreth 831 km².

Zhvillimi ekonomik: Ekonomia e Bashkisë së Skraparit mbështetet kryesisht në bujqësi, blegtori, pemëtari, vreshtari dhe turizëm. Zona njihet për prodhimin e rrushit, verës, rakisë tradicionale, mjaltit dhe produkteve blegtorale, ndërsa turizmi natyror dhe kulturor përbën një sektor në zhvillim, falë atraksioneve si Kanionet e Osumit dhe Parku Kombëtar i Malit të Tomorit.

Në Bashkinë e Skraparit, krahas qytetit të Çorovodës, ndodhen disa njësi administrative rurale me reliev kryesisht kodrinoro-malor. Të ardhurat kryesore të banorëve sigurohen nga kultivimi i pemëve frutore, vreshtaria, blegtoria dhe përpunimi i produkteve tradicionale. Gjithashtu, vitet e fundit është zhvilluar agroturizmi dhe turizmi i aventurës, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin ekonomik të zonës.

Sfidat me të cilat përballet: Bashkia përballet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit historik dhe kulturor përmes lehtësimin e procedurave dhe politikave fiskale të banorëve për vetëpunësim në këtë fushë, ruajtjen e banesave muzeale nga erozioni dhe zjarret, por dhe ndalimi i ndërtimeve pa leje në qendrën historike; Krijimi i mundësisë së integrimit të formave alternative të turizmit në zonat përreth qytetit, si ekoturizmi dhe turizmi i aventurës; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

Rëndësia e këtij auditimi është të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

Në zbatim të programit të auditimit nr.550/1 prot, datë 22.05.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Bashkinë Skrapar u ushtrua auditimi financiar për periudhën nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025, sipas drejtimeve:

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;
2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;
2.3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025;
2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve;

2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar*, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- *Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;*
- *Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;*
- *Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.*

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Skrapar si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":

Parimi 1: "Angazhimin për integritet dhe vlerat etike".

- Për vitin 2025 ka qenë në fuqi Rregullore e Brendshme miratuar me Vendimin nr. 15, datë 03.03.2020 të Kryetarit të Bashkisë Skrapar.
- Nuk dokumentohet trajnimi i burimeve njerëzore të rekrutuar gjatë vitit 2025 mbi rregulloren e brendshme, integritetin dhe etikën.
- Nuk dokumentohet procedura e ndjekur për komunikimin dhe njohjen e stafit të Bashkisë Skrapar për ndryshimet ligjore të ndodhura në fusha të ndryshme.
- Ka rregullore të posaçme për hetimin administrativ të sinjalizimit, por nuk dokumentohet nëse përgjatë vitit 2025 ka pasur raste të raportimit të korrupsionit për të vlerësuar linjën e raportimit, ankuesi, njësia përgjegjëse për sinjalizimi, titullari i institucionit dhe dokumentimi i procedurës së ndjekur për trajtimin e rastit.
- Ka proçes vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj.
- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në zyrën e integruar me një ndalesë), duke i'u adresuar strukturave të bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 15 të Rregullores së Brendshme.

Parimi 2: "Titullari demostron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".
- Për vitin 2025 nuk administrohet plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.
- Bashkia Skrapar zotëron aksione pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sh.A, duke pasur kompetenca mbikëqyrëse, nëpërmjet anëtarit të saj në Këshillin Mbikëqyrës. Për këtë mungojnë raportimet drejtuar Bashkisë Skrapar, mbi aktivitetin e ujësjellës-kanalizime.
- Për vitin 2025, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit të paraqitur pranë nivelit drejtues dhe këshillit bashkiak. Si rezultat i këtij procesi, raportimi fokusohet në ecurinë e veprimtarisë dhe performancës financiare të institucionit dhe më pak në drejtim të raportimit të arritjeve apo problematikave në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Veç sa më sipër, nuk dokumentohet raportimi nga çdo strukturë e bashkisë.
- Gjithashtu në rregulloren e brendshme, jo për çdo strukturë të Bashkisë Skrapar, përcaktohet afat për raportimin ndaj eprorit, mbi realizimin e planit të punës/objektivave.
Parimi 3: "Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë".
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar (Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore ka kaluar në nivel drejtorie).
- Në organizimin dhe funksionimin e NJAB Bashkia Skrapar, referuar rregullores së brendshme, nuk parashikohen detyrat për pozicionin e specialistit të auditit, por këto janë të përfshira në pozicionin e drejtuesit të NJAB.
- Në rregulloren e brendshme, por edhe me urdhër të titullarit, nuk ka të përcaktuar linja komunikimi ndërmjet drejtorive/sektorëve të ndryshëm të bashkisë, konkretisht Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me qëllim shkëmbimin e informacionit sa subjekte janë pajisur me leje ndërtimi/infrastrukture, si dhe nëse këta të fundit janë me seli kryesore në Bashkinë Skrapar apo duhet të pajisen me NIPT sekondar, duke vijuar me përfshirjen e tyre në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, si dhe tarifimin e tyre nga sektori i taksave dhe tarifave).
- Sa më sipër, në strukturën dhe rregulloren e brendshme, parashikohet inspektori i ushqimit, me kompetenca kontrolli në subjekte prodhuese dhe tregtuese të produkteve ushqimore, ndërkohë këto detyra sipas Ligjit nr. Nr.9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar dhe Ligjit Nr.10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i përkasin Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Drejtorive Rajonale të tij, si dhe Shërbimit Veterinar Zyrtar.
- Gjithashtu konstatohet anomali në strukturën e ndryshuar me Vendimin nr.44/1, datë 29.03.2024, për vitin 2024, ku Inspektori i Mbrojtjes së Territorit, është në varësi të Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit. Pra nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në varësi direkte nga organi ekzekutiv i bashkisë (pra Kryetarit të Bashkisë Skrapar). Kjo mënyrë e funksionimit të strukturës cenon pavarësinë në vendimmarrje, por edhe realizimin e të gjitha detyrimeve ligjore të fushës, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Në kuadrin rregullator, konkretisht në:

- Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i ndryshuar, neni 3, shkronja "a", neni 4, neni 5, përcaktohet se:

-"*Kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga: a) inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse*".
-"*Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.*
-Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse" – **Ndërkohë** sipas mënyrës së organizimit të strukturës respektive në Bashkinë Skrapar, në dukje drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

- Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",* neni 5, neni 19, neni 20 (në fuqi për periudhën objekt auditimi):

-"*Inspektori apo grupi i inspektimit, brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akt nënligjor, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret*".
-"*Organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore mbështet funksionimin efektiv të inspektoratit vendor. Kjo përgjegjësi nuk përfshin drejtimin operacional të veprimtarisë së inspektimit*".
-"*Kryeinspektori i inspektoratit përkatës është "eprori i drejtpërdrejtë" i inspektorëve, në kuptimin e këtyre dispozitave*".

-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 *"Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar,* por është vetëm Plani i Përgjithshëm Vendor.
- Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.
- Nuk administrohet raporti i vlerësimit nga NJAB për përputhjen e rregullores së brendshme me strukturën organike.

Parimi 4: "Njësia publike demostron angazhimin në realizimin e kompetencave".
- Në Bashkinë Skrapar nuk janë hartuar "Hartat e proçeseve të punës".
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e MFK-së, nuk është parashikuar dhe hartuar një program trajnimi, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet dhe zbatimin e kërkesave kryesore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit përveç trajnimeve që janë organizuar nga ASPA.
- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtori i Drejtorisë së Financës.
- Në Bashkinë Skrapar nuk është caktuar Koordinatori MFK dhe i Riskut.

Parimi 5: "Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale".
- Për vitin 2025, GMS është krijuar me Urdhrin nr. 49 datë 12.03.2021 dhe me nr. 764 prot., datë 12.03.2021 të Kryetarit të Bashkisë Skrapar.

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaximit Strategjik (GMS) rezultoi se:
- Bashkia Skrapar nuk ka miratuar plan pune vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik".

- Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Parimi 6: "Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre".
- Nga Bashkia Skrapar përcaktohen objektiva sasior (vlerë monetare) në hartimin e PBA-ve dhe buxhetet vjetore, dokumente të cilat publikohen në faqen zyrtare të Bashkisë Skrapar. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk është hartuar plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".*
- Nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i plan-veprime vjetore operacionale të miratuara, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate, dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.
Parimi 7: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave".
- Nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut, pasi nuk dokumentohet krijimi i grupit koordinues teknik të menaxhimit dhe raportimit të riskut për vitin 2025.
- Nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i strategjisë së menaxhimit të riskut.
- Nuk ka urdhër të titullarit të institucionit, ku çdo strukturë e Bashkisë Skrapar të identifikojë risqet, për hartimin e regjistrit të riskut, masat për eleminimin e efektit të tyre, si dhe nuk dokumentohet përditësimi i tij minimalisht 2 herë në vit.
-Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit.
- Në Bashkinë Skrapar, sektori i financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin Excel, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.
Parimi 8: "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime".
- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk janë përcaktuar procedura specifike të vlerësimit të riskut të mashtrimit. Nuk administrohen evidenca të monitorimit të riskut tek/nga menaxherët, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin e bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, e cila përbën risk për veprimtarinë e bashkisë.
Parimi 9: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".
- Bashkia Skrapar nuk ka marrë masa për të bërë ndryshimet në rregulloren e brendshme, përshkrimet e punës, sipas ndryshimeve në strukturë, ku sektorë të caktuar kanë kaluar në nivel drejtorie, si dhe funksione të një drejtorie kanë kaluar në një drejtori tjetër.

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Parimi 10: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli".
- Në rregulloren e brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proçeset e punës. Mbetet problematikë hartimi i hartave të proceseve të punës për çdo pozicion në strukturën e Bashkisë Skrapar.
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtoria e Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtoria e Financës, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa autorizimi i pagesës nga NA.
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e proçedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar,* në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.
- Në përgjithësi për proçedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjesimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, proçesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe proçesverbalet për asgjesimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.
- Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankave të nivelit të dytë në llogarinë e thesarit për Bashkinë Skrapar, si dhe veprimeve me arkën, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave (taksat e ndara) arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimor. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.
- Bashkia Skrapar në bashkëpunim me Degën e Thesarit Skrapar, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponilibiteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

Parimi 11: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshëm të kontrollit të teknologjisë".

- Bashkia Skrapar nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vetë të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.
- Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT.
- Në Bashkinë Skrapar nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.
- Në strukturën e Bashkisë Skrapar është vetëm 1 specialist IT, duke sjellë që i njëjti person të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI-së.

Parimi 12: "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe proçedurave".
- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.
- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listë-pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga përgjegjësi i sektorit. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e sektorit të financës.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Parimi 13: "Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor".
Bashkia Skrapar disponon faqen e saj zyrtare në web www.bashkiaskrapar.gov.al ku pasqyrohet aktiviteti i saj si rregullorja e brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Mungojnë raporte periodike dhe të përditësuara për përformancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, raporte të auditimit, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, rregulloren e brendshme etj.

Parimi 14: "Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor".
- Përsa i përket raportimit të informacionit të përpunuar, evidentohet se përgatiten për menaxhimin/drejtuesit, raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) të njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me eficiencë dhe efektivitet, por nuk rezulton që të ketë një bazë rregullative që të përcaktojë llojet e raportimit dhe periodicitetin e tyre, si dhe raporte mbi aktivitete të tjera të institucionit. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

Parimi 15: "Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm".
- Për vitin 2025 nga Bashkia Skrapar (për vendimmarrje për dhënien e pasurive të paluajtshme me qira, buxhetin etj) janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Parimi 16: "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme".
- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë,

por nuk administrohen plotësisht raportimet e të gjithë drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të eficiencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.
- Bashkia Skrapar lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë për vitin 2025 e ka raportuar në MFE, me shkresën nr.1008 prot., datë 30.03.2026. Deklarata e cilësisë dhe raporti i vetëvlerësimit nuk është përcjellë brenda afatit ligjor[4].
- Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2025.
- Nuk ka rregulla të brendshme për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Parimi 17: "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë".
- Sipas kontakteve me menaxhimin nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm.

Bazuar në auditimin e kryer për zhvillimin dhe funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Skrapar për vitin 2025, janë evidentuar devijime të nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi për fushën e kontrollit të brendshëm të cilat në gjykimin profesional të grupit të auditimit ndikojnë në progresin e funksionimit të këtij sistemi dhe justifikojnë paraqitjen e një konkluzioni për vlerësimin e kryer, duke e vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm pjesërisht efektiv.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
1. z. A. M, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë.
2. znj. R. Ll, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve.
3. z. N. G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm

Në zbatim të programit të auditimit, u audituа dokumentacioni si më poshtë:
1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Skrapar;
2. Plani Strategjik 2025-2027, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2025;
4. Raportimi vjetor në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

[4] Udhëzim nr. 2, datë 26.1.2024 mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik",* është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë vitit 2025, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të Vendimit nr.44/1, datë 29.03.2024 *"Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Skrapar, të Njësive Shpenzuese në varësi të saj për vitin 2024, si dhe miratimin e kategorive/klasave të pagave për pozicionet e shërbimit civil",* të ndryshuar, si dhe ka pasur 1 punonjës përkatësisht, përgjegjësi i sektorit znj. D S.

Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryej auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Skrapar, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

Tabelën nr.1: Paraqitet struktura e Sektorit të Auditit të Brendshëm, si vijon:

Nr	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikim	Trajnime te vijueshme
	Për vitin 2025							
1	D S	P/Njësisë	01.02.2016	Finance	36	10	Jo	3 trajnime

Burimi: NJAB Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

<u>Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e NJAB për vitin 2025.</u>

Viti 2025, plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr.3387/1 prot., datë 15.10.2024, sipas të cilit janë planifikuar për t'u audituar 6 auditime, realizuar 6, pasqyruar si më poshtë:

Tabelën nr.2: Plani i auditimeve për vitin 2025

Nr	Subjekte të Audituara 2025		
	Planifikuar	**Realizuar**	**Niveli i riskut**
1	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve	Po	I lartë
2	Ndërmarrja e shërbimeve publike	Po	I mesëm
3	Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave	Po	I lartë
4	Drejtoria Taksave Tarifave Vendore	Po	I mesëm
5	Drejtoria Juridike	Po	I lartë
6	Detyrimet e prapambetura	Po	I lartë

Burimi: NJAB Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabelën nr.3: Raportimi i auditimeve të kryera

Nr	Periudha	Të Dhëna Sipas Raportimit								
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit						
				Perputh	Financ	Kombinuar	Performace	Tematik	Teknologjisë së informacionit	Zbatim Rekomandime
1	Viti 2025	6	6	5						1

Burimi: NJAB Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Plani strategjik 2025-2027 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.3387 prot., datë 15.10.2024.

-Për aktivitetin e vitit 2025 është raportuar pranë Ministrisë së Financave me shkresën nr.391 prot., datë 11.02.2026.

Nga auditimi i raportimit për vitin 2025, rezulton se janë dhënë 26 rekomandime gjithsej, nga të cilat janë zbatuar 5 prej tyre ose 19.2%, në proces zbatimi 13 ose 50%, pa zbatuar 8 ose 30.8%, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabelën nr.4: Raportimi i rekomandimeve të lëna

Nr	Periudha	Të Dhëna Sipas Raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2025	26	5	13	8	0	-	-	-

Burimi: NJAB Skrapar, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me nenin 12, shkronja "b" dhe nenin 13 në Ligjin nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;*

-Për vitin 2025, numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"*, të ndryshuar, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë ka qenë vetëm 1 punonjës;

-Përgjegjësi i NJAB Skrapar nuk është i certifikuar si "Auditues i brendshëm në sektorin publik" në kundërshtim me shkronjën "b" pika 2 në nenin 11 në Ligjin nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;*

-Për periudhën 2025, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim sisteme që kryen Bashkia Skrapar, me risk të lartë, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm *"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit".*

-Nuk pasqyrohet metodologjia e vlerësimit të riskut për sistemet. Konkretisht në një dokument "Excel" pasqyrohet vlerësimi i tyre sipas shkallëve të riskut "I lartë", "I mesëm" dhe "I ulët", por nuk pasqyrohet metoda e ndjekur për klasifikimin sipas shkallëve të riskut.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 *"Për arkivat" dhe nenin 19 pika 1 të Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë;*

-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, në kundërshtim me paragrafin 6.3, Kreun 6 të Manualit të Auditimit të Brendshëm;

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar;

-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2025 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën "ç" të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, *"Për Auditin e Brendshëm Publik",* i ndryshuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve;

-Nuk sigurohet zbatimi i parimit të përcaktuar në shkronjën "c" të nenit 7 në Ligjin nr. 114/2015, *"Për Auditin e Brendshëm Publik",* i ndryshuar, pasi në veprimtarinë audituese i njëjti person planifikon, organizon, auditon, kontrollon cilësinë e auditimit dhe njëkohësisht raporton.

Në dosjet e përzgjedhura për auditim, u konstatua se:

1. **Në dosjen e auditimit në Drejtorinë Juridike, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, sipas dokumentit standard vlerësimit të riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit rezulton se është vlerësuar me risk të mesëm, ndërkohë në vlerësimin e riskut nga NJAB në planin vjetor, rezulton me risk të lartë, pra ka një mospërputhje në vlerësimin e riskut; Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, rezulton se nuk është sipas formatit standard 4, kapitulli IV në manualin e auditimit të brendshëm të ndryshuar; Nuk administrohet dokumenti sipas formatit standard 6 "Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"; Formati standard 9 "Testet individuale të Auditimit të Brendshëm"; Raporti i auditimit nuk është sipas formatit standard të përcaktuar në manualin e auditimit të brendshëm, pika 4.1.12.
2. **Në dosjen e auditimit në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, Sektori i Planifikimit dhe Zbatimit të Buxhetit**, sipas dokumentit standard vlerësimit të riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit rezulton se është vlerësuar me risk të mesëm, ndërkohë në vlerësimin e riskut nga NJAB në planin vjetor, rezulton me risk të lartë, pra ka një mospërputhje në vlerësimin e riskut; Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, rezulton se nuk është sipas formatit standard 4, kapitulli IV në manualin e auditimit të brendshëm të ndryshuar; Nuk administrohet dokumenti sipas formatit standard 6 "Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"; Formati standard 9 "Testet individuale të Auditimit të Brendshëm"; Raporti i auditimit nuk është sipas formatit standard të përcaktuar në manualin e auditimit të brendshëm, pika 4.1.12.
3. **Në dosjen e auditimit në Drejtorinë e Tatim Taksave**, vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, rezulton se nuk është sipas formatit standard 4, kapitulli IV në manualin e auditimit të brendshëm të ndryshuar; Nuk administrohet dokumenti sipas formatit standard 6 "Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit"; Formati standard 9 "Testet individuale të Auditimit të Brendshëm"; Raporti i auditimit nuk është sipas formatit standard të përcaktuar në manualin e auditimit të brendshëm, pika 4.1.12.

Baza Ligjore:

-Neni 7, neni 11, neni 12, neni 13 të Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;*

-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik";*

-Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "*Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016";*

-Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 *"Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik";*

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar; Kapitulli III "Plani i auditimit duhet të përgatitet mbi bazë risku – e thënë ndryshe auditimi i brendshëm fokusohet në ato sisteme/fusha ku gjërat ka të ngjarë të mos bëhen siç duhet ose siç janë parashikuar", Kapitulli III, pika 3.1.6; Kreu 4.1.13.1;

<u>Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:</u>

-Për vitin 2025 nuk janë përfshirë dhe nuk janë audituar fusha të vlerësuara me risk të lartë.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

-Nuk zbatohen Standardet Globale të Auditit të Brendshëm (GIAS).

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. z. A. M, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë.
2. znj. D. S, në cilësinë e Përgjegjës të Zyrës së Auditimit të Brendshëm.

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
2.2.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;
2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
2.2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
2.2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

2.1.1 Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së 2025-2027 dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezulton se:
-Bashkia Skrapar ka paraqitur në Këshillin Bashkiak ***"Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027"*** i cili është miratuar me VKB nr.42, datë 15.12.2023 *dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr.889/1 prot, datë 24.12.2024.*
-Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është **ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik** (GMS) për PBA 2025-2027 me Urdhrin nr. 49 datë 12/03/2021.
-**Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme** është miratuar me VKB nr.9, datë 27.02.2024 paraqitur në Këshillin Bashkiak. Vlerësimi i të ardhurave është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuar në pikën 58 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
-**Tavanet Buxhetore** për PBA 2025-2027 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.18, datë 27.03.2024 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 239/1 prot., datë 02.04.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 63 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
-Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar në kundërshtim me pikën nr. 64 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".* Kryetari i Njësisë Vendore 5 ditë pas miratimit të tavaneve buxhetore duhet të miratoj udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë dhe duhet ta shpërndaj atë.
Përgatitja e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm:
- Bashkia Skrapar nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave projektdokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm në kundërshtim me pikën nr. 74 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*
Projektdokumenti i fazës së parë të PBA 2025-2027 nuk është paraqitur në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë në kundërshtim me pikat nr. 75 dhe 76 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

- **Tavanet përfundimtare** të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr.39 datë 25.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.536/1 prot., datë 30.07.2024 në kundërshtim me ligjin nr.68/2017, neni 37, pika 1 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* dhe udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 79 "*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim, brenda datës 15 korrik, tavanet përfundimtare në Këshillin e Njësive Vetëqeverisjes Vendore. Këshilli miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 korrik".*

- Faza e dytë e PBA 2025-2027

Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak në kundërshtim me udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 82* " *Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit gjatë periudhës 1-15 shtator Procesverbalet e takimeve së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, behën pjesë e dokumentit të projektit të PBA".*

Pika 84 "Pas reflektimit të sugjerimeve brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dokumentin e PBA të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësisë, së bashku me informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë".

- Faza e dytë e PBA 2025-2027 nuk është miratuar me VKB në kundërshtim me pikën nr. 81, 82 të Udhëzimit nr.23, datë 30.12.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

PBA 2025-2027 dhe buxheti i vitit 2025 është miratuar me VKB nr. 68, datë 20.12.2024 për Bashkinë Skrapar. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Tabela 5: Programimi i shpenzimeve për vitin 2025-2027 Bashkia Skrapar dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
		000/lekë	000/lekë	000/lekë
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110)	117,707	108,639	108,575
2	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (03280)	42,942	42,495	42758
3	Bujqesia dhe Ushqimi (04220)	3,958	3,958	3,958
4	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (04240)	16,996	17,,393	17,393
5	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave (04260)	23,007	23,007	23,007
6	Rrjeti rrugor rural (04520)	59,882	49,997	59,229
7	Menaxhimi i mbetjeve (05100)	26,265	26,465	26,465
8	Planifikimi Urban Vendor (06140)	10,702	13,062	13,062
7	Shërbimet Publike vendore (06260)	48,322	50,696	50,796
	Sporti dhe Argëtimi (08130)	5,521	18,101	18,301
8	Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat (08220)	9,252	9,102	9,302
9	Arsimi parashkollor përfshirë dhe arsimin bazë (0912)	69,537	77,313	77,813
10	Arsimi i mesëm i përgjithshëm (09230)	24,248	28,985	29,235
11	Përkujdesje Sociale fëmijët (10430)	17,705	18,305	18,305
12	Fonde Rezervë	600	600	600
13	Fond Emergjence	600	600	600
Totali		**477,244**	**488,717**	**499,398**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela 6: Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000/lekë

Nr	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	295,099	61.8	303,851	62.2	303,851	60.8
2	Sigurime (601)	49,281	10.3	50,752	10.4	50,752	10.2
3	Shpenzime operative (602)	85,605	17.8	85,264	17.4	86,283	17.3
4	Shpenzime (603)	-	-	-	-	-	-
5	Shpenzime (604)	8,932	1.9	8,435	1.7	8,698	1.7
6	Shpenzime (606)	-	-	-	-	-	-
7	Shpenzime (609)	1,200	0.25	1,200	0.24	1,200	0.24
8	Shpenzime për investime (230-231)	37,126	7.8	39,215	8	48,614	9.7
TOTALI		**477,244**	**100**	**488,717**	**100**	**499,398**	**100**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela 7: Sipas PBA 2025-2027 Bashkia Skrapar tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:**

A	Të ardhurat	2025	2026	2027
1	Të ardhura të trashëguara	-	-	-
I	**Totali**	-	-	-
1	Nga taksat	104,301	105,885	106,281
II	**Totali**	**104,301**	**105,885**	**106,281**
1	Transferta e pakushtëzuar	172,599	181,966	191,719
2	Transfertë specifike	163,812	164,333	164,865
3	Transfertë për rritje page	36,531	36,531	36,531
III	**Shuma e transfertave**	**372,942**	**382,830**	**393,115**
Totali I burimeve të veta (I +II+III)		**477,243**	**488,715**	**499,396**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2025.

Për vitin 2025, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr.68, datë 20.12.2024, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 892/1 datë 27.12.2024.

Sipas VKB nr. 68 *"Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025"* rezulton se të ardhurat nga burimet e vete të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën **104,301 mijë lekë**, transferta e pakushtëzuar ka vlerën **172,599 mijë lekë**, transferta specifike ka vlerën **163,812 mijë lekë** dhe transfertë për rritje page ka vlerën **36,531 mijë lekë.**

I detajuar planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2025 paraqitet në vijim:

Tabela 8: Të dhënat mbi buxhetin fillestar

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar i vitit 2025	
		Të ardhurat	Shpenzimet
1	Transferta e pakushtëzuar	172,599	-
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	163,812	-
3	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë	104,302	-
4	Transfertë për rritjen e pagave	36,531	-
1	Shpenzime për paga (600)	-	295,099
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601)	-	49,281
3	Shpenzime operative	-	85,605
4	Subvencione (603)	-	-
5	Transferta (604+606)	-	8,932
6	Fondi rezervë+Fondi I kontigjencës (609)	-	1,200
7	Shpenzimet kapitale (230+231)	-	37,126
8	Principali+Interesi I kredisë (166+651)	-	-
Total		**477,244**	**477,244**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Rezulton se buxheti i konsoliduar është miratuar i balancuar dhe pa deficite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **477,244 mijë lekë**.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2025 është bërë si vijon:
Gjatë vitit 2025 sipas VKB Nr.68, datë 20.12.2024 janë parashikuar shpenzime kapitale në vlerën 37,126 mijë lekë të cilat do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar.
-Likuidime për investime të përfunduara për të cilat janë akumuluar detyrime të prapambetura është parashikuar të likuidohet shuma 0 mijë lekë. Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2025 janë në vlerën 37,126 mijë lekë.
Tabela 9: Investimet e parashikuara për periudhën 2025-2027 me mbulim nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta.

000 lekë

Nr	Emri i programit/objektit	Origjina e te ardhures	2025	2026	2027
1	Fonde për hartim projektesh	Te ardhurat(05)	4,000	6,000	6,000
2	Blerje autovetura për nevoja të Bashkisë Skrapar	Te ardhurat(05)	3,000	-	-
3	Investime në segmented rrugore të Bashkisë Skrapar	Te ardhurat(05)	30,126	7,573	14,341
Total Investime			**37,126**	**13,573**	**20,341**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.
Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për
funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.
Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.
-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.
Gjatë vitit 2025 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë.

Në aneksin 2/2/1 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela me të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit dhe ndryshimet për vitin 2025 sipas VKB-ve.
Në aneksin 2/2/2 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela me të dhënat përmbledhëse për planifikimin e buxhetit sipas burimeve të të ardhurave dhe ndryshimet për vitin 2025 dhe ndryshimet sipas VKB-ve.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.
Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Skrapar, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv buxhetor, të miratuar me Vendim të KB, apo nga ndryshimet e transfertave të pakushtëzuara sektoriale nga pushteti qendror, nga auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Skrapar, u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.
Në aneksin 2/2/3 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur informacioni për realizmin e buxhetit të Bashkisë Skrapar dhe Njësive shpenzuese të tjera.

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit:
Për **vitin 2025** fondet buxhetore janë realizuar 545,274 mijë lekë nga 465,607 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 85%. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:
Shpenzimet për investime llog. 230-231 janë realizuar ne masën 66%.
Shpenzimet për investime llog. 602 janë realizuar ne masën 79%.

-Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Për **vitin 2025** janë **planifikuar** fonde për investime nga të ardhurat e Bashkisë Skrapar në shumën ***70,135 mijë lekë*** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura) dhe janë ***realizuar në vlerën 46,417 mijë lekë, ose në masën 66%***.

Tabelë nr.10: Tabela e përgjithshme e buxhetit (shpenzimet) e përmbledhur:

Në 000/lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2025	Plani përfundimtar 2025	Plani i çelur 2025	Realizimi i shpenzimeve 2025	% e realizimit/ planit vjetor
Shpenzime për paga (600)	295,099	305,794	293,759	288,033	94.2%
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	49,281	51,081	49,114	47,816	97.3%
Shpenzime operative (602)	85,605	97,077	85,175	77,322	90.8%
Subvencione (603)	-	-	-	-	-
Transferta tek organizatat (604)	50	170	170	162	95.3%
Transferta tek individët (606)	0	2,665	2,665	2,324	87.2%
Fondi rezervë+e kontigjencës (609)	1,200		-	-	
Fondi e Emergjences	8,882	10,490	3,964	3,533	89.1%
Shpenzime për Oponenca teknike, Projekte (230)	4,000	6,412	6,174	3,398	55%
Shpenzime për Investime (231)	33,126	63,724	46,603	43,019	92.3%
(1) Total Aparati i Bashkisë Skrapar	**477,243**	**537,413**	**487,624**	**465,607**	**86%**
(2) Fonde të kushtëzuara	**160,149**	**160,149**	**160,149**	**158,639**	**99%**
a. Nga te ardhurat e transf e pakushtez, specifike 600,601 606	128,617	128,617	128,617	127,108	98.8%
b. Nga Ministritë linjës Investime	31,532	31,532	31,532	31,530	100%

Total Bashki + Institucione	**637,392**	**698,764**	**647,775**	**624,247**	**96.37%**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Në aneksin 2/2/4 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela e investimeve të financuara gjatë vitit 2025 me të ardhurat e veta.
Në aneksin 2/2/5 në anekset e raportit të auditimit është paraqitur tabela e investimeve të financuara gjatë vitit 2025 nga buxheti i shtetit.

Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Skrapar së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar.
Për vitin 2025 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 537,413 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 465,607 mijë lekë, ose në masën 86 %.
Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 investimet me të ardhurat e veta janë planifikuar në vlerën 70,035 mijë lekë, realizuar 46,317 mijë lekë, ose në masën 66%
Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Skrapar në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku thuhet:
"*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji".*

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë.

a. Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

Për vitin 2025 fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës është planifikuar në total në shumën 1,200 mijë lekë, i cili është miratuar në buxhetin fillestar me VKB nr. 68 datë 20.12.2024 *"Për miratimin e buxhetit vjetor 2025 dhe PBA 2025-2027"*, dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 892/2 datë 27.12.2024.

b. Fondet e emergjencës.

Për vitin 2025 nga Ministria e Mbrojtjes, (AKMC), *"Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"* Bashkisë i është akorduar *fondi në vlerën 3,558 mijë lekë.*
Fondi i emergjencave është planifikuar me VKB nr. 68 datë 20.12.2024, është bërë miratimi i përdorimit të fondeve të lira të paraqitura **në tabelën nr.11**:

Në lekë

Nr.	Emërtimi I shpenzimeve	Shuma e planifikuar	Përdorimi	Mbetja
1	Shpenzime për blerje materiale për rehabilitimin e segmenteve rrugore te dëmtuara nga rreshjet	2,558	2,558	0
2	Kompensim demi ne banesa	1,000	1,000	0
Total		**3,558**	**3,558**	**0**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit

Për vitet 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"* pikat 10, 12, 28, 29, 48.

Për vitet 2025 janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 6 dhe me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" pikat 10, 12, 28, 29, 48.

Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara si më poshtë:
"Raport monitorimi Janar-Prill 2025" me e-mail datë 30.05.2025.
"Raport monitorimi Janar-Gusht 2025" me e-mail datë 30.09.2025.
"Raporti i monitorimit Janar-Dhjetor 2025" me e-mail datë 27.02.2026.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve:

Bashkia Skrapar në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 11,132 mijë lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2025 është planifikuar për likuidim vlera 0 mijë lekë si mëposhtë.

Tabela nr. 12: Informacion për planifikimin e likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës viti 2024	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602+606	Llog. 230+231
Viti 2025	11,132,082	-	VKB nr.68 date 20.12.2024	-	-

Burimi: *Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit*

Gjatë vitit 2025 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 50,435 mijë lekë dhe janë likuiduar detyrime në vlerën 23,860 mijë lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datë 31.12.2025 është në vlerën 38,300 mijë lekë.

Tabela Nr. 13: Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2025:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2024	Detyrimi i krijuar në periudhën 01/01/2025 – 31.12.2025	Total detyrime	Shlyerja e detyrimeve 2025	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2025
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH	595,320	44,618,302	45,213,622	21,265,757	23,947,865
b. Investime nga Bashkia	1,200	4,446,586	4,447,786	0	4,447,786
INVESTIME:	**596,520**	**49,064,888**	**49,661,408**	**21,265,757**	**28,395,651**
Mallra shërbime, mirëmbajtje	6,589,445	1,370,400	7,959,845	2,094,900	5,864,945
Vendime gjyqësore	1,472,287	0	1,472,287	-	1,472,287
Shpronësime	2,467,950	0	2,467,950	500,000	1,967,950

Transferta Subjekte	600,000	0	600,000	0	600,000
Totali pa fondet e kushtezuara	**11,132,082**	**5,816,986**	**16,947,868**	**2,594,900**	**14,352,968**
Totali	**11,726,202**	**50,435,288**	**62,161,490**	**23,860,657**	**38,300,833**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2025 janë të palikuiduara gjithsej fatura me vlerë 38,299 mijë lekë**.**

Në aneksin 2/2/6 në anekset e raportit të auditimit paraqiten detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2025.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2025 të paraqitura në Ministrinë e Financave me shkresën nr.1364 prot., datë 04/03/2026 jepen në tabelën si më poshtë:

Tabela Nr. 14: Stoku i borxhit i raportuar në MFE

Në lekë

		Viti 2025		
Nr	**Emërtimi**	**Stoku në vlerë ne fund te vitit 2025**	**Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në**	**Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së**
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a.2	Tituj të emetuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b.2	Tituj të emetuar			
b.3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**17,090,196**		**3.67**
Llogaria ekonomi	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore	1,472,287		
4864200	Det.Prap. Sherbime	340,432		
4864201	D.P.Eneri Elektirke			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	5,25,003		
4864400	Det.Prap. Investime	4,447,786		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	3,008,738		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime	1,967,50		
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet	600,000		
III	**Totali (I+II)**	**17,090,196**	**465,607,985**	**3.67**

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela Nr. 15: Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

	Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025	**Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2025**	**Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025**	**Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë gjatë vitit 2025**	**Pagesa në lekë të kryera gjatë vitit 2025**	**Detyrimi në lekë më 31.12.2025**

Dëmshpërblim page për punonjësit e larguar nga puna		1,472,287	0	0	0	1,472,287
Te tjera	-	-	-	-	-	-

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, përpunuar nga grupi i auditimit

Në aneksin 2/2/7 në anekset e raportit të auditimit paraqiten lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për mbi pagesat e vendimet gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme viti 2025.

Gjatë vitit 2025 janë shpenzuar 216,052 lekë për 1 (një) vendim gjyqësore. Fondet e shpenzuara janë nga të ardhurat e veta të Bashkisë Skrapar.
Vlera totale **216,052 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2025 nga Bashkia Skrapar, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.**
Bashkia Skrapar në fund të vitit 2025 ka detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 1,472,827 lekë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
1. z. A. M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Skrapar.
2. z. N. G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

2.5. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor.

- **<u>Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:</u>**

Për vitin 2025 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Vendimin nr.6, *"Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Skrapar dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025"*, i ndryshuar, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, e cila sipas strukturës është e përbëre nga sektorë dhe në total ka 13 punonjës, ku 1 (një) është Drejtori për Taksat dhe Tarifat, 1 (një) është specialiste vlerësimi, maturimi të të ardhurave, 2 (dy) janë specialist për të ardhurat, 2 (dy) janë inspektorë tatim taksave, 1 (një) është Inspektore tregu, 8 (tetë) janë specialistë për taksat dhe tarifat në Njësitë Administrative, respektivisht aneksi si vijon:

Tabelën nr. 16: Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni
1	H B	Drejtor Tatim Taksave
2	A L /E L	Specialiste e të Ardhurave deri në dt.30.06.2025 / nga dt.01.07.2025
3	B Ç / E Dh	Inspektore Tatim taksave deri në datë 15.10.2025 / nga data 16.10.2025
4	N D	Specialiste Vlerësimi, Maturimi të të ardhurave
5	A L	Inspektore tregu
6	G H	Insp.T-Taksave Nj.Adm.Qendër
7	K M	Insp.T-Taksave Nj.Adm.Bogovë
8	A M	Insp.T-Taksave Nj.Adm.Vëndreshë
9	I G	Insp.T-Taksave Nj.Adm.Çepan
10	E O	Insp.T-Taksave Nj.Adm.Potom
11	L B	Insp.T-Taksave Nj.Adm.Leshnje
12	F F	Insp.T-Taksave Nj.Adm.Gjerbës
13	K A	Insp.T-Taksave Nj.Adm.Zhepë

Burimi: Bashkia Skrapar

-Konstatohet se: strukturat e Bashkisë Skrapar ka probleme dhe nuk është në funksion të realizmit e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm në Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, Bashkia Skrapar, pasi evidentohet se

një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitorë), për 5,374 abonentë familjarë në vlerën ***109,677 mijë lekë*** *dhe 56 subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 11,577 mijë lekë.* ***Në total debia në fund të vitit 2025 është 121,255 mijë lekë.***

- **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:**

Për vitin 2025, Bashkia Skrapar nuk ka miratuar paketë të re fiskale por ka ushtruar aktivitetin me paketën fiskale të vitit 2022, e ndryshuar, me VKB nr.31, dt.23.11.2023, e konfirmuar nga Prefekti. Nga të dhënat e tabelës nr.2 më poshtë, shihet se për vitin 2025 të ardhurat nga 76,863 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 60,819 mijë lekë ose 79%, për shkak të mosrealizimit në zëra të veçantë si, taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhura nga pronësia etj.

-Bazuar në VKB nr.31, dt.23.11.2023 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Skraparit"* i ndryshuar, janë përcaktuar në mënyrë specifike drejtoritë përgjegjëse dhe pesha e tyre specifike në planifikimin e të ardhurave dhe mbledhjen e tyre si më poshtë:

Tabela nr.17: Drejtoritë përgjegjëse dhe pesha e tyre specifike.

Nr	Strukturat përgjegjëse	Në %	Plani në 000/lekë
1	Agjentet Tatimore	7%	46,509
2	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave	57%	356,088
3	Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve	7%	41,129
4	Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve	13%	80,000
5	Drejtoria Bujqësisë, Administrimit te Pyjeve, Ujerave dhe Shërbimit Veterinar	11%	68,547
6	Tarifa te Drejtorisë Ekonomike te Arsimit	3%	20,010
7	Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes	0%	24
8	Te ardhura nga MZSH	0%	324
9	Agjencia e shërbime publike	2%	9,526
10	Të tjera	1%	4,033
Total		**100%**	**626,191**

Burimi: Bashkia Skrapar

Për vitin 2025, ka pasur mos realizim në vlerën 16,000 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit.

Nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave drejtori që mbulon një pjesë të taksave dhe tarifave vendore, rezultoi se faktorët kryesorë të mosrealizimit për taksat që ata ngarkohen nga VKB – ja janë:

- Niveli ekonomiko-financiar i familjeve;
- Emigrimi dhe migrimi;
- Probleme të pronësisë.

Edukimi fiskal i komunitetit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore. Komuniteti nuk është ndërgjegjësuar për pagesën me vullnet të lirë të detyrimeve vendore.

Për periudhën e audituar, evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga: Kryetari i Bashkisë z. A. M, Drejtori i Financës z. N. G, znj. E. L si dhe z. D. B, në cilësinë e përgjegjësit të Degës së Thesarit Skrapar.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Skrapar, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2025 janë paraqitur të detajuara në:

Tabela nr.18: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2025. Në 000/lekë

Emërtimi	Plan 2025	Fakt 2025	Realizimi në %
Të Ardhura Tatimore	**25,932,120**	**14,117,926**	**54**
Taksa mbi Bize Vog {T.TH.Fitimi}	20,000	20,000	**100**
Taks mbi Pasurin e Paluajtshme	**19,356,370**	7,655,521	**40**
Taksa mbi ndertësat	**8,881,791**	3,041,194	**34**
- Nga subjektet	1,468,549	1,308,618	**89**
- Nga familjaret	7,413,242	1,732,576	**23**
- Nga Institucionet	0	0	

Takse mbi truallin	2,091,699	826,604	**40**
Taksa mbi Tokën Bujqësore	**8,382,880**	**3,787,723**	**45**
Taksa e ndikim infrast nga legalizime& nd.reja	650,000	81,894	**13**
Taksa për zenien e hapësires publike	30,000	36,600	**122**
Taksa e regjistrim automj.(DRSHTR)	**5,600,000**	**6,103,584**	**109**
Taksë tabele	**240,750**	169,450	**70**
- Nga subjektet fizike	0	0	
- Nga transporti	0	0	
- Nga subjek.juridik gjuh huaj	0	0	
- Nga subjek.juridik gjuh shqip	240,750	169,450	**70**
Takse fjetje ne hotel	65,000	43,575	**67**
Renta Minerare	20,000	706	**4**
Takse e kalim.drejt. Pronesise	0	6,596	
Takse Prone Pyll Kullote	0	0	
Te Ardhura Jotatimore	**43,525,674**	**40,934,702**	**94**
Tarifë Pastrimi	**13,566,633**	12,909,411	**95**
- Nga familjaret	1,938,300	1,061,510	**55**
- Nga subjektet	9,932,333	10,324,984	**104**
- Nga institucionet	1,468,000	1,468,000	**100**
- Nga firmat e ndertimit	150,000	500	
- Nga transporti	78,000	54,417	**70**
Tarifë Ndriçimi	**2,410,500**	1,971,200	**82**
- Nga familjaret	1,095,500	602,000	**55**
- Nga subjek. e firma ndert.	1,012,000	1,094,950	**108**
- Nga institucionet	210,000	210,000	**100**
- Nga transporti	93,000	64,250	**69**
Tarifë Gjelberimi	**1,750,000**	1,423,180	**81**
- Nga familjaret	601,000	306,900	**51**
- Nga subjek e firma ndert.	983,500	979,780	**100**
- Nga institucionet	70,000	70,000	**100**
- Nga transporti	95,500	66,500	**70**
T. zenie hapes. Publike(a+b)	**713,000**	698,533	**98**
a-Takse tregu	400,000	483,650	**121**
b-T. park. Automjet.(1b+2b)	**313,000**	214,883	**69**
1b- Nga inspektor i tregut	170,000	101,800	**60**
2b- Nga transporti	143,000	113,083	**79**
Tatim nga te ardhurat personale 2%	5,000,000	6,552,646	**131**
Miremb. Infrastrukture	5,957,533	5,282,882	**89**
Tarif Sherbimi (dosje ndihme ekon)	226,000	117,150	**52**
T.dru zj+l.ndert.	3,126,400	2,201,050	**70**
T.kullotje, gjeth(T-prone pyll ekullote)	1,076,750	889,160	**83**
Qira F.Pyjor	0	30,000	
Tarife Regjistrimi ne Konvikt	42,000	0	**0**
Leje Transporti	21,858	81,838	**374**
Të ardhura nga çerdhe	580,000	490,873	**85**
Të ardhura nga konvikti	300,000	310,953	**104**
Të ardhura nga kopshti	550,000	643,210	
Të ardh.Sherb.Publik(Sh.Funerali)	500,000	540,500	**108**
Të ardhura nga Q.K.F.	0	0	
Të ardh. nga gjobat e ndryshme	100,000	71,064	**71**
Dokum. Tenderi(Dosj.Nd/ekon)	0	22,350	
Te ardhura Detyrime të Prapambetura	2,500,000	2,031,591	**81**
Leja ndertimi	200,000	266,500	**133**
Te Tjera te paspecifikuara	**3,098,000**	2,431,814	**78**
-Qira ndertese {Banimi)	298,000	93,850	**31**
-Qira fond pyjor kullosor	2,500,000	2,306,394	**92**
-TE ARDH. NGA Z.GJ.CIVILE	0	20,000	
-SPOSORIZIME (FOND.BESA)	250,000	0	
-LICENSE MMZ	50,000	48,000	**96**
- Shtypshkrime	0	6,350	
Qira Trualli	648,000	235,958	**36**
Qira Ndertese zyra arsimore	114,000	101,100	
Qira Lokali	120,000	90,000	**75**
Dhenie mjete me qera	150,000	0	**0**
Te Tjera	500,000	0	**0**
Te ardhura te tj nga shitja e mallrave	0	3,600	

Kamatë vonese	50,000	262,223	**524**
Tarife vaditje	75,000	0	**0**
Tarife për linja ajrore	100,000	0	**0**
Çdemtime &sekuestrime		1,155,736	
T.prone pyll kullote	50,000	0	
TOTALI T-Tarifa	**69,457,794**	**55,052,628**	**79**
a-Nd/Sherb.pyjor	7,404,900	5,766,295	**78**
Totali Bashkia	**76,862,694**	**60,818,923**	**79**

Burimi: Bashkia Skrapar

Referuar pasqyrës më sipër, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situatës dhe moskryerjes së rregullt të procedurave, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Skrapar, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.

- **<u>Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:</u>**

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Skrapar, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja*,) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Skrapar dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Skrapar. Gjithashtu Bashkia Skrapar, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të paarkëtuara apo të shmangura sipas Në nenin 117[5]të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, "*Për Procedurat Tatimore*", ku parashikohet se "*Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*".

Nga Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Skrapar, konstatohet se mos arkëtimet janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Skrapar është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Skrapar duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

-Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

-Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e

[5] *"Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangur."*

Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 7 "*Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*" dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 15 "*Parapagimi*", si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 "*Për taksat Kombëtare*"
Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në:

Tabelën nr. 19: Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë. *Në lekë*

Agjenti Tatimor	**Lloji I Taksës**	**2025**
Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	20,000
Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	6,552,646
Drejtoria Rajonale të Shërbimeve te Transportit Rrugor	Taksa e mjeteve të përdorura të transportit	6,103,584
Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar Sh.a	Tarifat/ gjelbërim, ndriçim, pastrim, arsimi, ndërtesa	0
Dega e Doganës	Taksa e rentës minerare	706
Agjensia Shtetërore e Kadastrës	Takse e kalimiti te drejtës se pronësisë	6,596
Totali		12,683,532

Burimi: Bashkia Skrapar

- **Detyrimet e familjarëve:**

- *Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve*

Tarifa e shërbimit për familjarët parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të bashkisë.
Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.
Nga auditimi u konstatua se Bashkia Skrapar nuk ka lidhur kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Skrapar për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë.

- ***Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese***

Shërbimi për familjet ofrohet në zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.
Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.
Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.
Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.
Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2025 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjar në vlerën **109,677 mijë lekë.**

Tabela nr.20: Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore të ndara sipas rajoneve dhe Njësive administrative si vijon:

Nr.	**Emërtimi Nj.Vendore**	**Gjendja 31.12.2024**	**Shtesa të Debisë 2025**	**Pakësime të Debisë (Pagesa)**	**Gjendja 31.12.2025**
1	Nj. Çorovodë	28,608,208	5,449,608	491,821	33,565,995
2	Nj.Adm.Qendër	16,336,608	5,209,500	3,950,980	17,595,128

3	Nj.Adm. Bogovë	15,363,637	390,917	68,976	15,685,578
4	Nj.Adm.Vëndreshë	3,177,369	1,049,665	199,402	4,027,632
5	Nj.Adm.Çepan	8,553,831	1,347,155	620,424	9,280,562
6	Nj.Adm.Potom	5,489,179	1,639,726	939,886	6,189,019
7	Nj.Adm.Leshnje	2,564,350	293,115	76,598	2,780,867
8	Nj.Adm.Gjerbës	6,771,422	526,547	-	7,297,969
9	Nj.Adm.Zhepë	12,021,372	1,233,114	-	13,254,486
Totali		**98,885,976**	**17,139,347**	**6,348,087**	**109,677,236**

Burimi: Bashkia Skrapar

- **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore bëhet me program, ku janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet që programi është i saktë, pasi në informacionet që kërkohen të dhënat dalin të analizuara për çdo zë tatimor që DTT Bashkia Skrapar aplikon. Pasqyrimi i të dhënave fillon me çelje si debitor. Kamatëvonesat rigjenerohen nga sistemi në fund të çdo periudhe**.**

Tabela nr.21: Situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Qytet	1	Biznesi i Madh	2025	82	3	0	85
Qytet	2	Biznesi i Vogël	2025	124	10	3	131
Total 1+2				**206**	**13**	**3**	**216**
Njësitë administrative	3	Biznesi i Madh	2025	0	0	0	0
Njësitë administrative	4	Biznesi i Vogël	2025	13	0	0	13
Total 3+4				**13**	**0**	**0**	**13**

Burimi: Bashkia Skrapar

- **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2025 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucionet shtetërore në vlerën **11,577 mijë lekë.**

Tabela nr.22: Gjendja e debitorëve të biznesit:

Nr.	Njësitë Administrative	Deri më datë 31.12.2024	Deri më datë 31.12.2024 (zbritur pagesat e 2025)	2025	Totali progresiv	Nr i subjekteve debitore
1	Subjektet fizik biznesi i vogël	403,656	377,003	271,790	648,793	26
2	Subjektet juridik biznesi i madh	9,452,719	8,500,632	2,428,431	10,929,063	30
Totali		**9,856,375**	**8,877,635**	**2,700,221**	**11,577,856**	**56**

Burimi: Bashkia Skrapar

Sa me sipër arrihet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Skrapar, për subjektet që janë debitorë pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve, kanë zbatuar një pjesë e procedurave për to, si bllokimi i llogarive (gjithësej 56 subjekte), është dërguar ASHK-së kërkesa për vendosjen e barrës hipotekore, kërkesë për vendosjen e barrëve siguruese.

- **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Bashkia Skrapar në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Skrapar janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Skrapar.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2025 deri më 31.12.2025, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së

ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **81,894 lekë** për 4 persona**.**

Tabela nr.23: Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë						
Viti	**Persona**	**Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë**	**Nr i personave**	**Vlera e arkëtuar**	**Nr. i personave**	**Vlera e detyrimit**
Deri më datë 31.12.2024	0	0	0	0	0	0
Deri më datë 31.12.2024 (zbritur pagesa 2025)	0	0	0	0	0	0
2025	4	81,894	4	81,894	4	81,894

Burimi: Bashkia Skrapar

- **<u>Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:</u>**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave, ushtrojnë aktivitetin 2 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, si vijon:

Tabela nr.24: Subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre

Nr.	**Subjekti**	**Nipt**	**Afati i Autorizimit**		**Detyrimi për autorizimin**	**Pagesat e kryera**	**Diferenca**
			Fillimi	**Mbarimi**			
1	'K' SHPK	J.....P	07.08.2024	06.09.2029	1,000,000	1,000,000	0
2.	"K P Skrapar"	K.....H	19.04.2021	18.04.2026	1,000,000	1,000,000	0
Totali					**2,000,000**	**2,000,000**	**0**

Burimi: Bashkia Skrapar, Drejtoria Tatim Taksave.

Shënim: Për shkak të detyrimeve të papaguara, nga subjekti "K P" ShPK, në tatimet e shtetit, në doganë dhe në OSHEE, aktiviteti është bllokuar, për këtë arsye nuk është rinovuar licenca.

<u>Konkluzione:</u>

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan debitorë në vlerën **121,336,986 lekë** ndaj Bashkisë Skrapar.

1. Debitorë nga taksat dhe tarifat vendore për abonentët familjarë në vlerën **109,677,236 lekë.**
2. Debitorë nga taksat dhe tarifat vendore për abonentët biznes në vlerën **11,577,856 lekë.**

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. z. A. M, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Skrapar
2. znj. H. B, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

2.3 Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.

2.3.1. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

2.3.2. Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

2.3.3. Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2025;
- Ditarët e kontabilitetit për vitin ushtrimor 2025;
- Listë pagesat me zgjedhje për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për vitin ushtrimor 2025;
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit Skrapar, për vitin ushtrimor 2025;

- Dokumentet e inventarizimit etj., për vitin ushtrimor 2025;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2025 Bashkia Skrapar ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në të cilat përfshihen aparati i Bashkisë Skrapar, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor.
Bashkia Skrapar për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar.
Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Skrapar si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Skrapar për vitin 2025 janë të nënshkruara nga z. A. M, Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. N. G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Skrapar në datë 20.05.2026.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2025 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare individuale dhe të konsoliduar për Bashkisë Skrapar dhe Njësitë e tjera shpenzuese për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2025- 31.12.2025.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2025:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Bashkisë Skrapar në 31.12.2025, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1) 2025.
Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=2,373,946,997 lekë.

- Aktivet	2,541,303,633 lekë
- Detyrimet	167,356,636 lekë
- Aktivet Neto	2,373,946,997 lekë

Aktivet afatshkurtra:
Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën **242,379,906 lekë** dhe përbëhen nga:
- Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre" në shumën 45,470,974 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 39,080,563 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 157,828,369 lekë;

Fondi i Konsoliduar:
Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.
Pasqyra PF1: Detajet e nënrubrikës "*Teprica*".

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	-	2,388,566,969	Çelje
Amortizim i vitit	137,936,327	77,948,116	Investime + Dhurime
		9,425,532	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	137,936,327	2,475,940,617	Shuma
Shuma		**2,338,004,290**	

Burimi: Bashkia Skrapar

Referuar pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 101 "Teprica" është kontabilizuar për vlerën 2,338,004,290 lekë.
Sipas tabelës së mësipërme llogaria 101 "Teprica" është kontabilizuar në përputhje me udhëzimin e MFE-së Nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*".

Pasqyra PF2: Detajet e nënrubrikës "*Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre*".
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
531	Mjete Monetare në arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	45,470,974	96,856,465	(51,385,491)
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akreditiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë	-	-	-
	Totali	**45,470,974**	**96,856,465**	**(51,385,491)**

Burimi: Bashkia Skrapar

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 45,470,974 lekë, përbëhet nga:
gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 35,942,707 lekë gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 9,528,267 lekë.

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 45,470,974 lekë kuadron me llogaritë 85 *"Rezultati i vitit ushtrimor"* 466 *"Mjete në ruajtje".*
Fondet e papërdorura për vitin 2025 janë si më poshtë:

Aparati i Bashkisë Skrapar:
1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2025 e papërdorur 21,479,009 lekë.
2-Të ardhurat viti 2025 të papërdorura 13,711,266 lekë.

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike:
1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2025 e papërdorur 342,473 lekë.
2-Të ardhurat viti 2025 të papërdorura 66,345 lekë.
Ndërmarrja e Shërbim Pyjor:
1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2025 e papërdorur 87,529 lekë.
2-Të ardhurat viti 2025 të papërdorura 256,085 lekë

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën **35,942,707 lekë** fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2026.

Pasqyra PF3: Detajet e nënrubrikës "*Gjendje inventari qarkullues*".

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
31	Materiale	5,267,618	4,572,319	695,299
32	Inventar i imët	33,812,945	25,082,712	8,730,233
33	Prodhim në proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshë në rritje e majmëri	-	-	-
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve	-	-	-
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarëve	-	-	-
	Totali	**39,080,563**	**29,655,031**	**9,425,532**

Burimi: Bashkia Skrapar

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Skrapar në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 39,080,563 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 5,267,618 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët " në vlerën 33,812,945 lekë.
Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =9,425,532 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën -9,425,532lekë
Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 5,267,618 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF4: Detajet e nënrubrikës , lëvizjet e llogarisë 312 "Materiale":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	4,572,319
Gjendja në 31.12.2025	**5,267,618**

Burimi: Bashkia Skrapar

Llogaria 327 "Inventar i imët", ka vlerën 33,812,945 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelat si mëposhtë:

Pasqyra PF5: Detajet e nënrubrikës , lëvizjet e llogarisë 327 "Inventar i imët":

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	25,082,712
Gjendja në 31.12.2025	**33,812,945**

Burimi: Bashkia Skrapar

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2025, në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* nga ana e titullarit të Bashkisë Skrapar nuk është konceptuar urdhri për ngritjen e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2025 të Bashkisë.

***73.** Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efiçiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/ udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike.".*

74. *Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*
75. *Titullari i njësisë publike, kur ka dyshime për mashtrime, abuzim e, keqpërdorime, vjedhje apo grabitje të aktiveve apo të një pjese të tyre, ose qoftë edhe për të vërtetuar saktësinë e veprimeve ligjore për një periudhë kohore, mund të urdhërojnë kryerjen e inventarizimeve të plota ose të pjesshme të tyre, pa kufizim në numër, jashtë afateve të parapara të inventarizimit të aktiveve.*
76. *Inventarizimi bëhet, sipas rastit, me numërim, matje/peshim, verifikim etiketash/matjesh teknike, etj. të të gjitha objekteve që inventarizohen. Si përjashtim, me autorizim të titullarit për aktivet e ambalazhuara standard dhe të vulosura nga prodhuesi, inventarizimi në magazinë mund të bëhet në bazë të të dhënave të etiketave, duke bërë kontrolle në jo më pak se 5 për qind të numrit të përgjithshëm të pakove dhe, kur dalin diferenca, shtrihet në të gjithë sasinë. 77. Në raste të veçanta, gjatë inventarizimit mund të bëhet lëvizje e aktivit, por kurdoherë në prani të komisionit të inventarizimit.*
78*. Kur inventarizimi i sasisë brenda ambalazhit dëmton aktivet, lejohet, me autorizim të titullarit, të bëhet verifikimi vetëm si peshë bruto duke caktuar peshën neto me anë të zbritjes së peshës së ambalazhit në masën e caktuar me rastin e marrjes në dorëzim të aktiveve.*
79. *Përcaktimi i gjendjes së vërtetë të aktiveve me karakter të veçantë dhe masiv, bëhet me anë të matjeve teknike.*
80. *Përcaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlerë bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj.*

Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme "&"Të tjera aktive afatshkurtra":
Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të arkëtueshme*".

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme	**157,828,369**	**148,755,993**	**9,072,376**
411	Klientë e llogari te ngjashme	-	-	-
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	-	-	-
431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Loka	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	-	-	-
44	Institucione te tjera publike	-	-	-
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë	-	-	-
468	Debitorë te ndryshëm	126,032,037	115,916,958	10,115,079
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	31,796,332	32,839,035	(1,042,703)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)	-	-	
	Totali	-	-	
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Furnitore(Debitore), parapagime pagesa pjesore	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	-	-	-

Burimi: Bashkia Skrapar

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 115,916,958 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 126,032,037 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje

neto me vlerë 10,115,079 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët. Nga analiza e llogarisë 468 ***"Debitorë të ndryshëm"*** kemi detyrimet si mëposhtë:

Pasqyra PF7: Detajet e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*".

Lloji i Detyrimit	Detyrim 31.12.2024	Shtesa viti 2025	Pakësim viti 2025	Detyrim datë 31.12.2025
Detyrime Familjarë, Biznesi	98,885,976	17,139,347	6,348,087	109,677,236
Debitorë nga akt kontrollet	17,030,982	-	676,181	16,354,801
Shuma	**115,916,958**	**17,139,347**	**7,024,268**	**126,032,037**

Burimi: Bashkia Skrapar

Në llogarinë 468 *"Debitorë të ndryshëm"* janë kontabilizuar detyrimet duke i grupuar sipas llojit të detyrimit informacioni për debinë sipas detyrimeve gjendet në tabelës e mësipërme:
1-Nga Drejtoria e tatim taksave është përcjell informacioni për detyrimet e abonentëve familjarë, biznes dhe për debitorët nga akt kontrollet pa shkresë përcjellëse.

Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 31,796,332 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është kontabilizuar për vlerën 0 lekë. Vlera prej 31,796,332 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Pasqyra PF8: Detajet e nënrubrikës "*Të tjera operacione me shtetin*".

Emërtimi i llogarive	2025	2024
Llogari 401-408	2,589,052	4,316,066
Paga personeli llog 42	21,359,077	20,638,947
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	1,595,841	1,748,683
Sigurime shoqërore llog.435	5,522,179	5,420,627
Sigurime shëndetësore llog.436	730,183	714,712
Totali	**31,796,332**	**32,839,035**

Burimi: Bashkia Skrapar

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llog.202 *"Studime dhe Kërkime",* dhe paraqiten me kosto historike 110,213,144 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 42,848,813 lekë, shtesa gjatë vitit 2025 në vlerën 3,398,287 lekë, amortizim i vitit 2025 në vlerën 11,288,125 lekë dhe vlerë neto në vlerën 67,364,331 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 *"Studime dhe Kërkime"* gjatë vitit 2025 janë kontabilizuar në këtë llogari 3(tre) projekte me vlerë 3,398,287 lekë. Projektet e kontabilizuar në llogarinë 202 *"Studime dhe Kërkime"* janë përfituar me anë të procedurave të prokurimit dhe me anë të dhurimit.

Pasqyra PF9: Lista e projekteve të kontabilizuara në llogarinë 202 gjatë vitit 2025.

Nr	Emri I Projektit	Vitit i regjistrimit	Vlera historike	Amortizimi	Vlera kontabel neto
1	Hartim projekti për Godinen e Qendres Kulturore te Femijeve "Meleq Staravecka"	2025	1,495,110	0	1,495,110
2	Hartim Projekti per Godinen e Re te Palestres	2025	1,549,009	0	1,549,009
3	Hartim Projekti per Asfaltimin e Rruges varrezave fshati kakruk	2025	354,168	0	354,168
Totali			**3,398,287**		**3,398,287**

Burimi: Bashkia Skrapar

Nga auditimi u konstatua që në përbërje të llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* janë 6 (gjashtë) projekte të cilat lidhen me ujësjellës që duhet t'i bashkëngjiten kapitalizmit të aktiveve dhe të transferohen në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha".

Të dhënat analitike të llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"* për 6 (gjashtë) projekte të cilat lidhen me ujësjellës, paraqiten në **Pasqyrën PF10.**

Nr.	Projekti	Viti Kontabilizimit	Kosto Historike
1	Projekt Ide Reabilit.KUZ Çorovode	2016	4,992,000
2	Studim Projektim Reabilit.KUZ Çorovode	2017	45,500,000
3	Projekt-Ndertimi Ujsjellesit Fshatit Therepel	2020	855,678
4	Projekt-Furnizim me uje I fshatrave Radesh, Verzhezhe, Munushtir, Vendreshe, Strore, Potom	2021	5,600,000
5	Projekt-Furnizim me uje I fshatrave Radesh, Verzhezhe, Munushtir, Vendreshe, Strore, Potom	2022	8,400,000
6	Hartim Projekti -Furnizimi me uje I disa fshatrave te Bashkise Skrapar	2023	13,637,680
Total			**78,985,358**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.*

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale", AAM sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 2,231,559,396 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,283,657,769 lekë. Gjatë viti 2025 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 77,948,116 lekë, shtesa pa pagesë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerë 0 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 126,648,202 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 403,120 lekë.

Pasqyra PF11: Detajet e nënrubrikës "*Aktive afatgjata materiale*".

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2024	Shtesa 2025	Amortizim 2025	Pakësime 2025	Gjendja me 31.12.2025
210	Toka, Troje, Terrene	4,243,818	0	0	0	4,243,818
211	Pyje, Kullota, Plantacione	6,911,988	0	0	0	6,911,988
212	Ndërtime e Konstruksione	604,930,566	18,153,568	30,246,528	0	592,837,606
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,541,399,601	49,732,367	77,069,980	0	1,514,061,988
214	Instalime dhe paisje	15,813,985	2,475,204	4,396,984	198,000	13,892,205
215	Mjete Transporti	55,357,785	3,746,010	11,071,557	0	48,032,238
218	Inventar Ekonomik	18,439,204	442,680	3,863,153	205,120	15,018,731
28	Caktime	36,560,822	0	0	0	36,560,822
	Shuma	**2,283,657,769**	**74,549,829**	**126,648,202**	**403,120**	**2,231,559,396**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 210 *"Toka, troje terrene"* më datën 31.12.2024, është kontabilizuar për vlerën 4,243,818 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa/pakësim, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,243,818 lekë.

Nga verifikimi dhe analiza llogaria 210 *"Toka, troje, terrene",* konstatohet se, nga ana e Drejtorisë e Financës dhe Buxhetit, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në Njësive Administrative, etj., sipas regjistrit të

aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione" truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë, trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.
Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 *"Toka, troje terrene"* rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 *"Toka, troje terrene"* dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të. E pa analizuar kjo llogari ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30*; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.*

Llogaria 211 ***"Pyje, Kullota, Plantacione"*** më datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 6,911,988 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësim, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 6,911,988 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se në llogarisë 211 *"Pyje, kullota, plantacione",* është pasqyruar vetëm "Pyllëzimi Kurorës së Qytetit të Çorovodës" në vlerën 6,911,988 lekë. Bashkia në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Skrapar, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 *"Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive",* e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Skrapar, me numër rendor nga 1(një) deri 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy) dhe godinën e DSHP-së. Për këto sipërfaqe nuk është bërë verifikimi fizik i tyre me qëllim përcaktimin e vlerës kontabël të llogarisë nr. 211. Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për llogarinë me sipër. Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Skrapar nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Pra, si rezultat i moszbatimit të kuadrit rregullator ligjor për transferimin e aktiveve, llogaria 211 *"Pyje Plantacione",* nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2025. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 "Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë";* Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74,* dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap III, pika 30, i ndryshuar.*

Llogaria 212 ***"Ndërtesa dhe Konstruksione"***. Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 592,837,606 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 604,930,566 lekë. Gjatë viti

2025 ka patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 18,153,568 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 0 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 0 lekë Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 30,246,528 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 0 lekë.

Pasqyra PF12: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" gjatë vitit 2025:

Nr	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
1	Mbikqyrje punimesh ne objektin: Rikonstruksioni Kinemas Qytetit Çorovode	279,103	0	279,103
2	Kolaudim punimesh ne objektin: Rikonstruksioni Kinemas Qytetit Çorovode	70,306	0	70,306
3	Rikonstruksioni Godines Shkolles Ramiz Aranitasi	2,487,064	0	2,487,064
4	Qender e Grumbullimit te Qumshtit financim kosto TVSH Projekti FZHSEPSP_BS	380,217	0	380,217
5	Ndertim lera financim kosto TVSH ne Projektin FZHSEPSP_BS	1,371,899	0	1,371,899
6	Ndertim Muri Mbrojtes pergjat lumit Osum te ish kantieri NSHN Faza II	13,564,979	0	13,564,979
Totali		**18,153,568**	**0**	**18,153,568**

Burimi: Bashkia Skrapar

Nga tabela e mësipërme 1 (një) projekt i cilat nuk është marrë në dorëzim dhe është kontabilizuar në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* në vlerën 13,564,979 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* këto projekte duhet të kontabilizohen në llogarinë 231 *"Investime për aktivet afatgjata"* deri në momentin e marrjes në dorëzim të investimit.

Investimi *"Ndërtim Muri Mbrojtës përgjatë lumit Osum te ish kantieri NSHN Faza II"* me vlerë kontrate më TVSh 59,820,003 lekë, për këtë investim është kontabilizuar pagesa pjesore në vlerën 13,564,979 lekë.

Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerë e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit.

Llogaria 213 *" Rrugë, rrjete, vepra ujore"*:

Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë për vitin ushtrimor 2025, paraqiten me tepricë neto 1,514,061,988 lekë. Në vitin paraardhës 2024, vlera kontabël neto e llogarisë 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* paraqitet në shumën 1,541,399,601 lekë. Gjatë vitit 2025 ka patur shtesë të llogarisë 213 blerje me pagesë në shumën 49,732,367 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2025 kanë qenë në vlerën 0 lekë.

Pasqyra PF13: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" gjatë vitit 2025:

Nr	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
1	Mbikqyrje punimesh ne Objektin: Mbrojtje ure mbi lumen e Tomorrices	1,030,787	0	1,030,787
2	Mbrojtje Ure mbi Lumin e Tomorrices	18,778,693	0	18,778,693
3	Rikualifikimi urban ne Lagjen "5 Shtatori" Çorovode	29,256,808	0	29,256,808
4	Mbikqyrje punimesh ne objektin: Rikualifikimi urban ne Lagjen "5 Shtatori" Çorovode	666,079	0	66,079
Total		**49,732,367**		**49,732,367**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Nga tabelë e mësipërme konstatohet se 2 (dy) projekte të cilat nuk janë kolauduar dhe nuk janë marrë në dorëzim janë kontabilizuar në llogarinë 213 *"Rrugë, rrjete vepra ujore"* në vlerën 48,035,501 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* këto projekte duhet të kontabilizohen në llogarinë 231 *"Investime për aktivet afatgjata"* deri në momentin e marrjes në dorëzim të investimit.
Investimi *"Mbrojtje ure mbi lumen Tomorricë"* me vlerë kontrate më TVSh 52,462,565 lekë, për këtë investim është kontabilizuar pagesa pjesore në vlerën 18,778,693 lekë.
Investimi *"Rikualifikimi urban në lagjen 5 shtatori Çorovodë"* me vlerë kontrate më TVSh 53,463,434 lekë, për këtë investim është kontabilizuar pagesa pjesore në vlerën 29,256,808 lekë.
Sa më sipër aktivi i cili merret në dorëzim duhet të kontabilizohet në llogarinë përkatëse të klasës 2 me vlerë e plotë të aktivit edhe pse nuk është shlyer i plotë detyrimi, sepse në rastin e mësipërm kemi nënvlerësim të vlerës së aktivit.

Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 213 *"Rruge, rrjete, vepra ujore"* konstatohet që Bashkia Skrapar ka në inventar 62 objekte ujësjellësve me kosto historike në vlerën 895,367,087 lekë Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha" në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" kreu II pika 14,* me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85,* me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.*

Llogaria kontabël 214 *"Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune".* Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2025 paraqitet me vlerë neto kontabël 13,892,205 lekë.
Bashkia gjatë vitit 2025 ka blerë më pagesë më anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 2,475,204 lekë.
Pasqyra PF14: Shtesat gjatë vitit 2025 në llogarinë 214 *"Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune":*

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	2,475,204	-	0	-
Total		**2,475,204**	**-**	**0**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 215 *"Mjete transporti"*. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Skrapar.
Sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të në datën 31.12.2025 Bashkia Skrapar (aparati) disponon 31 mjete me kosto historike 112,980,457 lekë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike disponon 21 mjete me kosto historike 90,482,789 lekë. Ne total në PF të konsoliduara kosto historike është në vlerën 203,463,246 lekë, amortizim të akumuluar në shumën 155,431,008 lekë dhe me vlerë neto kontabël 48,032,238 lekë.

Gjatë vitit 2025 llogaria 215 *"Mjete Transporti"* nuk ka pasur shtesa 2 mjete më vlerë të cilat janë blerje e krijuar me pagese.

Pasqyra PF15: Mjetet e Transportit të Bashkisë:

Nr	Drejtoria	Emërtimi	Viti i regjistrimit	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera Neto
1	Administrata	Automjeti Rang-Rover	2025	3,350,000		3,350,000
2	Projekti FZHSEPSP_BS	Blerje automjeti Financim kosto TVSH Projekti FZHSEPSP_BS	2025	396,010	0	396,010
Total				**3,746,010**	**0**	**3,746,010**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria kontabël 218 *"Inventar ekonomik".* Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Skrapar. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 15,018,731 lekë. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 218 *"Inventari ekonomik"* është pakësuar me vlerën 3,420,473 lekë.

Pasqyra PF16: Shtesat gjatë vitit 2025 në llogarinë 218 "Inventar ekonomik":

			Pa pagesë		
Nr	**Njësitë shpenzuese**	**Blerje me pagesë**	**Jashtë sistemit**	**Brenda sistemit**	**Lëvizje brenda aktiveve**
1	Bashkia	442,680	-	-	-
Total		**442,680**	**-**	**-**	**-**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Skrapar në fund të vitit 2025, paraqitet në vlerën 1,383,539,984 lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2025. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" paraqitet me shtesë prej 137,533,207 lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2025.

Në aneksin nr. 2/3/1 në anekset e projekt raportit të auditimit është paraqitur amortizimi i AAGJ. Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Skrapar, janë si më poshtë:

- Ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- Inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- Për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- Për mjetet e transportit 20%
- Për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivet Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2025 në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se Bashkia Skrapar është aksionare në shoqërinë e re të krijuar "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha" shoqëri e krijuar në bazë të akt marrëveshjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfaqësuar nga AKUM me nr.7183.prot., datë 28.09.2022 dhe Bashkitë Berat, Kuçove, Dimal, Poliçan dhe Skrapar. Bazuar në këtë akt marrëveshje kapitali fillestar i shoqërisë është 10,000,000 lekë ku Bashkia Skrapar zotëron 4,7% të aksioneve ose në vlerë kapitali 470,000 lekë (10,000,000*4,7%). Nga

auditimi konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Skrapar nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në shoqërinë e re të krijuar "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha" për vlerën prej 470,000 lekë. Llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vetë"*, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2025. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" kreu II pika 14,* me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.*

Llogaria 231 *"Investimet për Aktivet Afatgjata Materiale"*:

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që llogaritë 230-231 "Investimet për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale" janë në vlerën 0 (zero) lekë rrjedhimisht nuk është paraqitur asnjë investim që është në proces. Nga tërësia e veprimeve kontabël sipas pasqyrave financiare dhe anekseve statistikorë rezulton që nuk është paraqitur asnjë investim që është në proces zbatimi rrjedhimisht të gjitha investimet janë paraqitur të përfunduara. Nga analiza e kryer rezulton që në 31.12.2025 investimet në proces për të cilat grupit të auditimit nuk ju paraqitën certifikata të marrjes në dorëzim janë si më poshtë:

Pasqyra PF17: Aktivet e kontabilizuara në llogarinë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* 213 *"Rrugë, rrjete dhe vepra ujore"* gjatë vitit 2025:

Nr.	Emërtimi	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto kontabël 31.12.2025
1	Mbrojtje Ure mbi Lumin e Tomorrices	18,778,693	0	18,778,693
2	Rikualifikimi urban ne Lagjen "5 Shtatori" Çorovode	29,256,808	0	29,256,808
3	Ndërtim Muri Mbrojtës përgjatë lumit Osum te ish kantieri NSHN Faza II	13,564,979	0	13,564,979
Total		**61,600,480**		**61,600,480**

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ndjek parimet e kontabilizimit të shtesave të aktiveve të qëndrueshme në bazë të procesit të përfundimit të objekteve sipas akteve të marrjes në dorëzim të objekteve dhe vlerave të situacioneve përfundimtare moment ky i pakësimit të vlerave të llogarisë 230-231, por kalon në shtesat e aktiveve të qëndrueshme vlerat e likuiduara gjatë vitit të punimeve në proces. Për sa më sipër nuk ruhet gjurma e auditimit në lidhje me procesin e kontabilizimit të pakësimit të llogarisë 230 - 231 ''Investime në proces'' në shtesat e llogarive të aktiveve të qëndrueshme jo materiale dhe materiale përkatësisht llogaritë 202, 212, 213, 214. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar *''Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin'' neni 12 germa ë dhe germa dh* dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2. Njohja e AAGJ në pasqyrat financiare vjetore.*

Hyrjet e AAGJM dokumentohen: ''Për blerjet, ku si dokumente shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt-marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivit. Për përfitimet nga dhurime, ku si dokument është akti i dhurimit dhe akti i marrjes në dorëzim. Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument

shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim. Për rivlerësimet, shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve''.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Skrapar për vitin 2025 llogaritë kundërti parti të llogarisë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" janë kontabilizuar si mëposhtë:
-Llog 105 "Teprica e granteve kapitale të brendshme" me vlerë 0 lekë;
-Llog 106 "Teprica e granteve kapitale të huaja" me vlerë 0 lekë;
-Llog 115 "Nga fondet e veta të investimeve" me vlerë 0 lekë;
Llogaritë e mësipërme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante/investime janë investime në proces të papërfunduara. Llogaritë e mësipërme referuar udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 *"Disa ndryshime në udhëzimin e ministrit të financave dhe të ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* duhet të kuadrojnë me llogarinë 231 *"Investime për aktivet afatgjata".*

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Skrapar më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Pasqyra PF18: Detajet e nënrubrikës "*Llogari të pagueshme*".

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	2,589,052	4,316,066
42	Detyrime ndaj personelit	21,359,077	20,638,947
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,595,841	1,748,683
435	Sigurime shoqërore	5,522,179	5,420,627
436	Sigurime shëndetësore	730,183	714,712
467	Kreditor të ndryshëm	0	0

Burimi: Bashkia Skrapar

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund të vitit 2025 është në vlerën 2,589,052 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Skrapar më 31.12.2025. Lëvizja e llogarisë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to"*, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Pasqyra PF19: Detajet e nënrubrikës "*Furnitorë e llogari të lidhura me to".*

Nr.	Objekti I faturës	Vlera e faturës me TVSh	Gjendja date 01.01.2025	Shtesa 2025	Pakesime 2025	Gjendja 31.12.2025
1	Ndihme ekonomike 6 %	132,984	132,984	10,455	132,984	10,455
2	Keshilltare dhe Kryepleq	477,275	477,275	477,275	477,275	477,275
3	Kthim i bursave për konviktet	375,358	375,358	601,564	375,358	601,564
4	Sherbime Telefonike	530,730	530,730	343,978	530,730	343,978
5	Energji Elektrike	338,052	338,052	376,310	338,052	376,310
6	Uje i Pijshem	957,600	957,600		957,600	0
7	Drut e zjarrit	452,430	452,430		452,430	0
8	Peleta për ngrohje	261,966	261,966	30,357	261,966	30,357
9	Posta	36,420	36,420	37,120	36,420	37,120
10	Sherbime Telefonike	135,237	135,237		135,237	0
11	Ushqimet e Çerdhes	217,981	217,981		217,981	0

12	Ushqimet e Konviktit	375,358	375,358	601,564	375,358	601,564
13	Energji elektrike Dhjetor 2025	61,800	61,800	343,200	61,800	343,200
14	Uji pijshem Dhjetor 2025	325,971	325,971	124,680	325,971	124,680
15	Blerje Antifrize 2025			117,600		117,600
16	Riparim Kambjo Fadrome 2025			120,000		120,000

Burimi: Bashkia Skrapar

Referuar informacionit në tabelën e mësipërme Bashkia Skrapar në llogarinë 401 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to"* ka pasqyruar detyrimet e palikuiduara. Bashkia Skrapar nuk ka regjistruar detyrime të prapambetura në këtë llogari. Detyrimet e mësipërme i përkasin vetëm muajt dhjetor 2025.

Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Skrapar, paraqitet në vlerën 21,359,077 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar ne muajin janar 2026 ne shumen 21,359,077 lekë.
Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", paraqitet në vlerën 1,595,841 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar ne janar 2026.
Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 5,522,179 lekë.
Llogaria 436, "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 730,183 lekë.

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Skrapar, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 9,528,207 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.
Në mënyrë analitike, garancitë e të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, **paraqiten si mëposhtë.**
Pasqyra PF20: Detajet llogarisë "*Kreditorë për mjete në ruajtje".*

Nr.	Objekti i ngurtësimit	Operatori ekonomik	Viti i ngurtesimit	Gjendje 31.12.2024	Shtesa 2025	Pakësime	Vlera
1	Rikonstruksion Lulishtja e Qytetit"	"K SHPK"	2011	161,566	-	-	161,566
2	"Ndërtim Abulance Tip. A-2 Çorovode"	"D"	2011	52,967	-	-	52,967
3	"Rikonstruksion I Pjesshem I Godines Bashkise Skrapar"	E C	2017	230,260	-	-	230,260
4	"Rikonstr.Shkolla fshati Gradec"	"E"	2017	95,938	-	-	95,938
5	"Kanali Ujrave te Larta Fshati Gjerbes -III"	"S"	2019	112,740	-	-	112,740
6	"Rikonstruksiion Sifonit Rezervuari Staraveck"	"S"	2020	136,075	-	-	136,075
7	Ndertimi kanalit Ujites fshati Barce Nj.Adm.Gjerbes	"S"	2020	112,740	-	-	112,740
8	Restaurimi I fasadave te disa objekteve ne Lagjen "5 Shtatori"	I K	2020	845,310	-	-	845,310
Total				**1,747,596**			**1,747,596**

Burimi: Bashkia Skrapar

Referuar informacionit të mësipërm janë paraqitur 8 ngurtësime me vlerë 1,747,596 lekë për të cilat ka kaluar afati i garancisë.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 *"Kreditore për mjete nën ruajtje"* duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.
Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50, ku përcaktohet:

Llogaria 467 "Kreditor të ndryshëm", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Skrapar, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 0 lekë
Nga auditimi i të dhënave për detyrimet e prapambetura të Bashkisë Skrapar u konstatua që me datë 04.03.2026 për dërgimin e Raportit të Vetëvlerësimit Financiar për vitin 2025 dhe paraqitjen pranë Ministrisë së Financave të *"Detyrimeve ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësisë Financiare"* janë paraqitur detyrime të prapambetura ndaj të tretëve vlera prej 17,090,196 lekë detyrime me të ardhurat e veta.
Në **aneksin nr.2/2/6 në anekset e raportit të auditimit** janë pasqyruar detyrime për 29 fatura tatimore nga të cilat me financim nga buxheti i shtetit 22,999,525 lekë dhe 15,300,108 lekë nga të ardhurat e veta. Sa më sipër detyrimet e parapambetura të raportuara në Ministrinë e Financës janë mbivlerësuar për vlerën 1,790,088 lekë dhe llogaria 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* është nënvlerësuar për vlerën 38,299,633 lekë.
Këto janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Pika 15 Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", paragrafi 42.*

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 572,816,633 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 14,951,647 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 20,000 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.
Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 8,085,633 lekë.
Gjendja e llogarisë ***71*** **"Të ardhurat jo tatimore"** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 33,210,340 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 8,601,769 lekë, e cila përfshin, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
Gjendja e llogarisë ***711*** "***Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2025 në vlerën 24,608,571 lekë, e cila përfshin etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 563,873,926 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 293,646,693 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 293,646,693 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2025, paraqitet në bilanc në vlerën 48,696,749 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 48,696,749 lekë.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 79,219,933 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 79,219,933 lekë.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë"*** paraqitet në bilanc për vitin 2025 në vlerën 117,478,539 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Për vitin 2025 totali i te ardhurave ne vlere është 572,816,633 lekë dhe totali shpenzimeve është 536,873,926 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 35,942,707 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 *"Rezultatin e ushtrimit".*

Në aneksin nr. 2/3/2 në anekset e raportit të auditimit paraqitet analiza e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 *"Pasqyra e performancën financiare"* të PF të vitit 2025.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Skrapar
2. Z. N. G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit

4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a), (b) dhe (c) të nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit"*, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 181/5 prot. datë 20.10.2025 i ka dërguar Bashkisë Skrapar, "Raportin përfundimtar", për përmirësimin e gjendjes, si dhe ka rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Bashkia Skrapar *nuk ka respektuar* këtë afat, duke mos hartuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
Bashkia Skrapar nuk ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

III. Rekomandimet e KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 181/5 prot., datë 20.10.2025, janë rekomanduar gjithsej 28 rekomandime:
a. Janë rekomanduar **19 masa** ***organizative****;*
b. Janë rekomanduar **2 masa** ***për shpërblim dëmi në vlerën 1,112,294 lekë;***
c. Janë rekomanduar **2 masa** ***për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;***
d. Është rekomanduar **1 masë** ***për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore me efekt mungesë të ardhurash;***
e. Janë rekomanduar **2 masa** ***për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitetin e fondeve publike;***
f. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Skrapar që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 22 punonjës** të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 181/5 Prot., datë 20.10.2025, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Skrapar)	Pa pranuar
1	Organizative	17 masa	17 masa	-
2	Shpërblim dëmi	2 masa	2 masa	-
3	Për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;	2 masa	2 masa	-
4	Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore me efekt mungesë të ardhurash;	1 masë	1 masë	-
5	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitetin e fondeve publike;	2 masa	2 masa	
6	Masa Disiplinore	22 masa	22 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	17 masa	3 masa	-	4 masa	10 masa
2	Shpërblim dëmi	4 masa	-	-	-	2 masa
3	Për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;	2 masa	-	1 masë	1 masë	-
4	Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore me efekt mungesë të ardhurash;	1 masë	-	-	1 masë	-
5	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitetin e fondeve publike;	2 masë	1 masë	-	-	1 masë
6	Masa Disiplinore	22 masa	-	-	-	22 masa

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:
Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

Nga 46 (dyzet e gjashtë) rekomandime të dhëna për t'u zbatuar nga Bashkia Skrapar, niveli i zbatimit paraqitet si më poshtë vijon:
- 17 (shtatëmbëdhjetë) rekomandime organizative janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 3 (tre) prej tyre, në proces zbatimi 4 (katër) masa, si dhe pa zbatuar 10 (dhjetë) masa. Nga masat e pa zbatuara 2 (dy) prej tyre do të rikërkohen përsëri në auditimin aktual.
- 2 (dy) masa për shpërblimin e dëmit ekonomik janë pranuar plotësisht dhe janë pa zbatuar;
- 2 (dy) masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia. Nga të cilat 1 (një) masë është në proces zbatimi dhe 1 (një) masë pjesërisht e zbatuar.
- 1 (një) masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore me efekt mungesë të ardhurash e cila është në proces zbatimi.
- 2 (dy) masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitetin e fondeve publike. Nga të cilat 1 (një) masë është zbatuar plotësisht dhe 1 (një) masë pa zbatuar e cila do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.
- 22 (njëzet e dy) masa disiplinore ndaj 22 punonjësve të cilat nuk janë zbatuar.

A. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se, në 8 procedurat e përzgjedhura për auditim përfshirë dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike (NSHP)-në për periudhën 01.01.2024 -31.12.2024, me vlerë totale të fondit limit 107,728,763 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave 101,997,932 lekë pa TVSH, u konstatua se, janë aplikuar kritere të paargumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e objektit të kontratës çka ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën midis B/OE pjesëmarrës në garë.
-Në të gjitha procedurat e audituara, përfshirë edhe blerjet me vlerë të vogël, u konstatuan parregullsi në lidhje me protokollimin e procesverbaleve, të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së auditimit dhe në disa raste u konstatua mungesa e tyre në dosje.
-Nga auditimi i 2 (dy) procedurave të prokurimit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Skrapar u konstatua se, në një (1) rast Njësia e Prokurimit ka përllogaritur sasinë e karburantit objekt prokurimi pas urdhrit të Prokurimit të nënshkruar nga titullari i Autoritetit Kontraktor.
-Në 1 (një) rast është argumentuar përcaktimi i fondit limit, duke mos kërkuar dhe administruar kërkesat e sektorëve dhe drejtorive të Bashkisë Skrapar me nevojat përkatëse për procedurën me objekt "*Blerje nafte*", për vitin 2024.
-Në procedurat me vlerë të vogël, u konstatua copëzim i fondit limit dhe vlera e këtyre procedurave e tejkalonte shumën tavan prej 1 milion lekë, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, ndërkohë që kishin funksion të ngjashëm dhe duhet të grupoheshin duke u prokuruar në një procedurë të vetme konkretisht në 3 (tre) procedura prokurimi me objekt: "*Blerje ushqimesh për Çerdhen për vitin 2024*" me fond limit në vlerën 998,047 lekë, "*Blerje ushqimesh për fëmijët e Qendrës Alternative*", me fond limit në vlerën prej 708,054.36 lekë "*Blerje ushqimesh për Kopshtin e qytetit për vitin 2024*", me fond limit në vlerën prej 910,653 lekë. Në 4 (katër) raste nuk është dokumentuar argumentimit teknik i specifikimeve teknike.
-Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, neni 2 dhe 82, pika 5 me pikën 4 të nenit 39, nenin 78 nenin 84. Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020*, "Për prokurimin publik*", neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, germa "b" nenin 76 pika 2. Udhëzimi nr. 5 datë. 26.06.2021,

"Mbi Përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 3, pika 1616 -Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. neni 18. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 36-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore marrë të gjithë masat e nevojshme për trajnimin e nëpunësve që përfshihen në procedurat e prokurimit, me qëllim shmangien e mangësive lidhur me dokumentimin dhe argumentimin e kritereve dhe specifikimeve teknike, dokumentimin e kërkesave të sektorëve dhe drejtorive për mallra/punë/shërbime për përllogaritjen e fondit limit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 1.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.550/1, datë 22.05.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të tyre grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi u konstatua se në 3 procedura nga 8 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 58,740,274 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave 55,372,785 lekë pa TVSH u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Skrapar, si vijon: "*Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës "Zylyftar Veleshnja", "Punime të sinjalistikës horizontale dhe vertikale si dhe element të mobilimit urban, në rrugët e qytetit, Bashkia Skrapar".* "*Mbrojtje ure mbi lumin e Tomorricës, krahu i majtë dhe i djathtë në hyrje dhe dalje".* Për procedurën me objekt Mbikëqyrje punimesh në objektin "*Rehabilitimi Urban në të dy anët e Rrugës Arkitekt Kasemi*" Komisioni i blerjeve të vogla në cilësinë e KVO-së ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik nga shorti, me arsyetimin se, nuk është paraqitur në datën e caktuar për kryerjen e këtij procesi. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, neni 2 dhe 82. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 36-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi:. Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune ku të analizojë arsyet e parregullsive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 2.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.550/1, datë 22.05.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për parregullsitë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të tyre grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të zhvillimit u konstatua se Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit të Bashkisë Skrapar nuk ka kërkuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të zhvillimit brenda zonave të mbrojtura dhe zonave me përparësi zhvillimin e turizmit. Nga auditimi janë konstatuar **tre raste** për objektet: - Leje zhvillimi ambiente shërbimi, akomodimi, rekracioni

dhe agroturizëm me 2 kate, miratuar me Vendim Nr. 25, datë 16.04.2024, me zhvillues "A. Z." - Leje zhvillimi Objekt 2 kate me stukturë druri, miratuar me Vendim Nr. 27, datë 12.09.2024, me zhvillues B. B. - Leje zhvillimi Objekt shërbimi agroturizëm, miratuar me Vendim Nr. 26, datë 02.09.2024, me zhvillues G. Q. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Vendimin nr. 41, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit *"Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda zonave të mbrojtura dhe zonave me përparësi zhvillimin e turizmit*", pika 3 dhe pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 75-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Skrapar, të merren të gjitha masat për të kërkuar mendimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe për t'i kërkuar aplikantit, zhvilluesit dhe projektuesit, hartimin e aktit të përputhshmërisë, i cili duhet të miratohet nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për të gjitha objektet që zhvillohen në zonat e mbrojtura me përparësi zhvillimin e turizmit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 3.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.550/1, datë 22.05.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për lejet e ndërtimit grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës.

Statusi: Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të zhvillimit u konstatua se për objektin: Leje zhvillimi strukturë akomoduese (bujtinë) 2 kat + papafingo me 1 kat nëntokë miratuar me Vendim Nr. 28, datë 26.11.2024, me zhvillues "E. B", nuk janë respektuar kushtet urbane të parashikuara në ligj konkretisht parcela minimale e lejuar për ndërtim, intensiteti maksimal i lejuar, lartësia maksimale e lejuar, e matur me metra dhe numër katesh, si dhe distanca urbane nga kufiri i pronës. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin 107/2014 *"Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit",* i ndryshuar, neni 38; VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, neni 9, Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Skrapar, miratuar nga KKT me Vendim nr. 02, datë 08.02.2017, pika 1.5 dhe 1.5.1, Pashaporta e njësisë strukturore ZU.13.1, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 75-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Skrapar, në lidhje me miratimin e lejeve të zhvillimit, të marrë të gjitha masat për të respektuar kushtet urbane të parashikuar në dispozitat ligjore dhe rregullatorë, si dhe në çdo rast të respektohet parcela minimale e lejuar për ndërtim, intensiteti maksimal i lejuar, lartësia maksimale e lejuar, e matur me metra dhe numër katesh, si dhe distanca urbane nga kufiri i pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 4.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.550/1, datë 22.05.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për lejet e ndërtimit grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës.

Statusi: Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të zhvillimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatuan mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar nga ligji dhe rregulloret përkatëse. Janë evidentuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, të cilat tejkalojnë afatet e përcaktuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu, u konstatua se lejet

zhvillimit nuk respektojnë përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së zhvillimit. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar në tre raste për objektet: Leje zhvillimi Objekt 2 kate me stukturë druri, miratuar me Vendim Nr. 27, datë 12.09.2024, me zhvillues B B; - Leje e zhvillimi Objekt shërbimi agroturizëm, miratuar me Vendim nr. 26, datë 02.09.2024, me zhvillues G Q; - Certifikatë përdorimi Banesë e re me binxë, me mbulesë me çati me tjegulla marsejeze, në Zonë Kadastrale 2811, Pasuria Nr 304/1, miratuar me Vendim Nr. 10, datë 15.04.2024, me zhvillues z. A. Q. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, neni 9, pika 1, neni 10, pika 1, nënpika dh), neni 10/1, neni 20, neni 27/1, pika 2, neni 27/2, pika 1, nënpika i), ë), j), g), k). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 75-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Skrapar, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje leje zhvillimi dhe certifikatë përdorimi:

-Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje zhvillimi dhe certifikatë përdorimi, siç janë: licenca e topografit dhe projektuesit, aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit, policat e sigurimit, kontratat midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese, etj.;

-Të shqyrtojë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;

-Të respektojnë përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së zhvillimit, ku të përmbajë të dhëna si: përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme; intensitetin e ndërtimit; koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim; lartësinë maksimale në metra.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 5.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.550/1, datë 22.05.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për lejet e ndërtimit grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike për objektet: "*Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës "Arkitekt Kasëmi"* dhe nr. 1566 prot., datë 24.05.2024" fituar nga shoqëria "B" SHPK me vlerë 28,540,291 lekë; "*Rikonstruksion i shkollës së mesme të përgjithshme "Ramiz Aranitasi*", dhe nr. 2506 prot., datë 28.09.2023" fituar nga shoqëria "F" SHPK me vlerë 43,167,046 lekë me t.v.sh u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Skrapar nuk është kryer Oponenca Teknike, veprim ky në mospërputhje me me pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit",* i ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2020 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998",* me VKM Nr. 610, datë 22.9.2022 *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 41, pika "C", si dhe VKM Nr. 9, datë 11.01.2024 *"Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste". (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 64-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit të marrë masa që të pajisin me ***Oponencë Teknike*** për çdo projekt zbatimi, me qëllim kontrollin e projektit në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe të zhvillimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, dhe në përputhje me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 6.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.550/1, datë 22.05.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për lejet e ndërtimit grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Drejtori i financës dhe specialisti i aseteve i Bashkisë Skrapar nuk kanë marrë masat për hartimin e planeve të rilevimit, verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së si dhe parashikimin e fondeve për pagesën e plan rilevimeve për çdo pronë publike për të cilën do të aplikohet, për të bërë të mundur transferimin e 2104 pasurive dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit të Bashkisë Skrapar dhe njësive të tyre administrative. Për kontratat qirasë të lidhura në vitin 2024, nga Bashkia Skrapar, nuk janë ngritur njësitë monitoruese për zbatimin e kontratës si dhe nuk dokumentohen procesverbalet për marrjen në dorëzim të pronës nga qiramarrësi. Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor Skrapar, nuk ka regjistruar në ASHK pasuritë pyje dhe kullotat transferuar me anë të VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016**,** "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive*". Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil, neni 92, neni 144, neni 192 dhe neni 195, Ligjin 111/2018 *"Për Kadastrën",* neni 67, pika 3, Ligjin 20/20 *"Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë",* neni 37, VKM-në nr. 54 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"* pika II, shkronja dh, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* pikat 26-3, Rregullore e Bashkisë Skrapar, neni 65. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 70-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtori i financës, specialisti i aseteve dhe Drejtori i NSHP të marrin masat e duhura për parashikimin e fondeve të nevojshme për hartimin e plan rilevimeve dhe nisjen e procedurave për regjistrimin e pasurive në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Skrapar me VKB nr.68, datë 20.12.2024 *"Për miratimin e buxhetit të vitit 2025"* nuk janë parashikuar fonde për hartimin e planeve të rilevimit.

Statusi: Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vëna në dizpozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore vendore u konstatua se, për vitin 2024 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 70,497,206 lekë dhe janë realizuar në vlerën 64,695,922 lekë ose 92%, me një nivel të ulët

të realizimit, me 5,801,284 lekë më pak nga plani. Nga auditimi u konstatua se, për disa zëra sipas trajtimit në material, realizimi paraqitet në vlera të ulëta s dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Nga auditimi rezultoi se i takse e fjetjes në hotel me një realizim prej 34% nga plani, gjithashtu të ardhura nga transporti llogariten në masë 46%, ndërsa realizimi mbi plan paraqitet të ardhura nga tregu me një tejkalim prej 114 %, duke u ndjekur nga taksa nga konvikti me një realizim pre111 %. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Tatim-Taksave të marrë masa që, gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet e pa studiuara dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të Bashkisë.

-Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i të ardhurave të planifikuara gjatë vitit 2025 në Bashkinë Skrapar rezulton se të ardhurat janë planifikuar në vlerën 76,862 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 60,818 mijë lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me administrimin e taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Skrapar kryhet në programin Excel. Drejtoria e të ardhurave nuk disponon regjistra fizik. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave ku sipas rastit janë konstatuar përllogaritje të gabuara. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: *"Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar, të merren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse me qëllim saktësimin e të dhënave të grumbulluara nga burime të ndryshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga dokumenationi i vënë në dispozicion, rezulton që kjo drejtori ka marrë masa për hartimin e regjistrave të taskave vendore.

Statusi: Zbatuar plotësisht

10. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i të dhënave mbi agjentët tatimorë për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Berat në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhjet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo. Bashkia Skrapar nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Për sa më sipër, Bashkia Skrapar nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Skrapar, nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj gjithashtu nuk ka filluar procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura. Këto veprime janë në kundërshtim me të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008 neni 117 pika*, "Për Procedurat Tatimore",* ku parashikohet se *"Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*". *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj.

- Të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucioni e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaj sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar, ka marrë masa për krijimin e bazës për të dhënat e subjekteve, duke kryqëzuar informacionet me institucionet e tjera dhe rakordimet në fund të muajit.

Statusi: Zbatuar plotësisht

11. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar u konstatua se, për vitin 2024, plani i buxhetit është në vlerën 684,970 mijë lekë dhe është realizuar në fakt në vlerën 610,766 mijë lekë me një diferencë në vlerën 74,204 mijë lekë, ose në masën 89 %. Zëri që ka vlerën më të ulët të realizimit është zëri transferta korrente të brendeshme, i cili është planifikuar në vlerën 11,962 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 2.883 mijë lekë ose në masën 24 %. Gjithashtu zëri investime ose shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) ka një mosrealizim pasi janë planifikuar investime në shumën 125,578 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 100,009 mijë lekë ose në masën 79 %. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 92,857 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 78,774 lekë, ose në masën 84 %. Sa i përket realizimi të buxhetit rezulton se, realizimi nga fondet e Bashkisë është në vlerën 418,101 mijë lekë dhe nga fondet e buxhetit të Shtetit 192,665 mijë lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore",* pika a) e nenit 5, neni 37 dhe neni 46; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,15, 27 dhe 32, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* neni 9, pika 1.3., gërma "c". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Skrapar, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i i buxhetit për **vitin 2025** fondet buxhetore janë realizuar 545,274 mijë lekë nga 465,607 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 85 %. Në këtë masë realizimi ka ndikuar mosrealizimi në zërat e buxhetit:
Shpenzimet për investime llog. 230-231 janë realizuar ne masën 66%.
Shpenzimet për investime llog. 602 janë realizuar ne masën 79%.

Statusi: Proces zbatimi

12. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vëna në dizpozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Skrapar u konstatua se, Bashkia Skrapar në datën 01.01.2024 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 15,062,317 lekë. Detyrime të reja të krijuara janë në vlerën 6,054,908 lekë, totali progresiv i detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta dhe granti janë në vlerën 21,117,225 lekë. Detyrime të krijuara nga ministritë e linjës për investim janë në vlerën 595,320 lekë, detyrime për mallra dhe shërbime në vlerën 7,595,809 lekë, detyrimet nga vendimet gjyqësore në vlerën 1,472,287 lekë, dhe detyrime të klasifikuar si të tjera në vlerën 3,067,950 lekë. Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta Bashkia Skrapar ka marrë masa për shlyrjen e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",* pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura",* pikat 82-91. Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",* pika 101. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Përgjatë vitit 2025 dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2025 rezulton se në datën 31.12.2024 kanë qënë në vlerën 11,726 mijë lekë nga të cilat me burim financimi buxhetin e shtetit në vlerën 595 mijë lekë. Në datën 31.12.2025 janë në vlerën 38,300 mijë lekë nga të cilat me burim financimi buxhetin e shtetit 14,352 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 detyrimet e prapambetura janë rritur për vlerën 26,574 mijë lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Zbatuar plotësisht

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, si pasojë marrjes së angazhimeve buxhetore pa patur fonde në dispozicion, në 5 (pesë) raste janë hasur vonesa në likuidimin e faturave pjesore apo përfundimtare (për situacionet e punimeve) të kontratave të punimeve, apo shërbimeve jashtë afate të përcaktuara. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare",* neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin brenda afatit kohor që përcaktohet në kuadrin rregullator në fuqi, të gjitha detyrimet që ka ndaj të tretëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i transaksioneve me thesarin referuar programit te auditimit me nr.550/2, datë 22.05.2026 u konstatuan disa likuidime me afat mbi 30 ditor. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se, ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Nuk ka gjurmë auditimi mbi trajnimin e punonjësve të rekrutuar gjatë vitit 2024 për rregulloren e brendshme.

-Për vitin 2024 nuk administrohet plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme nuk është përditësuar me ndryshimet e strukturës.

-Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar).

-Nuk janë hartuar "Hartat e proceseve të punës".

-Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

-Nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i strategjisë së menaxhimit të riskut.

-Në Bashkinë Skrapar, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin Excel, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2024. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike";* Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 14-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi dy herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

14.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masa për mbajtjen e kontabilitetit si dhe administrimin e taksave dhe tarifave vendore nëpërmjet programeve kompjuterike të licencuara.

14.3. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

-Kryejen e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit "Harta e proceseve të punës".

-Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Brenda datës 31.12.2025

Qëndrimi i grupit të auditimit (14.1): Nga auditimi i pikës 1 të programit të auditimit auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatuar se nuk janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut, pasi nuk dokumentohet krijimi i grupit koordinues teknik të menaxhimit dhe raportimit të riskut për vitin 2025 gjithashtu nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i strategjisë së menaxhimit të riskut. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

Qëndrimi i grupit të auditimit (14.2): Nga auditimi i pikës 1 të programit të auditimit auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatuar se nuk janë marrë masa nga Bashkia Skrapar për administrimin të dhënave të taksave dhe tarifa vendore në sistem të licencuar.

Statusi: Pa zbatuar

Qëndrimi i grupit të auditimit (14.3): Nga auditimi i pikës 1 të programit të auditimit auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se nuk janë kryer ndryshimet në rregulloren e brendshme. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i organizimit dhe funksionimit të IMTV, u konstatua se, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes të Territorit Vendor, për vitin 2024, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), nuk është ngritur si strukturë. Në strukturën organizative të vitit 2024, të miratuar nga Këshilli Bashkiak, është përcaktuar një pozicion pune si "Inspektor" i mbrojtjes së territorit, pjesë e *"Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit"*. Për periudhën objekt auditimi, ky post pune mbulohet nga z. Z. M, me arsim të mesëm, dhe jo me arsim të lartë sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme jo në përputhje me**:** Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* neni 4, neni 11. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 81-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa për ngritjen e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit me punonjës të arsimuar sipas fushës së përcaktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i strukturës së Bashkisë Skrapar për periudhën dhjetor 2024- nëntor 2025 sipas VKB nr.68, datë 20.12.2024, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), nuk është ngritur si strukturë. Në strukturën organizative të vitit 2024, të miratuar nga Këshilli Bashkiak, është përcaktuar një pozicion pune si "Inspektor" i mbrojtjes së territorit, pjesë e *"Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit"*.

Statusi: Pa zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Skrapar përgjatë vitit 2024, u konstatua se:
-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm;
-Për vitin 2024, numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit ligjor sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë ka qenë vetëm 1 punonjës;
-Përgjegjësi i NJAB Skrapar nuk është i certifikuar si "Auditues i brendshëm në sektorin publik";
-Për periudhën 2024, konstatohet se, nuk janë mbuluar me auditim aktivitete/sisteme që kryen Bashkia Skrapar, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë;
-Nuk është realizuar plani i auditimeve, nga 7 auditime të planifikuara janë realizuar 6 prej tyre dhe për këtë nuk pasqyrohet arsye.
-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore;
-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën b neni 12 "ç" në nenin 6, nenin 13, shkronja "ç" në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";* Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë *"Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016";* Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 *"Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik";* Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2, faqe 20-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar, Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për, plotësimin e strukturës së NJAB Skrapar.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Skrapar, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisk të lartë, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Përgjatë vitit 2025 dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i pikës 1 të programit të auditimit auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua si mëposhtë:
-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me nenin 12, shkronja "b" dhe nenin 13 në Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;
-Për vitin 2025, numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë ka qenë vetëm 1 punonjës;
-Përgjegjësi i NJAB Skrapar nuk është i certifikuar si "Auditues i brendshëm në sektorin publik" në kundërshtim me shkronjën "b" pika 2 në nenin 11 në Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar;

-Për periudhën 2025, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim sisteme që kryen Bashkia Skrapar, me risk të lartë, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm "Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit".
-Nuk pasqyrohet metodologjia e vlerësimit të riskut për sistemet. Konkretisht në një dokument "Excel" pasqyrohet vlerësimi i tyre sipas shkallëve të riskut "I lartë", "I mesëm" dhe "I ulët", por nuk pasqyrohet metoda e ndjekur për klasifikimin sipas shkallëve të riskut.
-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" dhe nenin 19 pika 1 të Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë;
-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, në kundërshtim me paragrafin 6.3, Kreun 6 të Manualit të Auditimit të Brendshëm;
-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar;
-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2024 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën "ç" të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, "Për Auditin e Brendshëm Publik", i ndryshuar, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve;
-Nuk sigurohet zbatimi i parimit të përcaktuar në shkronjën "c" të nenit 7 në Ligjin nr. 114/2015, "Për Auditin e Brendshëm Publik", i ndryshuar, pasi në veprimtarinë audituese i njëjti person planifikon, organizon, auditon, kontrollon cilësinë e auditimit dhe njëkohësisht raporton.

Statusi: Në proces zbatimi

17. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i rekomandimeve, në mënyrë të përmbledhur i Raportit Përfundimtar të Auditimit me nr. 36/8 prot. datë 14.05.2024, statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:
-**Mbi respekitmin e afatit ligjor prej 20 ditësh,** Bashkia Skrapar ka respektuar këtë afat, në përputhje me nenin 15, shkronja "j", të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, duke kthyer përgjigje sipas shkresës me nr. 1745 Prot., datë 10.06.2024, bashkëlidhur Urdhërin nr.237, datë 30.05.2024 mbi planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.
-**Mbi respektimin e afatit ligjor prej 6 muajsh, Bashkia Skrapar ka marrë masat** për të raportuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, duke kthyer përgjigje me anë të shkresës me Nr. 3890 Prot., datë 13.11.2024.
-**Për përmirësimin e gjëndjes janë rekomanduar 14 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 12 masa. Nga masat e pranuara është zbatuar pjesërisht 1 masë, në proces zbatimi 1 masë dhe pa zbatuar janë 10 masa.
-**Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa** me vlerë 554,100 lekë, deri më datë 30.09.2024**,** të cilat janë pranuar plotësisht. Nga masat e pranuara, 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 1 masë është në proces zbatimi.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej 554,100 lekë, deri më datën 30.09.2024 është **arkëtuar** vlera prej 337,500 lekë. Ka mbetur pa u arkëtuar vlera prej 216,600 lekë, rekomandim i cili mban statusin në process zbatimi pasi ndodhet në proces gjyqësor.

-**Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia janë rekomanduar 2 masa**, të cilat janë pranuar plotësisht. Nga 2 masat e pranuara rezulton 1 masë zbatuar pjesërisht dhe 1 masë pa zbatuar.

-**Janë rekomanduar 28 masa disiplinore**, gjendja e të cilave paraqitet si më poshtë;

Sipas "Ligjit për Nëpunësin Civil" i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Skrapar, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 28 punonjës.

Nga verifikimi rezulton se janë dhënë 20 masa disiplinore "vërejtje". Statusi i këtij rekomandimi konsiderohet zbatuar pjesërisht.

Nisur nga sa më sipër, veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 82-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Për 11 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe sektorët e tjerë të Bashkisë Skrapar, të marrin masa për:

- Hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.
- Çdo viti buxhetor të përgatitë dhe të paraqesë për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor dhe në vijim KëshilliBashkiak Skrapar të marrë vendimet brenda afateve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar në vendimin nr.181 i përcjell në Bashkinë Skrapar me shkresën nr.87/8, datë 20.10.2025.

Statusi: Pa zbatuar

4.1.Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mosshlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e njësisë vendore gjatë vitit në vazhdim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar në vendimin nr.181 i përcjell në Bashkinë Skrapar me shkresën nr.87/8, datë 20.10.2025.

Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2024 kanë qënë në vlerën 11,726,202 lekë dhe në datën 31.12.2025 janë në vlerën 38,300,833 lekë nga këto me burim financimi nga buxheti i shtetit janë në vlerën 14,352,968 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave, të kryhen analizat e situatës për mos përmbushjen e procesit të inventarizimit të aktiveve me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive, marrjen e masave përkatëse për punonjësit të cilët nuk kanë zbatuar urdhërin e titullarit të Njësisë si dhe të kryhet procesi i inventarizimit sipas Udhëzimit përkatës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i pikës 3 të programit të auditimit me nr.50/1, datë 22.05.2026 u konstatua së nuk është kryer inventarizimi. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet

përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Skrapar të marrë të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane të parashikuar në dispozitat ligjore dhe rregullatorë, në çdo rast të respektohet distancat nga kufiri i pronës, lartësia maksimale e lejuar, ajo e katit përdhe dhe e çatisë, intensiteti maksimal dhe parcela minimale e lejuar.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar në vendimin nr.181 i përcjell në Bashkinë Skrapar me shkresën nr.87/8, datë 20.10.2025.

Statusi: Pa zbatuar

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Skrapar, të marrë masa:
- Për çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të kërkojë të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi.
- Përpara miratimit lejeve të sigurohet mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve si: plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të eficiencës së energjisë, etj.
- Të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar në vendimin nr.181 i përcjell në Bashkinë Skrapar me shkresën nr.87/8, datë 20.10.2025.

Statusi: Pa zbatuar

11.1.Rekomandimi:Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Skrapar para miratimit të lejeve të ndërtimit të kërkojë mendimin e autoriteteve përkatëse mbi konformitetin e objektit në zhvillim në raport me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve. Gjithashtu të kërkojë dhe marrë mendim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), mbi statusin juridik të pronave në zhvillim.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar në vendimin nr.181 i përcjell në Bashkinë Skrapar me shkresën nr.87/8, datë 20.10.2025.

Statusi: Pa zbatuar

12.1.Rekomandimi:Nga Bashkia Skrapar, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) dhe Struktura e Mbrojtjes së Territorit Vendor, të merren të gjitha masat për të mos lejuar zhvillimin e objekteve në mungesë të dokumentit të fillimit të punimeve, sipas parashikimeve ligjore, si dhe të ushtrojë masat parandaluese dhe administrative të parashikuara, për të gjitha rastet kur konstatohet kjo kundërvajtje.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimi i mësipërm është rikërkuar në vendimin nr.181 i përcjell në Bashkinë Skrapar me shkresën nr.87/8, datë 20.10.2025.

Statusi: Pa zbatuar

D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA

Për 2 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Skrapar, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2022, në vlerën totale 105,832 mijëlekë, e cila përbëhet nga:
- **95,805,410lekë** detyrime nga abonentët familjarë;
- **7,985,028 lekë** detyrime nga biznesi i madh;

- 561,579 lekë detyrime nga biznesi i vogël;
- 480,000 lekë detyrime nga qiratë e truallit;
a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare;
b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.
d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare, subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Skrapar, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohet vlera e detyrimeve të paarkëtuara, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i debitorëve familajrë dhe biznes në datën 31.12.2025 u konstatua si mëposhtë;
-Debitorë familjarë janë në vlerën 109,677,236 lekë.
-Debitorë familjarë janë në vlerën 11,577,856 lekë.
Gjatë vitit 2025 debia totale është në vlerën 121,255,092 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pallogaritur dhe papaguar në shumë 69,276,330 lekë.

F. MASA DISIPLINORE

Për 8 punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil, KLSH i rikërkon Kryetarit së Bashkisë Skrapar, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore (në proporcion me shkeljen e kryer), si vijon:
Shënim: Për punonjësit të cilët nuk janë më në marrëdhënie pune me këtë institucion, nuk rikërkohet masa disiplinore.
1. **Z. N. G**, me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave
2. Znj. F. B, Inspektor i taksave në NJA Çepan për periudhën 01.09.2022-31.12.2023
3. Znj. I. O, detyrë inspektore e menaxhimit të aseteve në cilësinë e kryetares së komisionit të inventarizimit
4. Z. B. M, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit
5. Znj. Xh. S, me detyrë ish përgjegjëse prokurimesh
6. Z. E. Y, me detyrë përgjegjës prokurimesh
7. Znj. J. K, me detyrë juriste
8. Znj. R. Ll, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga Bashkia Skrapar nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore. Për punonjësit e mësipërm është kërkuar masë edhe Raportin Përfundimtar të Auditimit përcjell me shkresën nr. 181/5 Prot., datë 20.10.2025

Statusi: Pa zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH-së, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për *vetëqeverisjen vendore*", **nga Titullari i njësisë publike,** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,112,294 lekë pa TVSh**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës "Arkitekt Kasëmi" dhe nr. 1566 prot., datë 24.05.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar, përfaqësuar nga Kryetari z. A. M. dhe shoqëria "B" sh.p.k me Nipt K54 dhe Liçensë me. Nr. NZ.0950/20, përfaqësuar nga Administratori znj. D. A, me vlerë të kontratës 28,540,291 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 77 (shtatëdhjetë e shtatë) ditë, nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: Zëri 3 (3.158/5a) Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km, Zëri 2(3.405/1) Prishje struktura prej betoni (para bizneseve dhe në trot. egzistues)], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Skrapar, në vlerën **663,820 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi",* i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 64-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **663,820 lekë pa TVSh** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "B" sh.p.k, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumin e situacionuara.

Menjëherë

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga subjekti Bashkia Skrapar nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e shumës 663,820 lekë.

Statusi: Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 2506 prot., datë 28.09.2023 dhe objekt: "Rikonstruksion i shkollës së mesme të përgjithshme "Ramiz Aranitasi" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Skrapar, përfaqësuar nga Kryetari z. A. M. dhe shoqërisë "F" sh.p.k me Nipt K17 dhe Liçensë me. Nr. NZ.4048/20, e përfaqësuar nga Administratori z. F. M. me vlerë të kontratës 43,167,046 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 120 ditë, nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe, garanci të punimeve 12 muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt – preventiv, përkatësisht: [Zëri 26 (3.158/5a) Suva brenda mur tulle h-4m me krah, llaç përzier M 25; Zëri 1 (2.358/b).; Zëri 11. Hidroizolim me dy shtresa mapej (izolimi i plasaritjeve në betonin e oborrit të shkollës)], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Skrapar, në vlerën **448,474.5 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve*

të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të spërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 64-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **448,474.5 lekë pa TVSh** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "F" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumin e situacionuara.

Menjëherë

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga subjekti Bashkia Skrapar nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e shumës 448,474 lekë.

Statusi: Pa zbatuar

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Skrapar, rezulton se, në fund të vitit 2023 janë krijuar debitorë nga biznesi në total 59 subjekte për vlerën 7,130,924 lekë. Përsa i përket debisë progresive më 31.12.2024 janë 68 subjekte debitore për vlerën 10,829,295 lekë. Nga auditimi lidhur me debitorët familjarë u konstatua, se në fillim të vitit 2024, debia është në vlerën 91,647,127 lekë, familje debitore të krijuara brenda vitin 2024 është në vlerën 9,744,853 lekë, familje debitore në fund të vitit 2024 është në vlerën 101,391,980 lekë. Në lidhje me debitorët për taksën e tokës bujqësore rezultoi se, vlera debitore në fillim të vitit 2024 është në vlerën 65,693,222 lekë, si rrjedhojë debia e krijuar në vitin 2024 është në vlerën 4,912,040 lekë, dhe debia progresive është në vlerën 70,605,262 lekë. Nga auditimi rezultoi se, debitorët nga taksa e tokës bujqësore zën 69.6 % të debitorëve familjarë.
Nga auditimi konstatohet se, detyrimi tatimorë progresiv nga bisneset dhe familjet është në vlerën 112,221,275 lekë i cili përbëhet nga:
-Debitorë nga Biznesi madh janë në vlerën 10,386,639 lekë.
-Debitorë nga Biznesi vogël janë në vlerën 442,656 lekë.
-Debitorë familjarë janë në vlerën 101,391,980 lekë.
Nga auditimit u konstatua se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2024, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar ndaj debitorëve të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,* nenet 89, 90, 91, 93, 94. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtartë Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Skrapar, si Drejtoria e Aseteve, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **112,221,275 lekë** për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i debitorëve familajrë dhe biznes në datën 31.12.2025 u konstatua si mëposhtë;
-Debitorë familjarë janë në vlerën 109,677,236 lekë.

-Debitorë familjarë janë në vlerën 11,577,856 lekë.
Gjatë vitit 2025 debia totale është në vlerën 121,255,092 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qirasë u konstatua se, për vitin 2024, Bashkia Skrapar ka pasur 27 kontrata aktive të dhëna me qira. Në tre raste të dhënies së pronës publike me qira, grupi i auditimit ka përllogaritur detyrime të paarkëtuara në vlerën 132,250 lekë. Për vitin 2024, Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, Bashkia Skrapar ka pasur 23 kontrata qiraje aktive. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor u konstatua se në dy raste të dhënies së pronës publike me qira, nuk është arkëtuar vlera 2,664,175 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" *Aneksi nr.A2* VKB-në nr. 31, datë 23.11.2022 "Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024" nenin 3, neni "Pagesa e Qirasë", *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 70-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar dhe Drejtori i NSHP të marrin masa për arkëtimin e detyrimeve nga dhënia e pasurive me qira, përkatësisht në vlerën 132,250 lekë, të krijuara nga mos likuidimi i qirasë për kontratat të cilat janë dhënë nga Aparati Bashkia Skrapar dhe vlera 2,837,420 lekë për kontratat e dhëna me qira nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor për vlerën në total 2,969,670 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi u konstatua se në pikën 16 të urdhërit është cilësuar se drejtoria e të ardhura duhet të marrë masa për arkëtimin e vlerës 132,250 lekë, kjo vlerë është paguar tërësisht, ndërsa arkëtimi i vlerave të tjera nuk është zbatuar.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nga kryqëzimi i informacionit, regjistrit të taksapaguesve, dosjeve fizike, dhe QKB-së, rezultuan disa subjekte të cilat janë tarifuar nga ana e Drejtoria e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore, pa patur informacionin e duhur në lidhje me xhiron vjetore të subjekteve, por është vepruar duke tarifuar subjektet duke i'u referuar viteve paraardhëse dhe jo referuar vitit koherent. Nga auditimi me përzgjedhje i subjekteve, dhe verifikimit nëpërmjet regjistrit të veprimeve u konstatua se, është tarifuar subjekti N Xh për tarifën e shfrytëzimit të infrastrukturës rrugore në vlerën 75,000 lek, tarifë e cila llogaritet sipas paketës fiskale për subjektet që ushtrojnë aktivitet në çdo subjekt fizik dhe juridik me aktivitet përpunim të gurit të mermerit, gurit të zi, guri dekorativ dhe inerte në vlerën 100,000 lekë pra është tarifuar me një diferencë prej 25,000 lekë më pak. Është tarifuar për tarifën e pastrimit në vlerën 90,000 lekë, ndërsa në paketë fiskale është përcaktuar 120,000 lekë tarifuar 30,000 lekë më pak, ku llogariten të ardhura të munguara në vlerën 55,000 lekë.
-Subjekti P M me Nipt K04 është tarifuar për tarifën e pastrimit në vlerën 87,000 lekë në paketën fiskale llogaritet 120,000 lekë me një diferencë prej 33,000 lekë më pak vlerë e cila përbën të ardhura të munguara pë buxhetin e Bashkisë Skrapar.

-Subjektit K S me Nipt L59 me aktivitet: tregëti me shumicë dhe pakicë të mermerit, konstatohet se është tarifuar për llojin e tarifës "shfrytëzimin e infrastrukturës rrugore" në vlerën 100,000 lekë. Duke iu referuar ekstraktit në QKB rezulton se në datën 27/12/2022 janë bërë ndryshimet si më poshtë:
Numri i cështjes: CN-042101-12-22 Arsyet e hapjes së çështjes: Depozitimi i vendimit, datë 02.12.2022 për ndryshim objekti aktiviteti. Objekti ishte ("Tregëti me shumicë dhe pakicë të mermerit. Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit dekorativ. Import - eksport të gurit dhe *mermerit"*) u bë ("Tregti me shumice dhe pakicë të mermerit. Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit dekorativ. Import - eksport të *gurit dhe mermerit*. *Shfrytëzim mineraleshme punime sipërfaqesore* (gurë *gëlqeror,* ranor pllakor, gëlqeror pllakor) në zonën minerare 56/3 Polene Skrapar si dhe tregëtim import-eksport të gurit etj.") pra ajo që konstatohet është se, lloj aktiviteti, tarifohet në vlerën 300,000 lekë sipas paketës fiskale, në këtë rast është tarifuar 200,000 lekë më pak, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar. Nga auditimi u konstatua se, nga llogaritja e gabuar e subjektit të audituar, janë akumuluar të ardhura të munguara në vlerën 343,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me paketën fiskale *pika 2, pika 2.2, pika 2.3, pika 2.4 miratuar me VKB nr.31, datë 23.11.2023, dhe konfirmuar në prefekturë me shkresën nr.837/1, datë 04.12.2023.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtartë Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore, të kryej tarifimin e saktë bazuar në "Paketën Fiskale", gjithashtu të marri masa administrative e ligjore për arkëtimin vlerës **343,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara, krijuar si rezultat i tarifimit të gabuar dhe mos pasjes së informacionit të saktë mbi subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Skrapar si dhe të merren masa dhe për kontabilizimin e vlerës nga struktura përgjegjëse e financës

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i ngarkesës fiskale sipas paketës fiskale për vitin 2025 në Bashkinë Skrapar nuk janë konstatuar ngarkesa jo në përputhje me paketën fiskale të miratuar për vitin 2025. Gjatë vitit 2025 është arkëtuar vlera 92,500 lekë.

Statusi: Në proces zbatimi

E. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e vëna në dizpozicion nga Dretoria e Financës dhe Buxhetit Skrapar u konstatua se, Bashkia Skrapar ka patur detyrime në fillim të vitit, në vlerën 5,017,764 lekë për zbatimin e vendimeve gjyqësore, ndërsa detyrimi i krijuar gjatë vitit 2024 është 238,931 lekë, vlera e shpenzuar për vendime gjyqësore në vitin 2024 është 3,784,408 lekë, vlerë e cila i përket vendimeve gjyqësore për faturat e ardhura nga bizneset me objekte të ndryshme, vlera e shpenzuar për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024 nga Bashkia Skrapar, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",* i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar të ngrejë një grup pune ku të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë në vijimësi, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të

ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjet e ndryshme, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për pagesat për vendimet gjyqësore për vitin 2025 rezulton se nuk ka pasur vendime të reja te kontabilizuara. Gjatë vitit 2025 janë shpenzuar 216,052 lekë për 1 (një) vendim gjyqësor. Fondet e shpenzuara kanë ardhur nga Ministria e Shëndetësisë sepse janë vendime gjyësore për pension invaliditeti në të cilat ka qënë palë e paditur Ministria e Shëndetësisë dhe këto pagesa kryer nëpërmjet Bashkive sepse kryejnë si funksion të deleguar pagesat për përsonat me aftësi të kufizuar.

Statusi: Zbatuar plotësisht

2. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për procedurën me objekt: *Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës Zylyftar Veleshnja*" me fond limit 1,644,859 lekë pa TVSH rezultoi se kanë marrë pjesë ofertuesit me vlerat përkatëse të ofruara: OE D sh.p.k. me vlerë oferte 1,354,750 lekë pa TVSH, OE "2A" sh.p.k. me vlerë **1,628,960** lekë pa TVSH, OE "E" sh.p.k. me vlerë **1,256,770** lekë pa TVSH, dhe OE "N" Sh.p.k me Nipt J87 me vlerë 1,263,850 pa TVSH.

Nga auditimi u konstatua se, është skualifikuar Operatori Ekonomik "E" sh.p.k. me vlerë oferte 1,256,770 lekë pa TVSH me ofertën më e ulët në klasifikim, për arsyen se nuk ka paraqitur punonjësit në listpagesë sipas kodeve të profesionit. Po ti referohemi OE fitues u konstatua se, është kualifikuar duke pasur të njëjtën mangësi si OE i skualifikuar për arsyen se nuk ka deklaruar punonjësit sipas kodeve të punësimit dhe si rrjedhojë KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik me ofertë më të lartë, me pasojë efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë në vlerën 372,190 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*" neni 2 pika d, pikën 2 të nenit 82 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 36-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrë masa për garantimin e përdorimit me efektivitet të fondeve në dispozicion, duke vlerësuar me kujdes dhe paanshmëri mangësitë që çojnë në skualifikimin e operatorëve ekonomik, sidomos në rastet kur kjo vendimmarrje shoqërohet me pasoja financiare.

Në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me rekomandimin 2.1, grupi i auditimit në bazë të Programit të Auditimit nr.550/1, datë 22.05.2026 i cili përfshin auditimin e pasqyrave financiare, menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm. Në lidhje me rekomandimet për prokurimet publike grupi i auditimit nuk mund të shprehet, por do të rikërkohet në auditimin e rradhës**.**

Statusi: Pa zbatuar

F. MASA DISIPLINORE

H1. Për punonjësit në marrëdhënie pune Mbështetur në Nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSh-së*", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin*

e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Skrapar, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

a.*"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", gërma "c" e nenit 58, për 2 punonjës, si më poshtë*:

1. Z. N. G, me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në procedurën me objekt: "*Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës Zylyftar Veleshnja*", në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik, dhe OE fitues është kualifikuar me të njëjtat mangësi me OE e skualifikuar. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

2. Znj. R. Ll, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në në procedurën me objekt: "*Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës Zylyftar Veleshnja*", në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik, dhe OE fitues është kualifikuar me të njëjtat mangësi me OE e skualifikuar. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

b. "Vërejtje" për 20 punonjës si më poshtë:

1. Znj. H. B, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

2. Z. E. O, inspektor i taksave dhe i tarifave Njësia administrative Potom, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

3. Znj. L. B, inspektore taksash Njësia administrative Leshnjë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

4. Z. I. G, inspektor taksash Njësia administrative Çepan, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

5. Z. N. D, inspektor taksash Njësia administrative Vëndreshë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

6. Z. A. M, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia Vëndreshë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët;

për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
7. **Z. N. K,** inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia administrative Bogovë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
8. Z. K. M, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia administrative Bogovë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
9. Z. F. F, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia administative Gjerbës për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
10.Z. K, A, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia Administative Zhepë, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
11. Znj. B. Ç. inspektor i taksava dhe i tarifave vendore për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
12. Z. A. L, në cilësinë e nëpunësit pranë Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, në 3 raste ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;
-Në cilësinë e nëpunësit pranë Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të zhvillimit dhe përdorimit të miratuara. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
13. Z. E. Y, me detyrë përgjegjës prokurimesh, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, pasi ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;
-Për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".
14. Znj. E. H, me detyrë juriste, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, për mangësitë në hartimin e fondit limit për procedurën me objekt: "*Blerje nafte për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Skrapar për vitin 2024*", Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".
15. Znj. J. K, me detyrë juriste, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, pasi në **2 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit; Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë

19.05.2021“*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.
16. Znj. L. H, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Gjelbërimit, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, për mangësitë në hartimin e fondit limit për procedurën me objekt: “*Blerje nafte për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Skrapar për vitin 2024*”, Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.
17. Z. D. M, me detyrë Mbikëqyrës në sektorin e Mbikëqyrjes së Rrugëve Rurale, në NShP Bashkia Skrapar, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, për mangësitë në hartimin e fondit limit për procedurën me objekt: “*Blerje nafte për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Skrapar për vitin 2024*”. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.
18. Z. E. O, me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Skrapar, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor NSHP, Bashkia Skrapar, për miratimin e disa procedurave të prokurimit, dhe për lidhjen e kontratave me operatorë ekonomikë të cilët kanë dorëzuar dokumentacion jo të plotë në funksion të kritereve të përcaktuara në DT. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.
19. Znj. A. K, me detyrë Përgjegjës i sektorit të Arsimit, Sportit dhe Kulturës, për mangësitë e konstatuara në procedurën me objekt: “*Blerje pajise mobilerie për shkollën e mesme*”. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.
20. Z. F. O, në cilësinë e NJP për mangësitë e konstatuara në procedurën me objekt: “Blerje pajise mobilerie për shkollën e mesme”. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion rezulton se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore.

Statusi: Pa zbatuar

H.2. Për punonjësit e larguar:

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre:
1. Z. B. M, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të zhvillimit dhe përdorimit të miratuara.
- Në cilësinë e Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në 3 raste, në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik, aktualisht i larguar nga puna.

H.3. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Skrapar, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe

nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Skrapar.
2. Z. N. G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.
3. Znj. H. B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve auditimi financiar i dërguar me shkresën 322/7 prot, datë 12.02.2026 në mënyrë të përmbledhur paraqitet zbatimi i rekomandimeve si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Bashkia Skrapar nuk *ka respektuar* këtë afat, duke mos dërguar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
-Sa më sipër Bashkia Skrapar është brenda afatit 6-mujor dhe në këto kushte nuk mund të shprehemi për zbatimin ose moszbatimin e këtij detyrimi.

III. Rekomandimet e KLSH
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 322/7 prot., datë 12.02.2026, janë rekomanduar gjithsej 22 rekomandime:
a. Janë rekomanduar **19 masa *organizative*;**
c. Është rekomanduar **1 masë *për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;***
d. Është rekomanduar **1 masë *për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet;***
e. Janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Skrapar që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 2 punonjës** të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me Nr. 322/7 Prot., datë 12.02.2026, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (BashkiaSkrapar)	Pa pranuar
1	Organizative	19 masa	19 masa	-
2	Për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;	1 masë	1 masë	-
3	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet;	1 masë	1 masë	-
4	Masa Disiplinore	2 masa	2 masa	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	19 masa	9 masa	-	-	10 masa
2	Për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia;	1 masa	-	-	-	1 masë
3	Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet;	1 masë	-	-	1 masë	-
4	Masa Disiplinore	2 masa	-	-	-	2 masë

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:

Nga 46 (dyzet e gjashtë) rekomandime të dhëna për t'u zbatuar nga Bashkia Skrapar, niveli i zbatimit paraqitet si më poshtë vijon:

- 19 (nëntëmbëdhjetë) rekomandime organizative janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 9 (nëntë) prej tyre si dhe pa zbatuar 10 (dhjetë) masa. Nga masat e pa zbatuara 8 (tetë) prej tyre do të rikërkohen përsëri në auditimin aktual.
- 1 (një) masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e cila është e pa zbatuar.
- 1 (një) masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet e cila është në proces zbatimi.
- 2 (dy) masa disiplinore ndaj 2 punonjësve të cilat nuk janë zbatuar të cilat janë rikërkuar edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit 181/5 Prot., datë 20.10.2025.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në lidhje me procedurën e vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit në Njësinë Shpenzuese të Ndërmarrjes së Shërbimit Publik u konstatua se në të njëjtën ditë ka dalë urdhri për ngritjen e komisionit dhe në të njëjtën ditë është mbajtur proces verbali për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit dhe në të njëjtën ditë është mbajtur proces verbali për asgjësimin e tyre. Proces verbalet për vlerësimin dhe asgjësimin kanë të dhëna të pasakta në lidhje me llojin e mallrave, gjendjen, natyrën e tyre, sasinë dhe çmimin dhe përmbajnë 56 artikuj në vlerën 1,735,741 lekë. Në Pasqyrat financiare për nxjerrjen jashtë përdorimit është reflektuar vlera prej 115,992 lekë që i përket llogarisë 218 "*Inventar ekonomik*", ndërsa diferenca prej 1,619,749 lekë (1,735,741-115,992) nga ana e Drejtorisë se Menaxhimit

Financiar dhe te Ardhurave është lenë gjendje inventari, nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare si nxjerrje jashtë përdorimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, neni 8, germa (ç) dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, pika 95, pika 106 dhe pika 114. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 16-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për saktësimin e procedurës së nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave në Njësinë Shpenzuese të Ndërmarrjes së Shërbimit Publik për vlerën 1,619,749 leke, duke ngritur komision të posaçëm të vlerësimit dhe asgjësimit, si dhe duke përfshirë kontrollin fizik e financiar të aktiveve si dhe të informojë Këshillin Bashkiak për efektet ekonomike dhe vendimet për nxjerrje jashtë përdorimit.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar për vitin 2025 u konstatua se nuk është kryer inventarizimi në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik".*Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Skrapar, mbahet në mënyrë manuale duke përdorur programi excel, e cila ka risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që gjenerohet nga ky sistemi për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të njësisë dhe njësive të vartësisë. Programi excel nuk përbën një "bartës informatik" të specializuar, i cili të garantojë mosmanipulimin e të dhënave, si dhe mundësinë e gjenerimit dhe printimit të informacionit në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mos besueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekte. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare si dhe në ruajtjen e gjurmës së auditimit, Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 6/d, neni 12/dh. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që mbajtja e kontabilitetit në Bashkinë Skrapar dhe njësite e varësisë të kryhet nëpërmjet programeve financiare të autorizuara të pa manipulueshme në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare si dhe në ruajtjen e gjurmës së auditimit.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatuar se kontabiliteti për vitin 2025 nuk mbahet në një sistem të monitoruar dhe të sigurt por mbahet në exel sistem i cili nuk ofron siguri për mbartjen e informacionit.

Statusi: Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua që llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar në vlerën 36,880,205 lekë ose në vlerën 309,195 lekë më shumë se akt rakordimi me thesarin (36,880,205 - 36,571,010). Llogaria

466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" nuk rakordon me të dhënat e thesarit për vlerën prej 309,195 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar pika 3, nënpika 28, 29. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë llogarinë 466"*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në pasqyrën e pozicionit financiar për diferencën e mbivlerësuar prej 309,195 lekë më shumë se akt rakordimi me thesarin dhe ta paraqesë saktë atë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatuar se llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në pasqyrën e pozicionit financiar është kontabilizuar për vlerën 9,528,267 lekë, referuar akt rakordimit me thesarin të datës 27.01.2026 është në vlerën 9,219,072 lekë. Kjo llogari është mbivlerësuar për vlerën 309,195 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual

Statusi: Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi paraqitjen e saktë të llogarive kontabël të inventarëve në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar, u konstatua se Njësia Shpenzuese "*Ndërmarrja e Shërbimeve Publike*" ka kryer pasqyrim të gabuar të disa llogarive, konkretisht:

Në llogarinë 32 "*Inventarë i imët*" është paraqitur vlera 1,414,995 lekë, e cila duhej të pasqyrohej në llogarinë 31 "*Materiale*"; Në llogarinë 33 "*Prodhim në proces*" është paraqitur vlera 1,810,152 lekë, e cila duhej të pasqyrohej në llogarinë 32 "*Inventarë i imët*".

Si rrjedhojë e këtyre pasqyrimeve të pasakta, llogaria 31 "*Materiale*" rezultoi e nënvlerësuar me 1,414,995 lekë; llogaria 33 "*Prodhim në proces*" rezultoi e mbivlerësuar me 1,810,152 lekë dhe llogaria 32 "*Inventarë i imët*" rezultoi e nënvlerësuar në vlerën 395,157 lekë (1,810,152 – 1,414,995). Këto pasqyrime të pasakta kanë sjellë paraqitje jo të drejtë të inventarëve në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* "i ndryshuar, Aneksi 1, pika 3.1 dhe Kapitulli III. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, në bashkëpunim me Njësinë e Varësisë "Ndërmarrja e Shërbimeve Publike", të marrin masa për rishikimin e regjistrimeve kontabël dhe të bëjnë korrigjimin e debive dhe kredive në llogaritë 31 "*Materiale*", 32 "*Inventarë i imët*" dhe 33 "*Prodhim në proces*", në mënyrë që saldoja e inventarëve të pasqyrohet saktë në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatuar se Njësia Shpenzuese "*Ndërmarrja e Shërbimeve Publike*" në llogarinë 31 "Materiale" e ka kontabilizuar për vlerën 1,266,552 lekë dhe llogarinë 32 "Inventar i imët" e ka kontabilizuar për vlerën 1,230,879 lekë në përputhje me udhëzimin nr. 8 dhe nomenklaturë e llogarive kontabël.

Statusi: Zbatuar plotësisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi paraqitjen e drejtë të llogarive në pasqyrat e konsoliduar të pozicionit financiar, rezultoi se Njësia Shpenzuese "*Ndërmarrja e Shërbimeve Publike*" ka pasqyruar gabimisht vlerën 6,802,914 lekë në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", vlerë e cila duhej të regjistrohej në llogarinë 4342 "*Operacionet me shtetin të drejta*".
Llogaria 4342 *"Operacione me shtetin të drejta"* e pasqyruar në fund të vitit 2024 në vlerën 26,036,121 lekë në pasqyrat financiare të konsoliduar është nënvlerësuar për vlerën 6,802,914 lekë dhe nuk kuadron me kundër partitë e saj që janë llogaria 401-408 *"Furnitorë e llogari te lidhura me to"*, llogaria 42 "*Detyrime ndaj personelit",* llogaria *431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa",* llogaria 435 *"Sigurime Shoqërore",* llogaria 436 "*Sigurime Shëndetësorë*". Nga analiza e kryer rezulton se Njësia Shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimeve Publike(NSHP) e ka paraqitur llogarinë 4342 *"Operacione me shtetin të drejta"* në fund të vitit 2024 në vlerën zero lekë kur kundër partitë e saj janë në vlerën 6,802,914 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh"; me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39 si dhe Kapitulli III. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 21-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Njësinë Shpenzuese Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike të marrin masa që të pasqyrojnë saktë në pasqyrën e pozicionit financiar mospërputhjen për llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" e cila në krahasim me thesarin është mbivlerësuar në vlerën 6,802,914 lekë dhe llogarinë 4342 *"Operacione me shtetin të drejta"* e cila është nënvlerësuar për vlerën 6,802,914 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar individual për "*Ndërmarrja e Shërbimeve Publike*" nu konstatua se llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* është kontabilizuar për vlerën 0 lekë. Llogaria 4342 *"Operacione me shtetin"* është kontabilizuar për vlerën 7,332,555 lekë kjo llogari kuadron me llogaritë e klasës 4 si 401-408 *"Furnitorë dhe llogari të lidhura me to"* është kontabilizuar për vlerën 705,480 lekë, llogaria 42 *"Detyrime ndaj personelit"* është kontabilizuar për vlerën 5,556,389 lekë, llogaria 431 *"Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"* është kontabilizuar për vlerën 124,352 lekë, llogaria 435 *"Sigurime shoqërore"* është kontabilizuar për vlerën 849,953 lekë dhe llogaria 436 *"Sigurime Shëndetsore"* është kontabilizuar për vlerën 96,381 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pozicionit financiar të pasqyrave të konsoliduar u konstatua që gjendja e llogarisë 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*", në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 26,036,121 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me llogarinë 7206 "*Financim i pritshëm nga buxheti*" të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 1,920,164 lekë. Diferenca prej 24,115,957 lekë (26,036,121 - 1,920,164) konstatohet në pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar (qendër).
Llogaria 4342 *"Operacione me shtetin të drejta"* duhej te paraqitej në vlerën 32,839,035 lekë (26,036,121 + 6,802,914). Vlera e llogarisë 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*" duhet të jetë e barabartë me llogarinë 7206 "*Financim i pritshëm nga buxheti*" të Pasqyrës së Performancës Financiare.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", Kreu III. "*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, pika 32. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 22-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është nënvlerësuar për vlerën prej 32,839,035 lekë që i korrespondon me kundër partinë e saj llogarisë 4342 *"Të tjera operacione me shtetin të drejta"*.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se llogaria 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*" është kontabilizuar për vlerën 31,796,332 lekë, llogaria 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* është kontabilizuar për vlerën 0 lekë. Kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 31,796,332 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat analitike të llogarisë 202 "*Studime dhe kërkime"* rezultojnë 25 studime dhe projektime të pasqyruara në vlerën e tyre historike 106,814,857 lekë. Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se:

- Llogaria 230-231 *"Investimet"* është në vlerën zero lekë. Nga të dhënat e llogarisë 230-231 "*Investime*" në pasqyrën e pozicionit financiar nuk paraqitet asnjë objekt që të jetë në proces pasi kapitalizimi i aktiveve është bërë sipas likuidimeve pjesore vjetore dhe jo sipas përfundimit të objekteve dhe akteve të marrjes në dorëzim të tyre. Nga analiza e kryer rezulton që në 31.12.2024 janë 8 objekte me vlerë 70,602,709 lekë, investime, për të cilat grupit të auditimit nuk ju paraqit certifikata e marrjes në dorëzim.
- Në përbërje të llogarisë 202 "*Studime dhe kërkime"* janë 6 projekte të cilat lidhen me ujësjellës me vlerë historike 78,985,358 lekë që duhet t'i bashkëngjiten kapitalizmit të aktiveve dhe të transferohen në *"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar Sha"* me NIPT. M23.
- Nga të dhënat e llogarisë 202 "*Studime dhe kërkime"* rezultoi se nuk ka informacion në lidhje me përfundimin e objekteve që u përkasin 13 projektet në vlerën 14,852,624 lekë.

Për sa më sipër kontabilizimit i pakësimit të llogarisë 230 - 231 *''Investime në proces''* nuk paraqet një pamje te drejte në shtesat e llogarive të aktiveve të qëndrueshme jo materiale dhe materiale përkatësisht llogaritë 202, 212, 213, 214.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Kreu, Aneksi 1 pika 2, klasa 2, pika 5 dhe pika 2.1.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 24-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë llogarinë 230-231 "*Investime*" në pasqyrën e pozicionit financiar për objektet që janë në proces dhe nuk kanë përfunduar dhe marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se llogaria 230-231 "*Investime*" është kontabilizuar për vlerën 0 lekë. Referuar kontabilizimeve në llogaritë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione" në vlerën 18,153,568 lekë* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në vlerën 49,732,367 lekë, këto kontabilizime nuk janë investime të përfunduara por pagesa pjesorë për investimet dhe duhet të kontabilizohen në llogarinë 230-231 "*Investime*" deri në momentin e marrjes në dorëzim të investimit. Llogaria 231 "Investime" është nënvlerësuar për vlerën 67,885,935 lekë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë llogarinë 202 "*Studime dhe kërkime"* në pasqyrën e pozicionit financiar për 6 projekte të cilat lidhen me ujësjellës me vlerë historike 78,985,358 lekë që duhet t'i bashkëngjiten kapitalizmit të aktiveve dhe të transferohen në *"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar Sha"* me NIPT. M23. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit. Bashkia Skrapar nuk ka transferuar asnjë aktiv tek *"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar Sha".* Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

7.3. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje me përfundimin e objekteve që u përkasin 13 projektet në vlerën 14,852,624 lekë për të cilat nuk ka informacion. Për objektet e përfunduara të marrë masa për kapitalizimin e tyre në shtesa të llogarisë 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*" dhe në llogarisë 213 "*Rruge, rrjete, vepra ujore*" dhe llogarinë 214 "*Instalime teknike makineri e pajisje*".

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se për projektet me vlerë 14,852,624 nuk janë kryer investimet përkatëse.

Statusi: Në proces

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Llogarisë 210 "*Toka, troje, terrene*", u konstatua se, nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit;

a) trojet nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, dhe të zyrave në Njësive Administrative, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "*Ndërtime e konstruksione*".

b) trualli i godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojet të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Skrapar, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 "*Toka, troje terrene*" rezultoi se kjo llogari nuk paraqet një pamje drejtë për pasqyrat financiare të vitit 2024, pasi kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 "*Toka, troje terrene*", si dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në

Pasqyrat Financiare rezultojnë të paplota, për shkak të mungesës së analizave shoqëruese dhe detajuese.
Mungesa e analizimit të kësaj llogarie ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 25-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të ngrenë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Skrapar të kaluar me VKM për llogarinë 210 "*Toka, troje terrene*". Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të merren masa për kontabilizimin e saktë të kësaj llogarie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i llogarisë 210 "*Toka, troje terrene*" u konstatua së nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit, nuk është ngritur grup pune për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të transferuara me VKM. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur u konstatua se në llogarinë. 211 "*Pyje, kullota, plantacione*", është pasqyruar vetëm "*Pyllëzimi Kurorës së Qytetit të Çorovodës*" në vlerën 6,911,988 lekë. Bashkia Skrapar nuk ka bërë vlerësimin e pyjeve dhe kullotave të transferuara, për rrjedhojë dhe në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Skrapar, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr. 4, e cila përmban,
a) listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Skrapar, me numër rendor nga 1(një) deri 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy).
b) godinën e DSHP-së.
Për këto sipërfaqe nuk është bërë verifikimi fizik dhe vlerësimi i tyre, me qëllim përcaktimin e e saktë të vlerës kontabël të llogarisë 211 "*Pyje, kullota, plantacione*".
Gjithashtu, për këto llogari, në Bashkinë Skrapar mungon një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, periudhat e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.
- Nga auditimi i llogarisë 212 *"Ndërtime e konstruksione"* në lidhje me kontabilizimin e tyre u konstatua se për një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë në verifikim për regjistrimin e tyre ka pasaktësi në pasqyrimin në kontabilitet në lidhje me sipërfaqen, gjendjen e tyre, truallin nën objekt dhe sipërfaqet rrethuese. Një pjesë e objekteve janë të trashëguara dhe të mbartura nga njësitë që u shkrinë (*ish/komunat*) dhe janë të pa shoqëruar me kartela objekti. Për çdo objekt të

llogarisë 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*" nga Bashkia Skrapar, nuk është bërë verifikimi dhe hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara, saktësimi i objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizim fizik i objektit, si dhe rivlerësim me normat për secilin objekt.
Sa më sipër llogaria 212 *"Ndërtime e konstruksione"* dhe llogaria 211 "*Pyje Plantacione"* nuk paraqesin një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024. Nga titullari i Bashkisë Skrapar, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015*"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 *"Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë";* Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* i ndryshuar Kap III, pika 30,. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II, nënpika 2, faqe 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 26-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Skrapar për llogarinë 211 "*Pyje Plantacione*" dhe llogarinë 212 *"Ndërtime e konstruksione",* në lidhje me gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i llogarisë 211 "*Pyje, kullota, plantacione*", 212*"Ndërtime e konstruksione"* u konstatua së nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit. Në këto 2 llogari kontabilizohen vetëm investimet e reja që kryhen gjatë vitit. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar u konstatua që llogaria 26 "*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*" në datën 01.01.2024, është paraqitur në vlerën zero lekë dhe në datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën zero lekë.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Skrapar është aksionarë në Shoqërinë e re të krijuar *"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar Sha"* me NIPT M23, shoqëri e krijuar në bazë të akt marrëveshjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfaqësuar nga AKUM me nr.7183.prot., datë 28.09.2022 dhe Bashkitë Skrapar, Kuçove, Dimal, Poliçan dhe Skrapar. Bazuar në këtë akt-marrëveshje kapitali fillestar i shoqërisë është 10,000,000 lekë ku Bashkia Skrapar zotëron 4,7% të aksioneve ose në vlerë kapitali 470,000 lekë (10,000,000*4,7%).
Nga auditimi u konstatua që Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave e Bashkisë Skrapar nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në Shoqërinë e re të krijuar *''Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar Sha''* me NIPT M23 për vlerën prej 470,000 lekë. Llogaria 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vetë*", nuk paraqet situatën e saktë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar, me qëllim pasqyrimin e drejtë të vlerës prej 470,000 lekë në llogarinë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*", që i përket pjesëmarrjes në shoqërinë "*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar*" sh.a., me NIPT M23.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se llogaria 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" është kontabilizuar për vlerën 0 lekë. Vazhdon mos të kontabilizohen kuota përkatëse në shoqërinë "*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar*" sh.a. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që llogaria 401-408 "*Furnitorë e llogarite lidhura me to"* në pasqyrat financiare të konsoliduar është paraqitur në vlerën 4,316,066 lekë që përben detyrimet e bashkisë për fatura të mbërritura të pa paguara. Llogaria 467 "*Kreditore te ndryshëm"* është paraqitur në vlerën prej zero lekë në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar. Nga auditimi i të dhënave për detyrimet e prapambetura të Bashkisë Skrapar (Qendër) u konstatua që me shkresën nr.480.prot., datë 10.02.2025 për dërgimin e Raportit të Vetëvlerësimit Financiar për vitin 2024 dhe paraqitjen pranë Ministrisë se Financave të *"Detyrimeve ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiare normale dhe rastet e vështirësisë Financiare"* janë paraqitur detyrime të prapambetura ndaj të tretëve në vlerën 12,137,246 lekë dhe vlera 595,320 lekë për detyrime për kontrata të lidhura nga Ministritë e Linjës. Në total detyrime të prapambetura të paraqitura në Ministrinë e Financave sipas të dhënave të detajuara janë 12,732,566 lekë. Nga tërësia e të dhënave të raportuara në Ministrinë e Financave për llogarinë 4864 *"Detyrime ndaj te treteve"* u konstatua që në pasqyrat e pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar janë pasqyruar me pak detyrime ndaj te treteve në vlerën 8,416,500 leke (12,732,566 - 4,316,066) ku vlera prej 4,316,066 leke është vlera e pasqyruar në llogarinë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to"*. Nga auditimi u konstatua që llogaria 467 "*Kreditore te ndryshëm"* është nënvlerësuar për vlerën prej 8,416,500 lekë (12,732,566 - 4,316,066).

Këto janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar pika 15 Seksioni *3*.1, paragrafi 42. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 33-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje me pasqyrimin e llogarisë 467 "*Kreditore të ndryshëm"* e cila është nënvlerësuar për vlerën prej 8,416,500 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua detyrimet e prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale janë në vlerën 17,090,196 lekë. Llogaria 467 "*Kreditore te ndryshëm"* është kontabilizuar për vlerën 0 lekë. Kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 17,090,196 lekë.

Statusi: Pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i u konstatua se llogaria 42 "*Detyrime ndaj personelit"* në pasqyrën e pozicionit financiar të bilancit të konsoliduar duhej të paraqitej në vlerën 20,338,947 lekë dhe është paraqitur në vlerën 20,638,947 lekë. Nga auditimi i pozicionit financiar të llogarisë 42 "*Detyrime ndaj personelit"* sipas njësive shpenzuese u konstatua se në pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar (Qendër) është paraqitur vlera prej 13,896,250 lekë, ndërkohe që sipas të dhënave të kësaj llogarie sipas thesarit (SIFQ) kjo llogari rezultoi në vlerën prej 13,596,250 lekë ose pasqyruar më shumë në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën prej 300,000 lekë (13,896,250-13,596,250). Llogaria 42 "*Detyrime ndaj personelit"* është mbivlerësuar për vlerën prej 300,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh" dhe me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 *''Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme''* pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 33-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje me pasqyrimin e llogarisë 42 *"Detyrime ndaj personelit"* e cila është mbivlerësuar për vlerën prej 300,000 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se llogaria 42 "*Detyrime ndaj personelit"* është kontabilizuar për vlerën 21,359,077 lekë. Sipas informacionit të pasqyrave financiare individuale llogari 42 "*Detyrime ndaj personelit"* për aparatin e Bashkisë Skrapar është kontabilizuar për vlerën 14,252,224 lekë, për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike është kontabilizuar për vlerën 5,556,389 lekë dhe për Ndërmarrjen e Shërbimit Pyjor në vlerën 1,550,464 lekë. Sa më sipër llogaria 42 "*Detyrime ndaj personelit"* është kontabilizuar në përputhje me vlerat e llogarive 42 sipas pasyrave individuale.

Statusi: Zbatuar plotësisht

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Skrapar në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën 36,880,205 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave për 25 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Skrapar. Një pjesë e fondeve që gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Skrapar i përkasin periudhave të mëparshme të trashëguara nga ish komunat dhe në vazhdim, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave është rakorduar me Degën e Thesarit Skrapar në lidhje me vlerën e trajtuar më sipër por nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,571,010 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare*

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe me pikën 3.2, Llogaria 466 "*Kreditor për mjete në ruajtje*" e UMFE nr.5, datë 21.02.2022.
Në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.02.2011 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 35-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave bazuar në listën analitike të llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në vlerën 36,571,010 lekë, të marrë masa për të njoftuar subjektet përkatëse dhe të ndjekë grafikun e likuidimit të garancive për objektet e marra në dorëzim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* është kontabilizuar për vlerën 9,528,267 lekë. Në këtë llogari rezultojnë 8 ngurtësime me vlerë 1,747,596 lekë për të cilat ka përfunduar afati i garancisë. Rekomandimi i mësipërm do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.

Statusi: Pa zbatuar

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se për vitin 2024 gjendja në fillim e llogarisë 468 *"Debitor të, ndryshëm"* është në vlerën 102,473,734 lekë dhe është shtuar gjatë vitit me shumën 13,443,224 lekë. Llogaria 468 *''Debitor të, ndryshëm''* për vlerën e shtuar të debitorëve të vitit 2024 prej 13,443,224 lekë nuk ka në kundër parti të sajë llogarinë 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për t'u marrë"*. Në pasiv të pasqyrave financiare të konsoliduar nuk pasqyrohet llogaria 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për t'u marrë".* Llogaria 4341*"Operacione me shtetin detyrime"* është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 115,916,958 lekë dhe duhej pasqyruar në vlerën 102,473,734 lekë që është vlera e debitorëve të viteve të mëparshme që rezultojnë para vitit 2024. Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin detyrime"* është mbivlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë (115,916,958-102,473,734) ndërsa llogaria 470 *''Llogari në pritje- të ardhura për t'u marrë''* është nënvlerësuar për vlerën 13,443,224 *lekë* që është shtesa e debitorëve për vitin 2024.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 7 germa c.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 36-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar në lidhje pasqyrimin e llogarisë 4341 *"Operacione me shtetin detyrime"* e cila është mbivlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë dhe të saktësoj llogarinë 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për t'u marrë",* e cila është nënvlerësuar për vlerën 13,443,224 lekë, që është shtesa e debitorëve për vitin 2024.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se llogaria 468 *"Debitor të, ndryshëm"* është kontabilizuar për vlerën 126,032,037 lekë. Llogaria 4341 *"Operacione me shtetin detyrime"* është kontabilizuar për vlerën 126,032,037 lekë dhe llogaria 470 *"Llogari në pritje- të ardhura për t'u marrë"* në vlerën 0 lekë. Llogaria 468 *"Debitor të, ndryshëm"* kuadron me llogarinë 4341 *"Operacione me shtetin detyrime"*.

Statusi: Zbatuar plotësisht

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre e cila vjen si pasojë e mos administrimit të saktë të llojeve të detyrimeve tatimore sipas llojit të tyre. Konstatohen pasaktësi në pasqyrimin e taksave dhe tarifave vendore nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave pasi ka paraqitur në pasqyrën e performancës financiare shumën 5,670,966 lekë të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përputhen me të dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse të të ardhurave. Vlera prej 5,670,966 lekë nuk është paraqitur si zë më vete në llogarinë "*Tatim nga të ardhurat Personale*" por është pasqyruar te llogaria 720 "*Grand korent i brendshëm*".

Nga auditimi u konstatua se arkëtimet Cash të realizuara gjatë vitit nuk përputhen me vlerën 68,608,126 lekë të paraqitur në pasqyrat financiare. Sipas akt-rakordimit me Thesarin, këto arkëtime rezultojnë në vlerën 64,695,922 lekë. Nga kjo shumë, 63,906,929 lekë përbëjnë të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe nga pjesëmarrja në taksa nacionale, ndërsa 788,993 lekë janë rimbursim shpenzimesh pas performancës për Këndin Sportiv, vlerë e cila është regjistruar në pasqyrat e konsoliduar të performancës financiare si *"Grant korrente i huaj"*, llogaria 721.

Për sa më sipër arkëtime e të hyra (Cash), gjatë vitit ushtrimor janë në vlerën 3,912,204 lekë më pak (68,608,126-64,695,922), nga të cilat 3,123,211 lekë (3,912,204-788,993) më pak fonde të përdorura në funksion të shpenzimeve korente dhe investimeve. Sipas pasqyrës së *"Cash floë"* total fonde në dispozicion janë 727,457,639 lekë dhe sipas përllogaritjeve janë në vlerën 724,334,428 lekë (727,457,639-3,123,211).

Nga auditimi i pasqyrimit të të ardhurave në pasqyrën e performancës financiare u konstatua që janë pasqyruar të ardhura në vlerën 558,707,951 lekë dhe duhej të pasqyroheshin 552,377,088 lekë ose janë pasqyruar 6,330,863 lekë më shumë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar neni 4 pika 7; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* neni 9 pika 1 dhe pika 1.3. dhe me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 *''Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes* së përgjithshme i ndryshuar pika 2.3. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 38-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin saktë të akordimeve buxhetore korente dhe kapitale në pasqyrën *"Cash flow"* për vlerën 3,123,211 lekë si dhe të marrë masa që në pasqyrën performancës financiare të pasqyroje saktë të ardhurat dhe vlerën e drejtë të tyre për vlerën e mbi vlerësuar prej 6,330,863 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se llogaria 70 *"Të ardhura nga taksat dhe tatimet"* është kontabilizuar për vlerën 14,951,647 lekë, llogaria 71 "Të ardhura jotatimore" është kontabilizuar për vlerën 33,210,340 lekë. Referuar akt rakordimit me thesarin të ardhurat për vitin 2025 janë në vlerën 60,605,418 lekë. Pasqyra e performancës financiare është paraqitur e nenvlerësuar në klasat e llogarive të të ardhurave në vlerën 12,443,431 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare në pasqyrat financiare të konsoliduar u konstatua që llogaria 73 "*Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve*" në datën 31.12.2024 është pasqyruar në vlerën minus 2,134,106 lekë, vlerë e cila

është pasqyruar gabim në pasqyrat financiare të konsoliduar, pasi vlera e kësaj llogarie duhet të ishte paraqitur zero lekë rrjedhimisht është nënvlerësuar për vlerën 2,134,106 lekë. Vlera prej minus 2,134,106 lekë është paraqitur edhe në llogarinë 63 *"Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit"*, për rrjedhojë është dhënë efekt i përsëritur në llogaritjen e rezultatit të veprimtarisë ekonomike. Ky veprim ka sjellë uljen e rezultatit të veprimtarisë së vitit ushtrimor në vlerën 2,134,106 lekë. Për rrjedhojë rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor duhet të pasqyrohej në pasqyrën e performancës financiare (Formati nr.2) llogaria 85 "*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*" në vlerën **62,110,366 lekë** (558,707,951+2,134,106-498,731,691).

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Kreu II. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 42-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin në pasqyrën e performancës financiare të llogarisë 73"*Ndryshimi të Gjendjes së Inventarit të Produkteve*" për pasqyrimin e saktë dhe të drejtë të sajë për vlerën e nënvlerësuar prej 2,134,106 lekë, në mënyrë që të saktësohet edhe vlera e llogarisë 85 "*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*".

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se ndryshimi i gjendjes së inventarit është në vlerën (9,425,532) lekë. Në pasqyrën e performancës financiare në llogarinë 63 kjo vlerë është paraqitur në shumën (9,425,532) lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua se për mbajtjen e kontabilitetit nuk veprohet në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara por në bazë të likuidimit të shpenzimeve rrjedhimisht shpenzimet nuk janë paraqitur në mënyre të saktë dhe të drejtë për vitin 2024.

- Llogaria 600 "*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*" është pasqyruar në vlerën 248,713,868 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 251,275,721 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 2,561,853 lekë.
- Llogaria 435-436 "*Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore*" është pasqyruar 41,672,619 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 42,732,827 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 1,060,208 lekë.
- Llogaria 602 "*Blerje mallra dhe shërbime*" është pasqyruar 78,785,490 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 81,477,989 lekë ose është pasqyruar më pak në vlerën 2,692,499 lekë. Nga tërësia e të dhënave të mësipërme janë pasqyruar më pak në pasqyrat e performancës financiare shpenzime për shumën 6,314,560 leke (2,561,853+1,060,208+2,692,499).

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 3, Kapitullin II, ndryshimet në Rubrikën 2.3, paragrafi 8 dhe 9.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 45-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se ndryshimi i gjendjes së inventarit është në vlerën (9,425,532) lekë. Në pasqyrën e performancës financiare në llogarinë 63 kjo vlerë është paraqitur në shumën (9,425,532) lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masa që të saktësojë të dhënat në lidhje me pasqyrimin në pasqyrën e performancës financiare të shpenzimeve për vlerën e nënvlerësuar prej 6,314,560 lekë, si dhe të marrë masa për njohjen e shpenzimeve në pasqyrën e performances financiare sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar të Bashkisë Skrapar u konstatua se ky rekomandim rekomandim është i zbatuar.

Statusi: Zbatuar

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare të pasqyrave të konsoliduar u konstatua që llogaria 606 *"Transferime për Buxhetet familjare e Individë"* është pasqyruar në pasqyrat e konsoliduar në vlerën 393,908 lekë, ndërkohë që sipas thesarit është në vlerën 128,650,258 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare në vlerën 128,256,350 lekë. Nga auditimi konstatohet që është pasqyruar në pasqyrat e performancës financiare llogaria 604 "*Transferime korente të brendshme*" është pasqyruar më shumë për vlerën 128,650,258 lekë dhe llogaria 606 "*Transferime për Buxhetet familjare e Individë*" më pak për vlerën 128,650,258 lekë. Llogaria 604 "*Transferime korente te brendshme*" duhej të pasqyrohej në vlerën 2,882,652 lekë ndërsa llogaria 606 "*Transferime për Buxhetet familjar e Individë*" duhej të pasqyrohej në vlerën 128,650,258 lekë. Ndryshimet janë si pasoje i keq klasifikimit te llogarive me njëra tjetrën.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar pika 3.1, nënpika 28, 29.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 48-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masat për të siguruar kontabilizimin e saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare, me qëllim dhënien informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare për vitin 2025 rezulton se llogaria 604 "*Transferime korente te brendshme*" është kontabilizuar për vlerën 7,253,344 lekë dhe llogaria 606 "*Transferime për Buxhetet familjar e Individë*" është kontabilizuar për vlerën 117,482,739 lekë.

Statusi: Zbatuar plotësisht

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera me arkë për periudhën e përzgjedhur rezultoi se, furnizimin me dokumente të përdorura për arkëtime dhe pagesa (mandat arkëtime dhe mandat pagesa), sipas hyrjes me nr. 46, datë 20.12.2024, Bashkia Skrapar e ka bërë nga persona të rastësishëm dhe jo nga shtypshkronja e letrave me vlerë. Mandat arkëtimet e përdorura nuk kanë numër serie të para shtypur. Përdorimi i këtyre dokumenteve që nuk përmbushin standartet ligjore për përdorim në sektorin publik ka risk të lartë që ka të bëjë me ruajtjen e gjurmës së auditimit.
Dokumentet e përdorura për arkëtimet (mandat arkëtime) janë pa numër serial dhe në disa raste të firmosura nga arkëtari dhe personi që ka bërë arkëtimin.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, pika 68.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 6/ç, 12/dh dhe Vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, "*Për shtypjen e letrave me vlerë*", i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 50-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrin masa që furnizimi i dokumentacionit të përdorur për veprimet me arkë të bëhet nga subjekte të autorizuar siç është shtypshkronja e letrave me vlerë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga verifikimi i mandat pagesave dhe mandat arkëtimeve të hyra gjatë vitit 2025 u konstatua se këto mandat arkëtime janë të pajisura më numër serial dhe janë marrë në dorëzim nga magazinieri i Bashkisë Skrapar.

Statusi: Zbatuar plotësisht

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve në llogarinë 468 **"***Debitorë të ndryshëm***"** u konstatua që në ketë llogari nuk janë pasqyruar debitorët nga kontrata e qirasë të fondit pyjor kullosorë. Subjektet që nuk kanë likuiduar detyrimet për vitin 2024 janë në vlerën 2,837,420 lekë dhe konkretisht subjekti *"O"* në vlerën 35,000 lekë subjekti *"H V"* në vlerën prej 138,245 lekë dhe subjekti *"M E"* në vlerën prej 2,664,175 lekë. Debitorët në vlerën 2,837,420 lekë (35,000 +138,245 +2,664,175) nuk janë përfshirë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në rakordimin e bërë me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave për debitorët. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespodencë ndërmjet drejtorive përkatëse dhe marrëdhënia shkresore midis strukturave të bashkisë që ka të bëjë me rakordimet në lidhje me debitorët është bërë me shkresa të pa protokolluara në zyrën e protokoll arshivës.
Kontabilizimi jo i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Si pasojë e mos kontabilizimit të debitorëve dhe mos paraqitjes së saktë të tyre në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" në fund të vitit 2024, vlera 2,837,420 lekë përben të ardhura të munguara.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, "*Për arkivat*", nenet 11-20 te "*Norma tekniko-profesionale*" dhe neni 22, si dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 20-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të marrë masat për kontabilizimin në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" të debitorëve të pa regjistruar që rrjedhin nga kontratat e qirasë së fondit pyjor-kullosor, në vlerën totale 2,837,420 lekë, përkatësisht: subjekti *"O"*, ne vlerën 35,000 lekë, subjekti *"H V"* në vlerën prej 138,245 lekë dhe subjekti *"M E"* në vlerën prej 2,664,175 lekë.

Menjëherë

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore debitorët për kontratat e qirasë nuk janë kontabilizuar në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*".

Statusi: Pa zbatuar

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve të Bashkisë Skrapar në nën llogarinë 627400, u konstatua që përgjatë vitit 2024 bashkia ka kryer likuidime në vlerën 2,695,558 lekë për shpenzime gjyqësore dhe shpenzime përmbarimore në 8 (tetë) urdhër shpenzime te cilat janë shpenzime pa ekonomicitet 3E te buxhetit te bashkisë në vlerën 2,695,558 lekë.
Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhet.
Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në nënpikën III.2, faqe 47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa ekonomicitet të Buxhetit të Bashkisë në vlerën 2,695,558 lekë**,** shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore mbi pagesat e kryera për vendimet gjyqësore për gjyqet e fituara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nga auditimi i ditarit të bankës së Bashkisë Skrapar për vitin 2025 u konstatua 1 (një) urdhër shpenzim me vlerë 216,052 lekë për vendim gjyqësor invaliditeti. Këto vendime gjyqësore paguhen nga Bashkia Skrapar por janë fonde të deleguara nga Ministria e Shëndetësisë.

Statusi: Proces zbatimi

D. MASA DISIPLINORE
D.1. Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*", kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Skrapar** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

"*Vërejtje*" për 2 (dy) punonjësit, si më poshtë:

1. Z. E. O, me detyrë *Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike*
2. Znj. I. O, me detyrë *Përgjegjëse e Sektorit të Financës*
për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar Udhëzimin e

MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, i dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar, i ndryshuar, pika 114.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Nuk është dhënë masë disiplinore për këta punonjës.

Statusi: Pa zbatuar

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TËSHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Skrapar, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. M, me detyrë Kryetar i Bashkisë Skrapar
2. Z. N. G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit
3. Znj. H. B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), rezultoi se Bashkia Skrapar paraqet mangësi në ngritjen, dokumentimin dhe funksionimin e disa prej komponentëve të sistemit të MFK-së. Konkretisht, u konstatuan këto mangësi:

- Për punonjësit e rekrutuar gjatë vitit 2025, nuk dokumentohet zhvillimi i trajnimeve dhe procesi i njohjes me rregulloren e brendshme të institucionit, kërkesat për integritetin dhe parimet e etikës në punë.
- Për vitin 2025, nuk administrohet plani i veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, duke mos mundësuar evidentimin dhe ndjekjen e masave të planifikuara për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

- Nuk administrohen raporte periodike të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm, të cilat do të shërbenin për evidentimin e progresit, problematikave dhe masave korrigjuese.
- Rregullorja e brendshme e institucionit nuk është përditësuar në përputhje me ndryshimet organizative të strukturës së Bashkisë, konkretisht me kalimin e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në nivel drejtorie.
- Bashkia Skrapar nuk ka hartuar dhe dokumentuar hartat e proceseve të punës, të cilat janë një element i rëndësishëm për përcaktimin e qartë të proceseve, përgjegjësive, kontrolleve dhe ndërveprimit ndërmjet strukturave organizative.
- Në drejtim të rritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të punonjësve në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nuk është hartuar dhe miratuar një program institucional trajnimi, i cili të përfshijë nevojat specifike për trajnimin dhe informimin e punonjësve mbi zhvillimet, kërkesat dhe zbatimin e parimeve të MFK-së.
- Bashkia Skrapar nuk ka miratuar planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik, duke mos siguruar një kuadër të dokumentuar për organizimin, zhvillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së këtij grupi.
- Nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i planeve vjetore operacionale, të lidhura me realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe objektivat vjetore të institucionit. Këto plane duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë veprimet konkrete, afatet e realizimit dhe personat/strukturat përgjegjëse për çdo veprim të parashikuar.
- Nuk dokumentohet hartimi dhe miratimi i një Strategjie të Menaxhimit të Riskut, e cila të përcaktojë qasjen e institucionit ndaj identifikimit, analizimit, vlerësimit, trajtimit dhe monitorimit të risqeve.
- Nuk është nxjerrë urdhër i titullarit të institucionit për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve nga të gjitha strukturat e Bashkisë Skrapar**,** si dhe për hartimin dhe administrimin e Regjistrit të Riskut. Gjithashtu**,** nuk dokumentohet përditësimi i Regjistrit të Riskut në mënyrë periodike, të paktën dy herë në vit, si dhe evidentimi i masave të përcaktuara për trajtimin dhe reduktimin e ndikimit të risqeve të identifikuara.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike"*; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar, në bashkëpunim me Koordinatorin e Riskut, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve, të marrë masa për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut dhe Regjistrit të Riskut, duke përcaktuar risqet sipas strukturave dhe proceseve, analizën dhe vlerësimin e tyre, masat ekzistuese dhe të nevojshme të kontrollit, strukturat/personat përgjegjës dhe afatet për trajtimin e tyre. Të sigurohet monitorimi, raportimi dhe përditësimi i Regjistrit të Riskut minimalisht dy herë në vit, me qëllim identifikimin dhe trajtimin në kohë të risqeve që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar, në bashkëpunim me Koordinatorin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe strukturat përgjegjëse, të marrë masa për forcimin dhe dokumentimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nëpërmjet:

- përditësimit të Rregullores së Brendshme në përputhje me strukturën organizative në fuqi dhe përcaktimit të qartë të detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të strukturave dhe pozicioneve të punës;
- hartimit dhe miratimit të Hartave të Proceseve të Punës;
- hartimit dhe miratimit të Planit të Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, me masa konkrete, përgjegjësi dhe afate të përcaktuara, si dhe monitorimit periodik dhe dokumentimit të rezultateve të zbatimit të tij;
- hartimit dhe zbatimit të një programi periodik trajnimi për stafin, me fokus në MFK, menaxhimin e riskut, integritetin dhe etikën, si dhe dokumentimit të trajnimit dhe njohjes së punonjësve të rinj me rregullat dhe aktet e brendshme të institucionit;

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së auditit të brendshëm përgjatë vitit 2025, u konstatua se:
- Referuar strukturës organizative të Bashkisë Skrapar, të miratuar me VKB nr. 66, datë 20.12.2024 u konstatua se shërbimi i auditimit të brendshëm është parashikuar në përbërje të Kabinetit të Kryetarit me 1 (një) pozicion "Përgjegjës i Zyrës së Auditimit të Brendshëm". Struktura e parashikuar nuk përmbush kriterin minimal për organizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, pasi referuar pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik",* njësia e auditimit të brendshëm duhet të përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë.
- Përgjegjësi i NJAB Skrapar nuk është i certifikuar si "Auditues i brendshëm në sektorin publik";
Nga veprimtaria e ushtruar gjatë vitit 2025 nga Përgjegjësi i Zyrës së Auditimit të Brendshëm u konstatuan se:
- Për periudhën 2025, nuk janë mbuluar me auditim aktivitete/sisteme që kryen Bashkia Skrapar, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë;
- Nuk pasqyrohet metodologjia e vlerësimit të riskut për sistemet. Konkretisht në një dokument "Excel" pasqyrohet vlerësimi i tyre sipas shkallëve të riskut "I lartë", "I mesëm" dhe "I ulët", por nuk pasqyrohet metoda e ndjekur për klasifikimin sipas shkallëve të riskut;
- Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore;
- Nuk janë çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit;
- Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2025 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar;
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar;
- Nuk sigurohet zbatimi i parimit të përcaktuar në shkronjën "c" të nenit 7 në Ligjin nr. 114/2015, *"Për Auditin e Brendshëm Publik",* i ndryshuar, pasi në veprimtarinë audituese i njëjti person planifikon, organizon, auditon, kontrollon cilësinë e auditimit dhe njëkohësisht raporton. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën b neni 12 "ç" nenin 13, shkronja "ç" në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";* Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë *"Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016";* Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 *"Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin*

publik"; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masa për ngritjen dhe organizimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, duke siguruar plotësimin e strukturës me jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë, si dhe plotësimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale për ushtrimin efektiv të funksionit të auditimit të brendshëm.

Pas ngritjes së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, të sigurohet që planifikimi strategjik dhe vjetor i auditimeve të mbështetet në një vlerësim të dokumentuar të riskut, si dhe të vendoset një sistem i standardizuar për administrimin, dokumentimin, ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve të auditimit, në format fizik dhe elektronik.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezultoi se:

- Raporti për vlerësimin dhe parashikimin e të ardhurave afatmesme është miratuar me VKB nr.9, datë 27.02.2024. Vlerësimi i të ardhurave është paraqitur në Këshillin Bashkiak në kundërshtim me afatet e përcaktuar.
- Tavanet Buxhetore për PBA 2025-2027 janë paraqitur dhe miratuar me VKB nr.18, datë 27.03.2024 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 239/1 prot., datë 02.04.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara.
- Udhëzimi i Kryetarit për përgatitjen e buxhetit afatmesëm nuk është hartuar.
- Bashkia Skrapar nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave projekt dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Projekt dokumenti i fazës së parë të PBA 2025-2027 nuk është paraqitur në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga kryetari i njësisë.
- Tavanet përfundimtare të PBA 2025-2027 janë miratuar me VKB nr.39 datë 25.07.2024 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.536/1 prot., datë 30.07.2024 në kundërshtim me afatet e përcaktuara.

Kalendari i konsultimeve publike nuk është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Veprime dhe mosveprimet janë në mospërputhje me Udhëzimin nr.23, datë 30.12.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*" pikat 58,63, 64, 79. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masat e nevojshme që të ndjekin të gjitha fazat e planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor duke e miratuar brenda afateve ligjore.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të buxhetit të Bashkisë Skrapar për vitin 2025, u konstatua se plani përfundimtar i shpenzimeve me burim financimi të ardhurat e veta, transfertën e pakushtëzuar dhe specifike ishte në vlerën 537,413 mijë lekë, ndërsa realizimi rezultoi në vlerën 465,607 mijë lekë ose në masën 83%.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore u planifikuan në vlerën 76,862 mijë lekë dhe u realizuan në vlerën 60,818 mijë lekë ose në masën 79%. Sipas zërave të të ardhurave u konstatuan nivele të

ulëta realizimi, si dhe tejkalime të planit, duke evidentuar mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe kapaciteteve reale të arkëtimit.
Mosrealizimi i buxhetit u evidentua veçanërisht në zërin e investimeve, ku llogaritë 230-231 u planifikuan në vlerën 70,136 mijë lekë dhe u realizuan në vlerën 46,417 mijë lekë ose në masën 66%, me mosrealizim në vlerën 23,719 mijë lekë.
Në nivelin e ulët të realizimit të investimeve ndikuan dy faktorë kryesorë: mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara, si dhe mosfinalizimi brenda vitit buxhetor i disa procedurave të investimeve për shkak të afateve të nevojshme për realizimin e tyre. Kjo e fundit evidentohet edhe nga fakti se në fund të vitit rezultuan të papërdorura fonde nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike në vlerën 21,909 mijë lekë.
Sa më sipër evidentohen mangësi në planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetorë, të cilat kanë ndikuan në nivelin e realizimit të investimeve të planifikuara për vitin 2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 39*; Ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.3, shkronjat "c" dhe "ç";* Ligjin nr. 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 2 dhe 3, pika 3;* UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, pikat 79, 80 dhe 81, si dhe VKB-të përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Skrapar, të marrë masa për planifikimin e të ardhurave të veta bazuar në kapacitetet reale të arkëtimit dhe, mbi këtë bazë, të planifikojë shpenzimet dhe investimet publike, duke siguruar përputhjen ndërmjet burimeve të financimit dhe mundësive reale të realizimit të tyre. Në rast të mosrealizimit të të ardhurave të planifikuara gjatë vitit buxhetor, të rishikohet në kohë plani i shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura, u konstatua se totali progresiv në datën 31.12.2024 është në vlerën 11,726 mijë lekë, nga të cilat për investime janë në vlerën 596 mijë lekë, për mallra dhe shërbime në vlerën 6,589 mijë lekë, për shpronësime dhe për vendime gjyqësore janë në vlerën 4,540 mijë lekë. Gjatë vitit 2025 janë likuiduar detyrime të prapambetura në vlerën 23,860 mijë lekë dhe janë krijuar detyrime të reja në vlerën 50,435 mijë lekë. Detyrime të prapambetura në datën 31.12.2025 janë në vlerën 38,300 mijë lekë, nga të cilat për investime janë vlerën 28,395 mijë lekë, për mallra dhe shërbime në vlerën 5.864 mijë lekë për shpronësime dhe vendime gjyqësore janë në vlerën 4,040 mijë lekë. Detyrime të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta janë në vlerën 14,352 mijë lekë dhe me burim financimi nga buxheti i shtetit 28,947 mijë lekë. Detyrimet e mësipërme i përkasin faturave të cilat kanë datë lëshimi mbi 60 ditë.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 65*, Udhëzimi të MFE nr.9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve*, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91.* (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1, faqe 25-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa që, me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, të parashikojnë shlyerjen e detyrimeve të papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve

ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, duke sjellë zvogëlim të fondeve për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e të dhënave kontabël të llogarisë 202 "Studime dhe kërkime", rezultoi se janë të regjistruara 25 studime dhe projektime, me vlerë historike totale prej 110,213 mijë lekë.

Nga verifikimi i përbërjes së kësaj llogarie dhe i dokumentacionit përkatës, rezultoi se 6 projekte/studime, me vlerë historike 78,985 mijë lekë, lidhen me investime në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Këto vlera, duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë me investime/aktive të destinuara për administrim dhe përdorim nga shoqëria rajonale e ujësjellës-kanalizimeve, duhet të trajtohen në përputhje me natyrën dhe destinacionin ekonomik të tyre dhe të sistemohen në kontabilitet në funksion të kapitalizmit të aktiveve përkatëse.

Vlerat e mësipërme duhet të verifikohen, dokumentohen dhe, pas përmbushjes së kushteve ligjore e kontabël, të transferohen si pjesë e kontributit në kapital/aktiveve të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar SHA, sipas procedurave dhe akteve përkatëse të miratuara për transferimin dhe administrimin e aktiveve publike.

Mungesa e këtij sistemimi dhe transferimi ka sjellë mbajtjen në bilancin e Bashkisë të vlerave që lidhen me aktive/investime të destinuara për administrim nga një subjekt tjetër, duke kërkuar rregullimin e pasqyrimit kontabël dhe juridik të tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura"* kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Kreu, Aneksi 1 pika 2, klasa 2, pika 5 dhe pika 2.1. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.3, faqe 41-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të saktësojë llogarinë 202 "*Studime dhe kërkime"* në pasqyrën e pozicionit financiar për 6 projekte të cilat lidhen me ujësjellësa me vlerë historike 78,985 mijë lekë, që duhet t'i bashkëngjiten kapitalizmit të aktiveve dhe të transferohen në *"Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Skrapar Sha"*.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 210 "*Toka, troje terrene"* u konstatua se nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit;

a) Trojet nën objekt, të objekteve si godina e Bashkisë dhe trualli përreth saj, ndërtesat e shkollave që ka në administrim, dhe të zyrave në Njësive Administrative, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "*Ndërtime e konstruksione*".

b) trualli i godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë,

c) trojet të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 "*Toka, troje terrene*" rezultoi se kjo llogari nuk paraqet një pamje të drejtë për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë 210 "*Toka, troje terrene*", si dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në

Pasqyrat Financiare rezultojnë të paplota, për shkak të mungesës së analizave shoqëruese dhe detajuese.
Mungesa e analizimit të kësaj llogarie ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.
Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.3, faqe 41-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të ngrenë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Skrapar të kaluar me VKM për llogarinë 210 "*Toka, troje terrene*". Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të merren masa që vlerat e saj të jenë analizuar me objekte.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur u konstatua se llogaria. 211 "*Pyje, kullota, plantacione*", është kontabilizuar në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 6,911 mijë lekë.
Bashkia Skrapar nuk ka bërë vlerësimin e pyjeve dhe kullotave të transferuara, për rrjedhojë dhe në kontabilitet nuk ka të pasqyruar vlerën e pyjeve dhe kullotave të Bashkisë Skrapar, të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, e ndryshuar, pika 6, shtojca me nr.4, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Skrapar, me numër rendor nga 1 (një) deri 892 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy).
Për këto sipërfaqe nuk është bërë verifikimi fizik dhe vlerësimi i tyre, me qëllim përcaktimin e saktë të vlerës kontabël të llogarisë 211 *"Pyje, kullota, plantacione",* duke ndikuar në saktësinë e vlerë së paraqitur në pasqyrat financiare të vitit 2025.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015*"Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 *"Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë";* Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* i ndryshuar Kap III, pika 30,. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin dhe vlerësimin e pronave të Bashkisë Skrapar për llogarinë 211 "*Pyje Plantacione*" në lidhje me gjendjen fizike për hartimin e regjistrit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*" rezultoi se gjatë periudhës së auditimit janë kryer shtesa me pagesë në vlerën totale prej 18,153 mijë lekë, të lidhura me 5 investime në aktive afatgjata materiale (AAM). Nga shqyrtimi i dokumentacionit justifikues për kontabilizimin e këtyre investimeve u konstatua se, nga 5 investimet e regjistruara

në llogarinë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*", 1 (një) investim, me vlerë 13,564 mijë lekë, nuk ishte marrë në dorëzim, por ishte regjistruar në këtë llogari.
Konkretisht, investimi "*Ndërtim Muri Mbrojtës përgjatë lumit Osum te ish kantieri NSHN – Faza II*", me vlerë kontrate, përfshirë TVSH-në, prej 59,820 mijë lekë. Për këtë investim, megjithëse objekti nuk ishte marrë në dorëzim, në kontabilitet ishte regjistruar pagesë pjesore në vlerën 13,564 mijë lekë në llogarinë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*".
Gjithashtu, nga auditimi i llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", rezultoi se gjatë periudhës së auditimit janë kryer shtesa me pagesë në vlerën totale prej 49,732 mijë lekë, të lidhura me 4 investime në aktive afatgjata materiale (AAM). Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës u konstatua se këto investime, me vlerë totale prej 48,035 mijë lekë, nuk ishin marrë në dorëzim, por ishin regjistruar në llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*".
Në përfundim, rezultoi se investimet në aktive afatgjata materiale, të cilat nuk ishin marrë në dorëzim, janë regjistruar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale vetëm mbi bazën e pagesave të kryera. Ky trajtim kontabël nuk pasqyron në mënyrë të saktë gjendjen dhe statusin e aktiveve dhe kërkon verifikimin dhe sistemimin e regjistrimeve kontabël në përputhje me dokumentacionin e marrjes në dorëzim dhe fazën e realizimit të investimeve.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022 *" Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për kryerjen e një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor për aktivet e kontabilizuar në llogaritë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione"* dhe 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*, si dhe të sigurojë që aktivet të regjistrohen në kontabilitet në momentin e marrjes në dorëzim, dhe jo në momentin e pagesës së plotë të vlerës së tyre.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Skrapar për vitin ushtrimor 2025, në llogaritë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" dhe 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", u konstatuan pasaktësi në evidentimin dhe klasifikimin e aktiveve afatgjata materiale, konkretisht:
Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" u konstatua se Bashkia Skrapar ka të evidentuara në inventar 62 objekte ujësjellësi, me kosto historike në vlerën 895,367 mijë lekë. Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin e këtyre aseteve te "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat" SHA, në kundërshtim me VKM nr. 302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", Kreu II, pika 14;* Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85;* si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, Kreu II, pikat 5 dhe 36 dhe Kreu III, pika 30.*
Gjithashtu, nga auditimi i kontabilizimeve në llogaritë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" u konstatuan 5 investime për aktive afatgjata materiale, në vlerën 63,296 mijë lekë, të cilat nuk janë kolauduar dhe nuk janë marrë në dorëzim. Për sa kohë këto

investime janë ende në proces, ato duhej të ishin evidentuar në llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", dhe jo në llogaritë përkatëse të aktiveve të përfunduara.
Për rrjedhojë, llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", e cila në pasqyrat financiare të vitit 2025 paraqitet me tepricë neto 0 lekë, është nënvlerësuar në vlerën 63,296 mijë lekë, ndërsa llogaritë 212 dhe 213 janë mbivlerësuar për vlerat përkatëse të investimeve të regjistruara para kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të tyre, në kundërshtim me Udhëzimin nr. *8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.*
Sa më sipër, pasqyrat financiare të Bashkisë Skrapar për vitin 2025 nuk paraqesin saktë gjendjen dhe klasifikimin e këtyre aktiveve afatgjata materiale, pasi në llogarinë 213 vijojnë të evidentohen asetet e ujësjellësit që duhet të transferohen te "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat" SHA, ndërsa investimet ende në proces janë evidentuar në llogaritë e aktiveve të përfunduara dhe jo në llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të saktësojë llogarinë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* në pasqyrën e pozicionit financiar për 62 Aktivet Afatgjata Materiale të cilat lidhen me ujësjellës me vlerë historike 895,367 mijë lekë duhet t'i transferohen *"Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha".*

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2026

10.1. Rekomandim: Drejtorinë e Financës dhe e Buxhetit, të marri masat që pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 *"Investime në proces".*

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i llogarive të pasqyrave financiare, rezultoi se llogaria 26 *"Aktive afatgjata financiare",* është paraqitur në vlerën 0 (zero) lekë.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Skrapar është aksionare në shoqërinë e re të krijuar "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha" shoqëri e krijuar në bazë të akt marrëveshjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përfaqësuar nga AKUM me nr.7183.prot., datë 28.09.2022 dhe Bashkitë Berat, Kuçove, Dimal, Poliçan dhe Skrapar. Bazuar në këtë akt marrëveshje kapitali fillestar i shoqërisë është 10,000 mijë lekë ku Bashkia Skrapar zotëron 4,7% të aksioneve ose në vlerë kapitali 470 mijë lekë (10,000 mijë*4,7%). Nga auditimi konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Skrapar nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në shoqërinë e re të krijuar "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sha" për vlerën prej 470 mijë lekë. Llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vetë"*, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2025. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" kreu II pika 14,* me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Skrapar të marrë masa që të saktësojë të dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar, me qëllim pasqyrimin e drejtë të vlerës prej

470 mijë lekë në llogarinë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*", që i përket pjesëmarrjes në shoqërinë "*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat*" sh.a.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2026

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Skrapar llogaria 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerë 9,528 mijë lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Në këtë llogari janë kontabilizuar ngurtësime me vlerë 1,747 mijë lekë për të cilat ka kaluar afati i garancisë.
Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 1,747 mijë lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për verifikimin e garancive të kontabilizuara në llogarinë 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"* dhe të zhbllokoj garancitë për të cilat nuk ka pretendime për cilësinë e investimit.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Skrapar llogaria 467 *"Kreditor të ndryshëm"* paraqitet në vlerën 0 lekë.
Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Skrapar u konstatua sipas Raportit të Vetëvlerësimit Financiar për vitin 2025 të dërguar në datën 04.03.2026 në Ministrinë e Financës janë paraqitur detyrime të prapambetura ndaj të tretëve vlera prej 17,090,196 lekë me burim financimi të ardhurat e veta.
Në aneksin nr.2/2/6 në anekset e raportit përfundimtar të auditimit janë pasqyruar detyrime për 29 fatura tatimore nga të cilat me financim nga buxheti i shtetit janë në vlerën 22,999,525 lekë dhe 15,300,108 lekë nga të ardhurat e veta.
Sa më sipër detyrimet e prapambetura të raportuara në Ministrinë e Financës janë mbivlerësuar për vlerën 1,790,088 lekë dhe llogaria 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* është nënvlerësuar për vlerën 38,299,633 lekë. Detyrimet e prapambetura të raportuara në Ministrinë e Financës nuk janë kontabilizuar në asnjë prej llogarive kontabël të pasqyrës së pozicionit financiar.
Këto janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Pika 15 Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", paragrafi 42. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 41-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masat për evidentimin dhe rakordimin periodik të detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe kontabilizimin e detyrimeve në llogarinë kontabël 467 *"Kreditorë të ndryshëm".*

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit, administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Skrapar kryhet në programin excel.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Bashkisë Skrapar për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Bashkisë Skrapar.
Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për Sistemin e Taksave Vendore"* i ndryshuar, neni 4, pika 7 dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar".(Më hollësisht gjetjet trajtuar në nënpikën 2.2.5, faqe 33-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
14.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim Taksave, të marrë masa për implementimin e një sistemi informatik të dedikuar për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, me qëllim automatizimin dhe saktësimin e llogaritjes së detyrimeve, kamatëvonesave dhe pagesave, si dhe sigurimin e gjurmueshmërisë dhe ruajtjes së të dhënave dhe deri në implementimin e sistemit, të sigurohet kryerja periodike e kopjeve rezervë dhe kontrolli i aksesit në të dhënat e administruara në Excel, për të minimizuar riskun e humbjes apo ndryshimit të tyre.
Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se:
- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **17 (shtatëmbëdhjetë)** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 3 (tre) janë zbatuar plotësisht, në proces zbatimi 4 (katër) masa, si dhe pa zbatuar 10 (dhjetë) masa. Nga masat e pa zbatuara 2 (dy) prej tyre do të rikërkohen përsëri në auditimin aktual.
- Për shpërblimin e dëmit janë lënë **2 (dy) masa** në vlerën 1,112,294 lekë dhe janë pranuar plotësisht, të cilat nuk janë zbatuar.
- Për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia janë lënë **2 (dy) masa.** Nga të cilat 1 (një) masë është në proces zbatimi dhe 1 (një) masë pjesërisht e zbatuar.
- Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore me efekt mungesë të ardhurash **1 (një) masë** e cila është në proces zbatimi.
- Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitetin e fondeve publike janë lënë **2 (dy) masa**. Nga të cilat 1 (një) masë është zbatuar plotësisht dhe 1 (një) masë pa zbatuar e cila do të rikërkohet përsëri në auditimin aktual.
-Për masa disiplinore janë lënë **22 (njëzet e dy) masa** të cilat janë pranuar plotësisht dhe nuk janë zbatuar.
Nisur nga sa më sipër, *veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe (56-98) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
15.1. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE
1.1.Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore marrë të gjithë masat e nevojshme për trajnimin e nëpunësve që përfshihen në procedurat e prokurimit, me qëllim shmangien e mangësive lidhur me dokumentimin dhe argumentimin e kritereve dhe

specifikimeve teknike, dokumentimin e kërkesave të sektorëve dhe drejtorive për mallra/punë/shërbime për përllogaritjen e fondit limit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.Rekomandimi:. Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune ku të analizojë arsyet e parregullsive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Skrapar, të merren të gjitha masat për të kërkuar mendimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe për t'i kërkuar aplikantit, zhvilluesit dhe projektuesit, hartimin e aktit të përputhshmërisë, i cili duhet të miratohet nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për të gjitha objektet që zhvillohen në zonat e mbrojtura me përparësi zhvillimin e turizmit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Skrapar, në lidhje me miratimin e lejeve të zhvillimit, të marrë të gjitha masat për të respektuar kushtet urbane të parashikuar në dispozitat ligjore dhe rregullatorë, si dhe në çdo rast të respektohet parcela minimale e lejuar për ndërtim, intensiteti maksimal i lejuar, lartësia maksimale e lejuar, e matur me metra dhe numër katesh, si dhe distanca urbane nga kufiri i pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Skrapar, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje leje zhvillimi dhe certifikatë përdorimi:

-Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje zhvillimi dhe certifikatë përdorimi, siç janë: licenca e topografit dhe projektuesit, aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit, policat e sigurimit, kontratat midis zhvilluesit dhe shoqërisë ndërtuese, etj.;

-Të shqyrtojë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;

-Të respektojnë përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e dokumentit të lejes së zhvillimit, ku të përmbajë të dhëna si: përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme; intensitetin e ndërtimit; koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim; lartësinë maksimale në metra.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit të marrë masa që të pajisin me ***Oponencë Teknike*** për çdo projekt zbatimi, me qëllim kontrollin e projektit në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe të zhvillimit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, dhe në përputhje me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1.Rekomandimi: Drejtori i financës, specialisti i aseteve dhe Drejtori i NSHP të marrin masat e duhura për parashikimin e fondeve të nevojshme për hartimin e plan rilevimeve dhe nisjen e procedurave për regjistrimin e pasurive në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa për ngritjen e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit me punonjës të arsimuar sipas fushës së përcaktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **663,820 lekë pa TVSh** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "B" sh.p.k, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumin e situacionuara.

Menjëherë

2.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **448,474.5 lekë pa TVSh** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "F" SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në volumin e situacionuara.

Menjëherë

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

2.1.Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave, Bashkia Skrapar dhe Drejtori i NSHP të marrin masa për arkëtimin e detyrimeve nga dhënia e pasurive me qira, përkatësisht në vlerën 132,250 lekë, të krijuara nga mos likuidimi i qirasë për kontratat të cilat janë dhënë nga Aparati Bashkia Skrapar dhe vlera 2,837,420 lekë për kontratat e dhëna me qira nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor për vlerën në total 2,969,670 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE

H1. Për punonjësit në marrëdhënie pune Mbështetur në Nenin 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSh-së*", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Skrapar, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

a.*"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", gërma "c" e nenit 58, për 2 punonjës., si më poshtë*:

1. Z. N. G, me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar, Buxhetit dhe Tatim Taksave, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues të Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në procedurën me objekt: "*Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës Zylyftar Veleshnja*", në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik, dhe OE fitues është kualifikuar me të njëjtat mangësi me OE e skualifikuar. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

2. Znj. R. Ll, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave në në procedurën me objekt: "*Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës Zylyftar Veleshnja*", në të cilat vlerësimi i ofertave dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë nuk është bërë në përputhje me kuadrin rregullator të prokurimit publik, dhe OE fitues është kualifikuar me të njëjtat mangësi me OE e skualifikuar. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

b. "Vërejtje" për 20 punonjës si më poshtë:

1. Znj. H. B, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

2. Z. E. O, inspektor i taksave dhe i tarifave Njësija administrative Potom, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

3. Znj. L. B, inspektore taksash Njësia administrative Leshnjë për mos përmbushje të detyrave në

administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
4. Z. I. G, inspektor taksash Njësia administrative Çepan, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
5. Z. N. D, inspektor taksash Njësia administrative Vëndreshë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
6. Z. A. M, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia Vëndreshë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
7. **Z. N. K,** inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia administrative Bogovë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
8. Z. K. M, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia administrative Bogovë për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
9. Z. F. F, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia administative Gjerbës për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
10.Z. K. A, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore Njësia Administative Zhepë, për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
11. Znj. B. Ç, inspektor i taksava dhe i tarifave vendore për mos përmbushje të detyrave në administrimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për debitorët; për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.
12. Z. A. L, në cilësinë e nëpunësit pranë Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Në cilësinë e Kryetarit/Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, në 3 raste ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;
-Në cilësinë e nëpunësit pranë Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të zhvillimit dhe përdorimit të miratuara. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
13. Z. E. Y, me detyrë përgjegjës prokurimesh, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, pasi ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit;
-Për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".
14. Znj. E. H, me detyrë juriste, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, për mangësitë në hartimin

e fondit limit për procedurën me objekt: "*Blerje nafte për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Skrapar për vitin 2024*", Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

15. Znj. J. K, me detyrë juriste, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, pasi në **2 raste** ka miratuar kritere kualifikuese të paargumentuara dhe që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokuruar dhe kanë mangësi në hartimin e fondit limit; Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

16. Znj. L. H, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Gjelbërimit, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, për mangësitë në hartimin e fondit limit për procedurën me objekt: "*Blerje nafte për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Skrapar për vitin 2024*", Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

17. Z. D. M, me detyrë Mbikëqyrës në sektorin e Mbikëqyrjes së Rrugëve Rurale, në NShP Bashkia Skrapar, në cilësinë e Anëtarit të Njësisë së Prokurimit, për mangësitë në hartimin e fondit limit për procedurën me objekt: "*Blerje nafte për nevojat e Ndërmarrjes së Shërbime Publike, Skrapar për vitin 2024*". Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

18. Z. E O, me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Skrapar, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor NSHP, Bashkia Skrapar, për miratimin e disa procedurave të prokurimit, dhe për lidhjen e kontratave me operatorë ekonomikë të cilët kanë dorëzuar dokumentacion jo të plotë në funksion të kritereve të përcaktuara në DT. Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

19. Znj. A. K, me detyrë Përgjegjës i sektorit të Arsimit, Sportit dhe Kulturës, për mangësitë e konstatuara në procedurën me objekt: "*Blerje pajise mobilerie për shkollën e mesme*". Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

20. Z. F. O, në cilësinë e NJP për mangësitë e konstatuara në procedurën me objekt: "Blerje pajise mobilerie për shkollën e mesme". Për veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara nga Bashkia Skrapar dhe i masave të marra për arkëtimin e tyre, u konstatua se nuk janë ndjekur në mënyrë të plotë të gjitha procedurat dhe rrugët ligjore për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura. Nga analiza e të dhënave të administruara rezultoi si më poshtë:

a) Detyrimet e abonentëve familjarë.

Në datën 31.12.2024, detyrimet tatimore të paarkëtuara nga abonentët familjarë rezultonin në vlerën **98,885,976 lekë**. Gjatë periudhës 01.01.2025–31.12.2025, nga abonentët familjarë janë arkëtuar detyrime të prapambetura në vlerën **6,348,087 lekë**, ndërkohë që gjatë së njëjtës periudhë janë krijuar detyrime të reja në vlerën **17,139,347 lekë**. Si rezultat, në datën 31.12.2025, detyrimet tatimore progresive të paarkëtuara të abonentëve familjarë rezultojnë në vlerën **109,677,236 lekë**.

b) Detyrimet e tatimpaguesve të biznesit.

Në datën 31.12.2024, detyrimet tatimore të paarkëtuara të tatimpaguesve të biznesit ndaj Bashkisë Skrapar rezultonin në vlerën **9,856,375 lekë**. Gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025, nga tatimpaguesit e biznesit janë arkëtuar detyrime të prapambetura në vlerën **978,740 lekë**, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe janë krijuar detyrime të reja tatimore në vlerën **2,700,221 lekë**. Si rezultat, në datën 31.12.2025, detyrimet tatimore progresive të paarkëtuara të tatimpaguesve të biznesit rezultojnë në vlerën **11,577,856 lekë**.

Pavarësisht arkëtimit të një pjese të detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2025, niveli i borxhit tatimor është rritur, si për abonentët familjarë, ashtu edhe për tatimpaguesit e biznesit. Kjo tregon se masat e ndërmarra për arkëtimin e detyrimeve nuk kanë qenë të mjaftueshme për të reduktuar stokun e borxhit dhe se nuk janë shfrytëzuar në mënyrë të plotë të gjitha mekanizmat dhe rrugët ligjore në dispozicion për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Kreu XI nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 ", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "*Për financat e qeverisjes vendore*", neni 35. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, në faqet 31-40 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe e Tatim Taksave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2025 nga subjektet e biznesit debitorë në vlerën 11,577,856 lekë, nga debitorët familjarë në vlerën 109,677,236 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT